



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 11.09.2019)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimeve për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kriterëve për 14 kandidatë për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, përgatitur nga relatorët përkatës.

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:10 dhe mbaroi në orën 17:45.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Brunilda Kadi* (anëtare)
5. *Fatmira Luli* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Illir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Antuen Skënderi, Këshilltare e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 6. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 7. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
- 8. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 9. Aurora Ndreu, Specialiste pranë Sektorit të Oponencës Juridike dhe Përafrimit të Legjislacionit.*
- 10. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 11. Gregor Borgowski, EURALIUS.*
- 12. Klodian Rado, EURALIUS.*
- 13. Charles Ericksen, USAID.*
- 14. Valbona Bala (Pajo), USAID.*
- 15. Përfaqësues të medias (Prezent vetëm në pikën e parë.)*

#### **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimeve për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kriterëve për 14 kandidatë për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, përgatitur nga relatorët përkatës.

*Naureda Llagami:* Atëherë, përshëndetje të gjithëve!

Po fillojmë mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 11 shtator 2019.

Siç jeni të informuar, në mbledhjen e sotshme, Këshilli i Lartë Gjyqësor do trajtojë 7 çështje për diskutim.

Çështja e parë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kriterëve për 14 kandidatë për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, të cilët janë nga radhët e juristëve të spikatur.

Çështja e dytë ka të bëjë me shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, për një vend vakant.

Çështja e tretë ka të bëjë me përjashtimin e gjyqtarëve {...} dhe {...} nga procedura e ndarjes së çështjeve me short.

Çështja e katërt ka të bëjë me shqyrtimin e opinioneve për kandidatët magistratë nga radhët e gjyqtarëve që kanë shprehur interes për komandim pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Çështja e pestë ka të bëjë me përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

Çështja e gjashtë ka të bëjë me ndërprerjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit Besmir Stroka në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë dhe kthimin e tij në pozicionin e mëparshëm.

Dhe çështja e fundit është caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

Atëherë, për të kaluar tek çështja e parë, doja t'ju informoja që, sot Këshilli ka dy vendimmarrje mjaft të rëndësishme, sikurse jeni vënë edhe në dijeni nga vendimmarrjet/nga mbledhjet e mëparshme. Këshilli po punon intensivisht për të bërë sa më funksionale, në mënyrë sa më të shpejtë, Gjykatën e Lartë. Në këtë mënyrë, në Korrik, Këshilli shpalli nisjen e procedurës së kandidimit për emërimet në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur dhe sot Këshilli do të trajtojë 14 kandidatë që kanë aplikuar për të qenë pjesë në garën e kandidimit për anëtar në Gjykatën e Lartë.

Gjithashtu, një tjetër vendimmarrje e rëndësishme e Këshillit është që në eventualitetin që Gjykata e Lartë, pas shkarkimit të zotit {...} në cilësinë e anëtarit dhe të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, Këshilli do të hapë vendin tjetër vakant pranë kësaj gjykate, nga radhët e juristëve të spikatur.

Për më shumë, po kalojmë tek relatori i çështjes.

Kështu, lidhur me shqyrtimin e kandidatëve për anëtarë të Gjykatës së Lart, po kaloj tek relatori i parë që është zoti Hallunaj, për kandidatin {...}.

Për efekt të zhvillimit të mbarëvajtjes së seancës tonë, unë ftoj të gjithë gazetarët, që janë të pranishëm këtu, të ulen në ambientet e mbledhjes dhe kamerat të vazhdojnë përjashta. Faleminderit!

*(Kameramanët dalin nga salla e mbledhjes. Gazetarët largohen gjatë zhvillimit të pikës së parë.)*

Atëherë, kalojmë në diskutim.

**Dritan Hallunaj:** Po! Atëherë, faleminderit!

Sipas shortimit që është bërë nga e Këshillit të Lartë Gjyqësor, për sa i përket ndarjes së relatorëve për kandidatët për anëtarë të Gjykatës së Lartë, për anëtarin {...}, relator jam caktuar unë dhe për këtë kam përpiluar relacionin mbas gjetjeve që janë bërë nga ana jonë si Komision dhe të gjithë vendimmarrjeve të Komisionit. Ky relacion është miratuar një herë në Komisionin për Zhvillimin e Karrierës dhe Komisioni ka vendosur kalimin për shqyrtim mbledhjes/seancës plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Atëherë, janë kryer disa veprime që kanë të bëjnë që nga momenti i procedimit, që nga verifikimi i të gjitha procedurave, nga vendimmarrja.

Po i citoj, por janë të gjitha hapat procedural që janë ndërmarrë nga ana jonë, dhe çdo letërkëmbim që kemi patur me kandidatët.

Me Vendimet nr.108, 109, dhe 110 datë 09.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është vendosur shpallja e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në fushën e të drejtës administrative (që është vendimi 108), (109) civile dhe (110) për fushën e të drejtës penale.

Në vijim të kësaj, në këtë vendim specifikohet që çdo jurist, që plotëson kushtet dhe kriteret e parashikuara sipas nenit 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 49, pika 1, 2 dhe 5, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, është hapur konkurrimi dhe të gjitha personat kanë paraqitur dokumentacionin e nevojshëm.

Ndër kushtet që duhet të plotësonin kandidatët për t’u emëruar ne Gjykatën e Lartë, sipas nenit 136, pikat 3 dhe 4, të Kushtetutës së Republikës, janë:

a) të ketë vjetërsi në profesion, prej 15 vjetësh, si avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera;

b) të mbajë gradën shkencore në drejtësi;

c) të mos ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit.

Pikërisht në këtë vendim vijon: Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara më sipër, duhet të plotësojë edhe kriteret, sipas nenit 48, pika 3, shkronja “c” dhe pika 5, të Ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (ligjit 96/2016), si më poshtë:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

b) të jetë shtetas shqiptar;

c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë si dhe, kritere të tjera që nuk po i përmendim.

Në momentin e aplikimit, kandidati duhet të paraqiste dokumentat e mëposhtëm dhe janë të listuara të gjitha në relacion:

a) Kërkesën për shprehjen e interesit...;

b) Jetëshkrimin...;

c) Fotokopje të kartës së identitetit;

d) Dokumentacionin shoqërues nëpërmjet të cilit vërtetohet përmbushja e kritereve të përcaktuara më sipër me vendimmarrjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Brenda afatit dyjavor nga dita e publikimit të vendimeve si më lart në faqen zyrtare, për tre pozicionet e lira të shpallura, ka aplikuar për të marrë pjesë edhe kandidati z. {...}.

Me Vendimin nr.142, datë 26.07.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur:

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve...;

2. Caktimin e relatorit dhe për zotën {...}, relator jam caktuar unë.

Më datë 26.07 (pra po atë ditë), në respektim të detyrimeve ligjore, kandidati është njoftuar në rrugë elektronike për fillimin e procedurës; për caktimin e relatorit; për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të një anëtari si dhe plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, postën elektronike dhe kontaktet telefonike, me qëllim procedurën e verifikimit të mëtejshëm.

Brenda afatit treditor, z. {...}, depozitoi rregullisht të plotësuar formularin deklarues në adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj tij. Nga ana tjetër, kandidatit nuk parashtrroi asnjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Më datë 29.07.2019, pas shqyrtimit paraprak të dokumentacionit të paraqitur në rastin e kandidimit, duke vlerësuar se ky dokumentacion ishte i mangët, kandidati, z. {...}, në rrugë elektronike, u njoftua për plotësimin e dokumentacionit të kandidimit.

Po me këtë datë i është dërguar edhe formulari dhe autorizimet përkatëse që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej tij.

Brenda afatit pesëditor, kandidati {...}, depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit, me përjashtim të dokumentit që provonte që ky kandidat të mbante gradë shkencore në drejtësi, kjo në zbatim të nenit 136, pika 3, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kritereve këto që ishin përcaktuar edhe në vendimmarrjet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë (*lapsus - Këshillit të Lartë Gjyqësor*) me nr.108, 109, dhe 110 të datës 09.07.2019.

Mbi këtë bazë, më datë 28.08.2019, kandidati, z. {...}, në rrugë elektronike, u njoftua për gjetjen e procedurës së verifikimit, pra në lidhje me kushtin e kandidimit “të mbajtjes gradë shkencore në drejtësi”, (pra mungesën e saj), kusht ky i përcaktuar siç relatuam më sipër në nenin 136, pika 3, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Pas marrjes së këtij njoftimi të dërguar nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, me shkresën e protokolluar në institucionin tonë me nr.3687/4, datë 02.09.2019, kandidati z. {...}, ka parashtruar pretendimet e tij në lidhje me mospasjen e kësaj grade, ku ndër të tjera në relacion është cituar komplet pjesa e pretendimeve që ai kishte, por shkurtimisht, për të mos... deklaron:

“...Duke qenë se jam mbajtës i një grade shkencore, nuk kam gradë shkencore në drejtësi por informoj Këshillin që kam përfunduar “Master i Shkencave” në të drejtën tregtare, dhe kam marrë diplomën ku jam vlerësuar me notën 10”. Si dhe parashtron disa pretendime të tjera që kanë të bëjnë me idenë e pranimit në programin e ciklit të tretë të studentëve, pra që ka të bëj me pjesën e marrjes së gradës shkencore të personave që

pranimi i tyre është i mundur për kandidatët që kanë fituar master shkencor dhe plotësojnë kriteret e pranimit. Pra në këto kushte nuk është se parashtron ose nuk paraqet një gradë shkencore por thjesht është ideja që meqenëse unë kam gradën, kam përfunduar masterin, jam në kushte të tilla që mund të filloj mbajtjen e doktoraturës. Pra këto janë gjetjet e Komisionit.

Duke vlerësuar të plotë procedurën e verifikimit të ndjekur deri në këtë moment për kandidatin, z. {...} dhe, në veçanti, verifikimet në lidhje me kushtin e kandidimit “të mbajtjes gradë shkencore në drejtësi”, këtë rast e kemi parashtruar Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe ky Komision, në mbledhjen e datës 09.09.2019, duke konsideruar se procedurat dhe verifikimet për këtë kusht kandidimi ishin të plota, bazuar në pikën 3, të Seksionit C, Kreu VI, të vendimit 75/2019, vendosi kalimin çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur për skualifikimin e kandidatit për mosplotësimin e këtij kushti kandidimi ose për vijimin e procedurës së verifikimit për kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit. Pra jemi në kushtet që meqenëse kandidati nuk plotësonte një nga kriteret bazë formal të kandidimit të tij, siç është “mbajtja e gradës shkencore në drejtësi”, është seanca plenare e Këshillit të Lartë Gjyqësor ajo që do vendosë për vijimin e mëtejshëm të procedurave apo skualifikimin e këtij kandidati. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Hallunaj!

Kemi diskutime dhe pyetje lidhur me relacionin dhe propozimin të bërë nga relatori?

Po, zoti Hallunaj!

**Dritan Hallunaj:** Meqenëse nuk ka pyetje, në cilësinë e relatorit vlerësoj se gjetja e procedurës së verifikimit është një rrethanë faktike, përmes së cilës vërtetohet që kandidati z. {...} nuk përmbush njërin prej kushteve dhe kriterëve të kandidimit, pikërisht atë “të mbajtjes gradë shkencore në drejtësi”, e përcaktuar kjo në nenin 136, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, por edhe në nenin 49, pika 1 e ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Gjetja e procedurës së verifikimit konfirmohet nga mungesa e diplomës që vërteton fitimin e gradës në drejtësi nga vetë kandidati në shpjegimet e tij. Kandidati, me të vërtetë në pretendimet e tij shprehet që pranimi në programin e ciklit të tretë të studentëve është i mundur për kandidatët që

kanë fituar master dhe plotësojnë kriteret e pranimit, por për mendimin tim kjo nuk provon faktin që kandidati të ketë kryer studimet e doktoraturës dhe të ketë fituar gradë shkencore sepse programet e studimit të doktoratës janë programet e studimit të ciklit të tretë, ndërsa programet e studimeve master i shkencave, janë studime të ciklit të dytë, referuar kjo ligjit 9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë”, i ndryshuar. Pikërisht, për këtë arsye, kandidati z. {...} është pajisur me diplomën përkatëse “master shkencor”, por nuk disponon dokument që të provojë “mbajtjen e gradës shkencore” në drejtësi, sipas parashikimeve që ka Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 136/3 e cila përcakton që një nga kriteret është të mbajë gradën shkencore.

Në këto kushte, për mendimin tim ose propozoj që zoti {...}, duke mos plotësuar një nga kushtet e kandidimit atë “të mbajtjes së gradës shkencore në drejtësi”, referuar pikës 16, seksioni B, kreu VI i vendimit 75/2019, nuk është e nevojshme kryerja e procedurës së verifikimit për kushtet dhe kriteret e tjera të kandidimit dhe propozoj skualifikimin e kandidatit {...} dhe përjashtimin e tij nga procedurat e tjera të emërimit për tre pozicionet e lira të shpallura në Gjykatën e Lartë, si ajo në fushën e të drejtës administrative, të drejtës civile dhe të drejtës penale. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Nëse kemi diskutime lidhur me propozimin e bërë?

Nuk kemi!

Atëherë, kalojmë në votim propozimin e bërë nga Komisioni?

**Dritan Hallunaj:** “Projektvendim për skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit {...} nga procedurat e emërimit të Gjykatës së Lartë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pika 1 dhe 5, të nenit 49 në lidhje me pikat 4, shkronja “c” dhe 6, të nenit 32, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në shkronjën “a”, pika 2, të nenit 61, në shkronjën “a”, të nenit 86 dhe nenet 97, 98 dhe 100, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “e”, pika 12, Seksioni Ç, Kreu VI, të vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur, vendosi: Skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit z. {...} nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë, për



pozicionet e lira të shpallura me vendimin nr.108, datë 09.07.2019, vendimin nr.109, datë 09.07.2019 dhe vendimin nr. 110, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...}.

3. Kandidati ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.” Ky është propozimi.

**Naureda Llagami:** Atëherë, kalojmë në votim projektvendimin e propozuar nga Komisioni/relatori. Jemi dakord?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Dakord.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi pranimin e vendimit sipas tekstit të lexuar nga relatori.

Kalojmë tek çështja e dytë, pra bëhet fjalë për kandidatin {...}, relator i të cilit është zonja Maçela Shehu.

Tani, për efekt të menaxhimit të kohës unë do propozoja që gjithë këtë procedurën, të paktën ne jemi në dijeni se i kemi lexuar materialet, procedurën e njoftimit të kandidatit, ndoshta mos ta përmendim më, mos ta lexojmë, por të kalojmë tek gjetjet e Komisionit dhe tek propozimi konkret që ka Komisioni. Sepse ajo lloj procedure është në relacion, i është bërë me dije palës dhe ne mund të kalojmë direkt në gjetjet e relatorit dhe propozimin që ka për kandidatin përkatës. Jeni dakord me këtë?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

**Marçela Shehu:** Faleminderit, Kryetare!

Ju parashtroj relacionin për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, në këtë rast, të kandidatit, zotit {...}.

Ashtu sikurse edhe ju cituat, unë si relatore kam realizuar procedurën e verifikimit në përputhje me parashikimet e vendimit nr. 75, datë 23.05.2019, verifikim i cili ka filluar pas shpalljes nga Këshilli i Lartë Gjyqësor i tre pozicioneve të lira për në Gjykatën e Lartë nga radhët e jo juristëve, konkretisht me vendimin nr. 108, 109 dhe 110 të datës 09.07.2019.

Pas shpalljes së këtyre tre vendeve, pra tre pozicioneve të lira me anë të këtyre vendimeve, me vendimin nr.142, datë 26.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, është vendosur fillimi i procedurës së verifikimit të këtyre kandidatëve dhe për zotin {...} jam caktuar unë si relatore.

Në vijim, në përputhje me parashikimet e vendimit nr. 75 të Këshillit të Lartë Gjyqësor ka vijuar procedura e verifikimit; është komunikuar në mënyrë elektronike me zotin {...} në adresën e deklaruar prej tij; i është bërë e ditur e drejta për të kërkuar përjashtimin e anëtarëve apo të relatorit; i janë komunikuar formularët për të plotësuar, autorizimet, etj.

Zoti {...} fillimisht nuk kishte shprehur pëlqimin e tij se për cilën nga tre pozicionet kishte kandiduar, më pas, pas pyetjes nga relatori ka deklaruar se ai kandidon për të tre pozicionet e lira.

Zoti {...} ka plotësuar dokumentacionin lidhur me pikat që relatori kishte vënë në dukje, përveç mbajtjes së.. pra përveç dokumentit që vërtetonte “mbajtjen e gradës shkencore në drejtësi”.

Në këto kushte, duke qenë se zoti {...} nuk paraqiti asnjë vërtetim që vërtetonte këtë fakt, pra që ai mbante gradën shkencore në drejtësi dhe duke qenë që ky ishte një moment që mund të çonte në skualifikimin e këtij kandidati, unë si relatore kam vënë në dijeni Komisionin e Zhvillimit të Karrierës i cili vendosi që kandidati zoti {...} të ftohet për të paraqitur shpjegime lidhur me gjetjen e procedurës së verifikimit. Pra gjetja e procedurës së verifikimit për zotin {...} lidhet pikërisht me mungesën e “mbajtjes së gradës shkencore në drejtësi”.

Në rrugë elektronike është njoftuar për gjetjen zoti {...}. Ai është përgjigjur duke thënë se nuk është mbajtës i një grade shkencore, pasi ka përfunduar studimet sipas modelit

të vjetër katërvjeçar. Ai ka theksuar se gjatë karrierës së tij 15-vjeçare ka botuar një sërë punimesh shkencore të materializuara në libra, të cilat i ka vënë në dispozicion.

Duke e vlerësuar të plotë procedurën e verifikimit, unë si relatore e kam parashtruar çështjen para Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Në mbledhjen e datës 09.09.2019, ky Komision ka konsideruar se procedurat e verifikimit janë të plota dhe ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor, i cili më pas të vlerësojë dhe të vendosë për skualifikimin e këtij kandidati për shkak të mosplotësimit të këtij kushti apo për vijimin e procedurës së verifikimit për kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit.

Lidhur me qëndrimin tim si relatore, të cilin unë pak a shumë e kam parashtruar edhe në relacion, unë vlerësoj se në rastin konkret ndodhemi në kushtet e skualifikimit të zotit { ... } për shkak se ai nuk plotëson një nga kushtet kushtetuese dhe ligjore që parashikon neni 136/3 i Kushtetutës dhe 49/1 i ligjit për Statusin dhe konkretisht atë “të mbajtjes së gradës shkencore në drejtësi”. Nuk e di nëse ka ndonjë pyetje nga anëtarët?

**Naureda Llagami:** Kemi ndonjë pyetje sqaruese, ndonjë paqartësi?

Atëherë, jo!

Kalojmë në propozimin tuaj?

**Marçela Shehu:** Unë si relatore kam përgatitur edhe projektvendimin përkatës që ka të njëjtën bazë ligjore si ai që citoi edhe zoti Hallunaj në projektvendimin e miratuar pak më parë dhe propozoj që, ky Këshill, të vendosë: Skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit z. { ... } nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me vendimin nr. 108, datë 09.07.2019, me vendimin nr. 109, datë 09.07.2019 dhe me vendimin nr. 110, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor; Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kandidatit z. { ... } dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve; Kandidati ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar; Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zonja Shehu!

Atëherë, nëse ne nuk kemi diskutime, do kalojmë në votimin e projekt-aktit të propozuar. Sipas rregullores, kemi një procedurë, që votimi fillon me relatorin, më pas anëtarët e Komisionit dhe më pas anëtarët e tjerë. Jemi dakord?

Po! Kalojmë në votim!

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Ilir Toska*: Dakord.

*Alban Toro*: Dakord.

*Dritan Hallunaj*: Pro.

*Maksim Qoku*: Dakord.

*Brunilda Kadi*: Pro.

*Fatmira Luli*: Pro.

*Erjon Muharremaj*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Medi Bici*: Pro.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, projektvendimi u miratua sipas propozimit të bërë nga relatorja lidhur me rastin e kandidatit {...}.

Kalojmë tek kandidati tjetër, që bëhet fjalë për zotin {...}, relator i të cilit është zoti Ilir Toska.

*Ilir Toska*: Faleminderit!

Atëherë, në cilësinë e relatorit të çështjes, ju parashtroj këtë relacion për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në gjykatën e lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, të kandidatit z. {...}.

Siç edhe u referua më herët, Këshilli me vendimin nr.108, datë 09.07.2019, ka vendosur të shpallë procedurën e emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në fushën e të drejtës administrative. Është përcaktuar edhe afati 2-javor.

Po kështu, me vendimin nr.109, datë 09.07.2019, Këshilli ka shpallur procedurën e emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave, nga

radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në fushën e të drejtës civile. Edhe në këtë rast afati i kandidimit është përcaktuar dy javë.

Brenda afatit dyjavor nga dita e publikimit të vendimeve si më lart në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për dy pozicionet e lira të shpallura përmes dy vendimeve si më sipër, ka aplikuar për të marre pjesë edhe kandidati z. {...}.

Me Vendimin nr.142, datë 26.07.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: Fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatët, nga radhët e juristëve të spikatur, për në pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë dhe caktimin e relatorit për secilin kandidat që ka dorëzuar kërkesën për t'u emëruar në Gjykatën e Lartë, ku për zotin {...} jam caktuar unë si relator.

Më datë 26.07.2019, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të vendimit nr. 75/2019, kandidati, z.{...}, në rrugë elektronike, u njoftua për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 ditëve nga marrja e këtij njoftimi. Po ashtu, kandidati u njoftua edhe për detyrimin për plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit, për qëllimet e procedurës së verifikimit duke iu dërguar edhe formulari përkatës.

Brenda afatit treditror, kandidati, depozitoi rregullisht formularin deklarues për adresën. Nga ana tjetër, në këtë afat, kandidatit nuk parashtrroi asnjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Më datë 29.07.2019, pas shqyrtimit paraprak të dokumentacionit të paraqitur në rastin e kandidimit, duke vlerësuar se ky dokumentacion ishte i mangët apo jo konform ligjit (origjinal ose i njësuar me origjinalin), kandidati, z.{...}, në rrugë elektronike, u njoftua për plotësimin e dokumentacionit të kandidimit, bazuar në pikën 9, Seksioni B, Kreu VI, të vendimit nr. 75/2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Po më datë 29.07.2019, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të vendimit nr. 75/2019, kandidatit, z.{...}, në rrugë elektronike, iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të vendimit nr. 75/2019) që

duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej tij në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit.

Brenda afatit pesëditor, kandidati, z. {...}, depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit.

Ndër dokumentet e dorëzuara nga kandidati, ishte dhe kopja, e njësuar me origjinalin, e dokumentit “Diplomë” nr.54, datë 24.04.2017, lëshuar nga Universiteti Bujqësor i Tiranës, sipas të cilës:

“Juria e ngritur pranë Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit në përputhje me legjislacionin në fuqi, shqyrtoi disertacionin me temë “Stabiliteti i çmimeve dhe qëndrueshmëria financiare - dy objektiva të rëndësishëm të Bankës Qendrore”, paraqitur nga z. {...}, lindur ..., në kërkim të gradës shkencore “Doktor” dhe me Vendimin nr. 2, dt. 26/01/2017, e vlerësoi atë “Shumë mirë” duke i dhënë z. {...} gradën shkencore “Doktor”, në fushën: “Ekonomi dhe Agrobiznes”, Drejtimi: “Financë - Kontabilitet”.

Në vijim të procedurës së verifikimit, më datë 06.08.2019, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të vendimit nr. 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkuar informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, për kandidatët e Gjykatës së Lartë, ndër ta edhe për z. {...}.

Po më datë 06.08.2019, në kuadër të verifikimit të kushtit të kandidimit, atij “të mbajtjes gradë shkencore në drejtësi”, përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, por edhe në nenin 49, pika 1, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shkresën nr. 4163 prot., u kërkuar informacion dhe konfirmim nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në lidhje me fitimin e gradës shkencore në drejtësi nga kandidatët për gjyqtarë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, ndër ta edhe për z. {...}.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, me shkresën nr. 7834/1 prot., datë 23.08.2019 (protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 4163/1 prot., datë 26.08.2019), Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë informoi dhe konfirmoi, ndër të tjera, se:

“... 4. Grada shkencore “Doktor” në “Financë - Kontabilitet” e fituar nga z. {...} figuron e regjistruar në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademik, pranë MASR, me numër rendor: 2834, Universiteti Bujqësor i Tiranës, nr. Vendimi: 2, datë

26.01.2017. Të gjitha gradat shkencore te listuara më sipër, përveç gradës shkencore te fituar nga z. {...} (Financë-Kontabilitet) ..., i përkasin fushës së drejtësisë. ...”.

Pas marrjes së informacionit dhe konfirmimit nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, pra nga ministria përgjegjëse për arsimin që ka për kompetencë, ndër të tjera, edhe administrimin e regjistrimit shtetëror të gradave shkencore (referuar ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”), nisur nga fakti se grada shkencore “Doktor” në fushën e “Ekonomisë dhe Agrobiznesit”, Drejtimi “Financë - Kontabilitet”, fituar nga kandidati, z.{...}, nuk klasifikohet si “gradë shkencore në drejtësi”, duke patur në vëmendje përmbajtjen e nenit 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 49, pika 1, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke vlerësuar së në rastin konkret verifikohet një rrethanë që mund të çonte në përfundimin se kandidati nuk plotëson një nga kushtet e emërimit si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, unë si relatori i çështjes vura në dijeni Komisionin e Zhvillimit të Karrierës, i cili, mbështetur në shkronjën “a”, pika 12, Seksioni B, Kreu VI, të vendimit nr. 75/2019, me vendimin e datës 28.08.2019, vendosi që:

“Kandidati z. {...} të ftohet për të paraqitur shpjegime lidhur me gjetjen e procedurës së verifikimit, si edhe të çdo dokumentacioni mbështetës të nevojshëm sipas vlerësimit të tij”.

Mbi këtë bazë, më datë 28.08.2019, kandidati, z.{...}, në rrugë elektronike, u njoftua për gjetjen e procedurës së verifikimit, pra në lidhje me kushtin e kandidimit “të mbajtjes gradë shkencore në drejtësi”, duke u ftuar për të paraqitur shpjegime për gjetjen e procedurës së verifikimit, si edhe të çdo dokumentacioni mbështetës të nevojshëm sipas vlerësimit të tij.

Brenda afatit pesë ditor, pikërisht me datë 28.08.2019, kandidati, z.{...}, në rrugë elektronike, paraqiti shpjegimet e tij.

Më datë 29.09.2019, kandidati, z.{...} i dorëzoi relatorit të çështjes një kopje të Disertacionit “Stabiliteti i çmimeve dhe qëndrueshmëria financiare - dy objektiva të rëndësishëm të Bankës Qendrore” - Dhjetor 2016, disertacion mbi të cilin, sipas tij, ai ka fituar gradën shkencore “Doktor”, pranë Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit të Universitetit Bujqësor të Tiranës. Po ashtu, në këtë rast, kandidati dorëzoi edhe një kopje

të Librit "E drejta bankare" (Botimi i tretë) - Mars 2009 (ISBN: 987-999-22-60-2), shtypur në Shtypshkronjën "Exspres", me autor atë vetë.

Në shpjegimet e tij, kandidati, z. {...}, ka parashtruar se:

"Çështja se kujt fushe i përket punimi im doktoral (me të cilin kam fituar gradën "Doktor"), të paktën në rastin tim, mund të kërkojë sqarim dhe interpretim. Me duhet te sqarohem: Unë jam jurist nga shkollimi dhe formimi im profesional, diplomuar si jurist në vitin 1994. Më pas e gjithë karriera ime ka vazhduar në sistemin bankar dhe financiar, të cilit unë i jam përkushtuar për shumë vite. Unë nuk kam formim tjetër shkollor dhe profesional (nuk jam ekonomist apo diçka tjetër). Pra unë jam jurist pasi kam studiuar vetëm për drejtësi, por karriera ime ka ndjekur një fushë specifike dhe pak të njohur të së drejtës, atë të së drejtës bankare. Në këtë kuadër kanë qenë dhe disa nga botimet e mija, përfshirë si autor i "E drejta bankare", bashkautor në komentarin e ligjit për Bankën e Shqipërisë dhe të ligjit tjetër për bankat në Republikën e Shqipërisë, etj.. CV ime e ka më të qartë këtë aktivitet.

Duke pasur këtë CV dhe kontribut në këtë degë (dhe duke punuar për 11 vjet në Bankën e Shqipërisë), edhe studimet e mija pasuniversitare, natyrshëm ishin në këtë drejtim: atë të bankingut, dhe bankingut qendror më konkretisht. Edhe tema e doktoratës sime përqendrohet vetëm në një pikë, dhe ka një konkluzion qendror: rishikimin e ligjit për Bankën e Shqipërisë dhe ndjekjen nga kjo Bankë, krahas stabilitetit të çmimeve dhe atë të stabilitetit financiar. Kjo sepse unë jam jurist dhe në fund të fundit kontributi im vërtitet rreth legjislacionit. Por instrumentet sesi do arrihet aty, pa dyshim që do jene teknike dhe të fushës së financë-bankës. Këtu kam idenë që lind dhe dyshimi dhe ka nevojë për sqarim, tek mënyra, teknika, instrumentet e punuar dhe studiuar nga unë për të nxjerrë konkluzionin dhe propozimin për rishikimin e legjislacionit përkatës të fushës (e drejta bankare në rastin konkret, ku dhe unë mendoj se aty ka qenë dhe kontributi im shkencor).

Do të ishte e padrejtë dhe vlerësim i pamerituar për mua nëse ky punim do të konsiderohej kontribut në ekonomi apo diku tjetër - për të cilën unë nuk jam i shkolluar/specializuar dhe nuk zotëroj njohuritë e duhura.

Një keqkuptim ka në fakt dhe në mënyrën e shprehur në shkresën e ardhur nga Ministria e Arsimit, ku sqaron çështjet e doktoraturave tona. Është e pasakte shprehja në piken 4, për personin tim: "Grada shkencore "Doktor" në "financë-kontabilitet", pasi tema



ime s'ka të bëjë me financën, aq më pak me kontabilitetin, por ka të bëjë me Bankën Qendrore të Shqipërisë dhe statusin juridik të saj, i cili duhet të rishikohet/plotësohet sipas punimit tim shkencor. Për këtë nevojitet rishikimi i ligjit të saj organik - sipas gjetjeve të mija.

Ndërkohë që ky punim, kjo temë, është ndjekur pranë Departamentit "Financë dhe Kontabilitet" të Universitetit Bujqësor të Tiranës, ku unë ndoqa shkollën doktorale dhe mbrojta temën në fjalë. Dhe mendoj që këtu është dhe ngatërresa apo nevoja për sqarim.

Por se kujt fushe i përket një studim shkencor, mendoj që nuk e përcakton ana formale, qoftë dhe Universiteti ku e ke ndjekur, por përmbajtja e punimit. Mua e njëjta shkollë doktorale më doli dhe pranë Fakultetit të Drejtësisë të UT, por duke qenë se për temën time unë arsyetova/konsiderova që aty nuk do të ishin ekspertët e duhur të fushës për shkak të specifikave teknike, nuk e ndoqa pranë këtij fakulteti por e ndoqa në një fakultet tjetër ku unë mendova që do kishte dhe ekspertë më të mirë të fushës. Dhe kjo mund të verifikohet. Në të kundërt, është e pamundur për mua që të konsideroj studimin tim shkollën katërvjeçare doktorale dhe temën e doktoratës, që i përket një fushe tjetër, veç asaj të së drejtës. Thjesht është e pamundur. Unë jam jurist, përtej çdo karriere të ndjekur nga ana ime për rreth 25 vjet. Madje mund të them që brenda punimit tim ka edhe elemente te ekonometrisë (shkencë mes ekonomisë dhe matematikës), që më ndihmoi mua (dhe më është dashur të përdor formula të saj) për të nxjerrë konkluzionet e punimit tim. Por kjo nuk passjell faktin që ky punim, kjo temë, është e kësaj fushe!?

Një tjetër problematikë unë shikoj edhe tek mungesa e ekspertëve të fushës dhe tek njohuritë e pakta që ka sot për të drejtën bankare, si një degë teknike e së drejtës. Një ekspert i kësaj fushe do ta kishte fare të lehtë këtë konstatim dhe këtë interpretim, pasi do kuptonte menjëherë çështjen e kompetencës lëndore dhe fushës që mbulon e drejta bankare.

Për të mbështetur këtë pretendim, po ju bashkëngjis kapitullin e fundit të punimit tim doktoral, Kreun 8 "Konkluzione dhe Rekomandime", më konkretisht piken 8.4, "Ndryshimet ligjore qe propozohen ne ligjin për Bankën e Shqipërisë", që është ne fakt edhe thelbi i punimit tim. Dhe mendoj se, nëse një punim shkencor propozon ndryshime konkrete në një ligj organik (siç është ligji për Bankën e Shqipërisë), ai s'mund t'i përkasë fushave të tjera veç asaj të së drejtës".

Duke vlerësuar të plotë procedurën e verifikimit të ndjekur deri në atë moment për kandidatin, z. {...} dhe, në veçanti, verifikimet në lidhje me kushtin e kandidimit “të mbajtjes gradë shkencore në drejtësi”, unë si relatori i çështjes ia parashtroi rastin Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Ky i fundit, në datën 09.09.2019, duke konsideruar se procedurat dhe verifikimet për këtë kusht kandidimi ishin të plota, bazuar në pikën 3, të Seksionit C, Kreu VI, të vendimit nr. 75/2019, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur për skualifikimin e kandidatit për mosplotësimin e këtij kushti kandidimi ose për vijimin e procedurës së verifikimit për kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit. Ky është edhe relacioni i përgatitur nga ana ime si relator i çështjes. Nëse ka pyetje nga ana e anëtarëve, mund t’ju përgjigjem.

**Naureda Llagami:** Keni ndonjë pyetje?

Po apo jo?

Jo! Nuk kanë pyetje. Vazhdojmë tek propozimi.

**Ilir Toska:** Atëherë, po vijoj me diskutimin në lidhje me pretendimet për gjetjen e procedurës së verifikimit të ngritura nga kandidati, zoti {...} dhe me propozimin tim për Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Në cilësinë e relatorit të çështjes mendoj se gjetja e procedurës së verifikimit është një rrethanë faktike përmes të cilës vërtetohet që kandidati, z. {...}, nuk përmbush njërën prej kushteve dhe kriterëve të kandidimit, pikërisht atë “të mbajtjes gradë shkencore në drejtësi”, përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, por edhe në nenin 49, pika 1, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Gjetja e procedurës së verifikimit vërtetohet përmes dokumentit të depozituar nga vetë kandidati, z. {...}, pra kopja, e njëzuar me origjinalin, e dokumentit “Diplomë” nr.54, datë 24.04.2017, lëshuar nga Universiteti Bujqësor i Tiranës. Po ashtu gjetja vërtetohet edhe përmes shkresës nr. 7834/1 prot., datë 23.08.2019, të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Përmbajtja e këtyre dokumenteve është paraqitur edhe në relacion, referuar atyre evidentohet qartësisht se grada shkencore “Doktor” fituar nga kandidati, z. {...}, nuk i përket fushës së drejtësisë, por fushës së ekonomisë dhe agrobiznesit, ndërsa drejtimi i saj nuk është në shkencat juridike, por në shkencat ekonomike (financë-kontabilitet).

Mendoj se pretendimet e kandidatit, z. {...}, se grada shkencore e fituar nga ai duhet të konsiderohet si gradë shkencore në drejtësi, janë të pabazuara.

Konkretisht, mendoj se nuk qëndron pretendimi i kandidatit se meqenëse ka përfunduar studimet e larta për drejtësi, grada shkencore e fituar prej tij nuk mund të jetë veçse në drejtësi. Lidhur me këtë kam parasysh faktin se, ndryshe nga sa pretendohet nga kandidati, përveç studimeve të larta për drejtësi në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (në periudhën 1990-1994), nga aktet e procedurës së verifikimit, rezulton që kandidati të ketë ndjekur edhe studimet në kursin njëvjeçar të kualifikimit të specialistëve të lartë të financë-bankës në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik (në periudhën dhjetor 1997 - dhjetor 1998), përveç edhe studimet në shkollën pasuniversitare të studimeve të thelluara në finance-bankë në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik (në periudhën 1998-2000). Një fakt i tillë referohet nga vetë kandidati në jetëshkrimin e tij, por edhe në dokumentet e dorëzuara. Po ashtu ky fakt përmendet edhe në “Diplomën” nr.54, datë 24.04.2017, lëshuar nga Universiteti Bujqësor i Tiranës. Është pikërisht një rrethanë e tillë ajo që unë mendoj se nga sa duket, është konsideruar në rastin e regjistrimit të kandidatit në fjalë në studimet e ciklit të tretë, programin e studimeve të doktoratës, referuar për këtë në nenet 26 dhe 34, në lidhje me nenet 89 dhe 99/2, të ligjit nr.9741, datë 21.05.2007, “Për arsimin e lartë”, i ndryshuar, që ka qenë në fuqi në momentin e fillimit të këtyre studimeve nga kandidati dhe bazuar në të cilin ai ka fituar gradën shkencore.

Mendoj se është i pabazuar pretendimi i kandidatit, z. {...}, për qenien në fushën e drejtësisë të gradës shkencore të fituar nga ai referuar për këtë karrierës së tij profesionale. Në vlerësimin tim, karriera profesionale nuk ka asnjë interferim me studimet akademike të doktoratës.

Në vijim mendoj se nuk mund të pranohet pretendimi i kandidatit, z. {...}, për interpretimin e fushës së gradës shkencore të fituar prej tij referuar përmbajtjes së disertacionit shkencor mbi të cilin ai ka arritur të fitojë gradën, pasi përcaktimi i fushës dhe drejtimit të programit të studimit për fitimin e kësaj grade është bërë nga organi kompetent i institucionit të arsimit të lartë që i ka dhënë gradën kandidatit, i cili, në përputhje me nenin 31 të ligjit nr.9741, datë 21.05.2007, “Për arsimin e lartë”, i ndryshuar, e ka pajisur atë me diplomën përkatëse, që përbën dokument zyrtar me fuqi të plotë provuese, në të cilin janë përshkruar, në veçanti, natyra dhe përmbajtja e studimeve.

Në vijim, në vlerësimin tim, mendoj se nuk qëndron edhe pretendimi i kandidatit, z.{...}, se institucioni i arsimit të lartë ku ai ka ndjekur studimet e doktoratës dhe i ka dhënë atij gradën shkencore nuk përcakton fushën e kësaj grade. Pra, thënë ndryshe, fakti që ai ka ndjekur studimet e doktoratës në Universitetin Bujqësor të Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit, nuk do të thoshte se grada shkencore e fituar nga ai nuk është në fushën e drejtësisë. Ndryshe nga sa kandidati pretendon, mendoj se drejtimi i institucionit të arsimit të lartë ku studenti ka ndjekur studimet e doktoratës dhe ka fituar gradën shkencore, në veçanti njësitë kryesore dhe ato bazë (fakultetet dhe departamentet), indirekt përcaktojnë dhe llojin/natyrën e programeve të studimeve që ofrojnë, rrjedhimisht dhe fushën e gradave shkencore që japin në përfundim të studimeve të doktoratës. Thënë ndryshe, referuar legjislacionit të kohës se arsimit të lartë, fakulteti, si njësi kryesore e një institucioni të arsimit të lartë, bashkërendonte mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor në fusha mësimore-kërkimore, të përafërta ose të ndërthurura. Thënë kjo, fusha mësimore-kërkimore e një fakulteti ekonomie dhe agrobiznesi, si në rastin konkret, kurrsesi nuk mund të jetë drejtësia. Po ashtu, edhe karriera akademike e personelit akademik të një fakulteti ekonomie dhe agrobiznesi, nga i cili krijohet juria dhe caktohet udhëheqësi shkencor për drejtimin, këshillimin, vlerësimin e nevojave dhe për zhvillimin e monitorimin e përparimit të punës kërkimore të studentit, kurrsesi nuk mund të jetë në fushën e drejtësisë.

Gjithsesi, përtej kësaj, sjell në vëmendje se gjatë procedurës së verifikimit, kandidati, z.{...}, megjithëse u ftua të paraqiste dokumente mbështetës, nuk paraqiti ndonjë akt provues përmes të cilit të vërtetonte pretendimin e tij se programi i studimeve të doktoratës i ofruar në rastin e tij nga Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Universiteti Bujqësor i Tiranës, ka qenë një program studimi në fushën e drejtësisë, hartuar dhe miratuar nga senati akademik i këtij institucioni të arsimit të lartë, sikurse përcaktohet në nenin 26 (*lapsus – duhet neni 25*) të ligjit nr.9741, datë 21.05.2007, “Për arsimin e lartë”, i ndryshuar, sikundër po ashtu, që ky program, ishte i miratuar dhe nga ministria përgjegjëse për arsimin.

Së fundi, mendoj se nuk qëndron edhe pretendimi i kandidatit, z.{...}, në lidhje me botimet e tij shkencore, referuar për këtë librit të tij “E drejta bankare”. Botimet shkencore në përgjithësi mendoj se nuk kanë asnjë interferim me studimet akademike të doktoratës.

Në përfundim të këtij diskutimi, mendoj se procedurat e verifikimit për kandidatin, z. {...}, në lidhje me kushtin e kandidimit “të mbajtjes gradë shkencore në drejtësi”, janë të plota, prandaj, ndërsa nuk vërtetohet që kandidati të përmbushë këtë kusht, vijimi i procedurës së verifikimit për kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit nuk është i nevojshëm.

Për sa parashtrova, mendoj se Këshilli i Lartë Gjyqësor është para rastit për të vendosur skualifikimin e kandidatit z. {...} dhe përjashtimin e tij nga procedurat e emërimit në dy pozicionet e lira të shpallura për në Gjykatën e Lartë, ato në fushat e të drejtës administrative dhe të drejtës civile.

Në lidhje me këtë propozim, në cilësinë e relatorit të çështjes, në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në vendimin nr.75/2019, kam përgatitur edhe projektvendimin përkatës, që është pjesë e materialeve të mbledhjes për këtë çështje.

Mund ta lexoj edhe projektvendimin.

“Projektvendim për skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit z. {...}  
nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pika 1 dhe 5, të nenit 49 në lidhje me pikat 4, shkronja “c” dhe 6, të nenit 32, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në shkronjën “a”, pika 2, të nenit 61, në shkronjën “a”, të nenit 86 dhe nenet 97, 98 dhe 100, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “e”, pika 12, Seksioni Ç, Kreu VI, të vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga relatori i çështjes, z. Ilir Toska, vendosi: Skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit z. {...} nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me vendimin nr.108, datë 09.07.2019 dhe vendimin nr. 109, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e

Shqipërisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Kandidati ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.” Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska!

Para se të kalojmë në votim, ka ndonjë diskutim për argumentimin ezaurues të relatorit dhe të pranuar nga Komisioni?

Atëherë, kalojmë në votim sipas procedurës. Relatori!

**Ilir Toska:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Komisioni!

**Alban Toro:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Kalojmë tek kandidati tjetër, i cili bëhet fjalë për zonjën {...}, relator i së cilës është Alban Toro. {...}! Okej!

**Alban Toro:** Faleminderit!

Atëherë, duke qenë që ‘modus operandi’ këtu edhe procedura e verifikimit të pasurisë dhe figurës është e njëjtë për të gjithë kandidatët, do mundohem të jem pak më konciz.

**Naureda Llagami:** Do t’i tërheqim vëmendje kryetarit tuaj që kur ramë dakord që të jemi konciz, do jemi konciz.

**Alban Toro:** Faleminderit!

Pra, me përcaktimin tim si relator të kësaj kandidateje me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 142, datë 26.07.2019 është proceduar duke kërkuar konfirmim në lidhje me shkaqet e përjashtimit, nëse do të kishte nga kandidatja, në raport me relatorin apo me ndonjë anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor, fakt që u konfirmua që nuk ka patur të tillë dhe më pas u procedua me kalimin/me disponimin e akteve të cilat janë kërkuar më përpara me njoftimin e bërë nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor në datën 10.07.2019, madje edhe me përcaktimin e disa akteve të tjera të cilat mungonin në dokumentacionin që ajo që kishte depozituar pranë sekretarisë, siç ishte certifikata personale, dokumenti që vërteton, pra kjo konfirmon shtetësinë shqiptare, dokumenti që vërteton gradën shkencore në drejtësi, dëshminë e penalitetit dhe duke dhënë një afat të përcaktuar dedlajn (*deadline*) që ishte data 05.08.2019.

Më datë 30.07.2019 kandidatja konfirmon marrjen e këtij njoftimi dhe nga ky moment nga ana e kësaj kandidateje, nuk ka pasur asnjë komunikim elektronik deri më datën 02.09 (megjithëse nga ana jonë është insistuar disa herë), në 02.09.2019, kur kjo kandidate njofton relatorin ndër të tjera si vijon: “Duke ju falënderuar për njoftimin me lejoni t’ju bëj me dije se unë {...} jam zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në pozicionin e zëvendësuesit për Komisioner Publik me vendimin nr. 82/2017 “Për miratimin e listës në bllok të kandidatëve të zgjedhur në institucionet e rivlerësimit, sipas ligjit 84/2016 si dhe aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, status që e gëzoj dhe sot në kuptim të ligjit dhe vendimit të Kuvendit dhe për pasojë i jam nënshtruar një procedure vlerësuese nga institucioni i Parlamentit dhe ONM-ja deri në zgjedhjen përfundimtare me datë 17.06.2017.

Arsye që me motivoi maksimalisht për të qenë një kandidate potenciale për pozicionin e zgjedhur (kujtoj këtu se në këtë proces jam vlerësuar maksimalisht dhe kam qenë pjesë e listës së ONM-së) dhe si rrjedhojë unë kam lejuar dhe autorizuar dhe vazhdoj të jem e monitoruar nga institucionet.

Në këto kushte nuk ka asnjë arsye refuzimi nga ana ime siç jeni shprehur, përkundrazi e vlerësoj si një proces në vazhdimësi në funksion të reformës në drejtësi për të kontribuar në Institucionet e Drejtësisë.

Si përfundim duke shprehur konsideratën për ju dhe institucionin do të preferoja të mos vazhdoja procesin duke ruajtur pozicionin aktual si zëvendësuese për Komisioner Publik duke shpresuar në bashkëpunime të tjera”.

Pra pikërisht ky fakt, ky konfirmim u konsiderua si gjetje në rastin konkret, pasi në vullnetin e lirë, kjo kandidate u tërhoq nga procesi. Kjo dorëheqje është parashikuar në rregulloren nr.75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (Seksioni B, pika 17), ku shprehimisht përcaktohet se kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori i çështjes përgatit relacionin që përshkruan procedurën e zhvilluar dhe projekt-aktin mbi përfundimin e procedurës administrative të verifikimit të kandidatit të tërhequr, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim përpara Komisionit, i cili vendos për dërgimin e çështjes në mbledhjen e Këshillit.

Ky disponim u bë nga ana e relatorit. U dërgua çështja tek Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i cili më pas, pasi e konsideroi/e vlerësoi si të plotë procedurën e verifikimit të ndjekur deri në atë moment, ia kaloi për shqyrtim Këshillit të Lartë Gjyqësor, akt të cilin e keni nëpërmjet relatimit, e dispononi edhe juve.

Kjo është pak a shumë pjesa e dorëheqjes e kësaj kandidateje.

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek propozimi, në qoftë se nuk kemi diskutime?

**Alban Toro:** Më duhet të bëj një pjesë arsyetuese në lidhje me gjetjet, për të arritur/kuptuar konkluzionet dhe pse kam arritur në përgatitjen e projektvendimit për skualifikimin e kësaj kandidateje.

Nga interpretimi i dispozitave kushtetuese dhe atyre të posaçëm, konkretisht neni 136 të Kushtetutës, neni 28, 32 të ligjit “Për statusin e gjyqtarit”, rezulton se e drejta për të kandiduar në zgjedhje është një e drejtë themelore por jo absolute.

Ligji parashikon një proces mbledhjeje faktesh dhe rrethanash të mbështetur në dokumentacionin zyrtar, por njëkohësisht ai garanton një proces të rregullt ligjor, duke e detyruar kandidatin të bashkëpunojë dhe të depozitojë aktet e nevojshme zyrtare që konfirmojnë jo vetëm plotësimin e kritereve ligjore, por të mundësojë dhe të kontrollojë vlerësimin e figurës dhe pasurisë së kandidatit. Për këtë qëllim kandidatët që verifikohen marrin pjesë aktivisht në procesin e verifikimit dhe janë të detyruar të depozitojnë akte që



provojnë ekzistencën e kritereve ligjore të kërkuara për Gjykatën e Lartë. Shprehja e interesit dhe kandidimi është një e drejtë e bazuar ekskluzivisht mbi vullnetin e kandidatit, por që i nënshtrohet respektimit të procedurave, kushteve dhe kritereve ligjore të përcaktuara nga Kushtetuta dhe legjislacioni i sipërcituar.

Në rastin konkret, kandidatja {...} më datën 06.09.2019 njofton relatorin me anë të njoftimit elektronik duke kërkuar tërheqjen me vullnetin e saj të lirë nga kandidimi për në pozicionin e lirë gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur. Instituti i dorëheqjes është një akt vullnetar dhe nuk mund të jetë i kufizuar në kohë. Ai bazohet në vullnetin e lirë të kandidatit për ndërprerjen në çdo kohë të konkurrimit për një pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë dhe për rrjedhim, procedura e verifikimit nuk mund të vijohet më tej, pavarësisht nga faza e procedimit aktual administrativ. Kandidati, me anë të e-mail-it ka shprehur dëshirën e saj për t'u tërhequr nga kandidimi dëshirën e saj për t'u tërhequr nga kandidimi, duke qartësuar dhe siguruar vullnetin përpara Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe për rrjedhim kryerja e procedurës së verifikimit për të gjitha kushtet dhe kriteret e tjera ligjore është e pa nevojshme.

Përfundimisht, kam përgatitur edhe projektvendimin, bazuar në këtë lloj arsytimi. Po lexoj vetëm dispozitivin sepse pak a shumë pjesa ligjore është e njëjtë për të gjithë. Kam propozuar për të vendosur skualifikimin dhe përjashtimin e kandidates znj. {...} nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me vendimin nr.108, datë 09.07.2019 dhe vendimin nr. 109, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit znj. {...}.

Kandidati ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toro!

**Ilir Toska:** Atëherë, mendoj se ka një lapsus në propozimin e bërë nga zoti Toro. Arsyetimi i tij është përpara tërheqjes nga kandidimi të znj. {...}, kështu që referuar edhe vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75 të vitit 2019, jemi përpara ndërprerjes së procedurës së verifikimit. Kështu që, besoj që relatori duhet ta riformuloj disponimin përkatës të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Alban Toro:** Atëherë, po e riformuloj në këtë kontekst.

...përfundimin e procesit të verifikimit të kandidatës {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi, për pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë, të shpallura me vendimin 108-109, datë 09.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Një kopje e këtij vendimi i njoftohet kandidatës znj. {...}.

Kandidati ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toro!

Kalojmë në ndonjë diskutim? Kemi?

Kalojmë në votim sipas rregullores?

Relatori fillimisht.

**Alban Toro:** Dakord.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi propozimin e dhënë nga relatori pas ndryshimeve të bëra në seancën plenare.

Kalojmë tek rasti tjetër.

Kandidati tjetër është zoti {...}, ku relator i të cilit është zoti Ilir Toska.

Po, zoti Toska!

**Ilir Toska:** Atëherë, ju parashtroj relacionin për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, të kandidatit z. {...}.

Meqenëse mu tërhoq vëmendja për përmendjen e të gjitha procedurave të ndjekura nga ana ime si relator i çështjes, të cilat përgjithësisht janë të njëjta për të gjithë kandidatët, po vijoj me pjesën atje ku këta kandidatë kanë ndryshim nga kandidatët e tjerë.

Atëherë, më duhet të them fillimisht se kandidati, z. {...}, ka konkurruar për të tre pozicionet e lira të shpallura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për anëtar të Gjykatës së Lartë, pra qoftë për ekspertizë të veçantë në fushën e të drejtës administrative, civile dhe penale.

Atëherë, nga dokumentacioni i paraqitur nga kandidati, zoti {...}, u konstatua edhe fakti i punësimit të tij si “këshilltar për marrëdhëniet me Parlamentin” i Ministrit të Financave të Republikës së Shqipërisë, gjatë periudhës shtator 2014 - shtator 2015, pra gjatë 10 viteve të fundit para kandidimit.

Fakti i punësimit të kandidatit, z. {...}, “këshilltar për marrëdhëniet me Parlamentin” i Ministrit të Financave të Republikës së Shqipërisë, gjatë periudhës shtator 2014 - shtator 2015, pasqyrohej në Jetëshkrimin e dorëzuar nga ai.

Po ashtu, një fakt i tillë, pasqyrohej edhe në kopjen e njëzuar me origjinalin të dokumentit “Librezë Pune”, dorëzuar nga kandidati.

Gjithashtu, në formularin e Deklaratës “Për mos mbajtjen e funksioneve politike në administratën publike”, plotësuar dhe dorëzuar nga kandidati, z. {...}, ai ka deklaruar se:

“Nuk kam mbajtur funksione politike në administratën publike, gjatë 10 viteve të fundit para kandidimit.

Theksoj, që pozicioni që unë kam mbajtur si “Këshilltari ligjor dhe për marrëdhëniet me Parlamentin i Ministrit të Financave të Republikës së Shqipërisë”, në vlerësimin tim nuk vlerësohet si funksion politik në kuptim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 49 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, por është vetëm emërtesë “politike” e Ministrit dhe nuk ka përfshirë asnjë funksion të karakterit politik sikurse ka patur për qëllim ligjvënësi duke marrë në konsideratë edhe faktin që nuk kam patur asnjë të drejtë vendimmarrje etj.”.

Po ashtu, Jetëshkrimin e tij, kandidati, z. {...}, ka pasqyruar si punësim edhe atë në pozicionin e “Këshilltarit ligjor pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës”, sipas Kontratës nr. CS (është numri i kontratës) për periudhën janar 2012 - qershor 2012, pra gjatë 10 viteve të fundit para kandidimit.

Marrë shkas nga këto dy fakte të punësimit si më lart të kandidatit, z. {...}, në kuadër të verifikimit të kushtit të kandidimit, atij “të mos ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit”, përcaktuar në nenin 136, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, por edhe në nenin 49, pika 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, më datë 06.08.2019, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të vendimit nr.75/2019, u kërkua informacion dhe dokumentacion për punësimin e kandidatit, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Në përgjigje të kërkesës së Këshillit të Lartë Gjyqësor, me shkresën nr. 14851/1 prot., datë 20.08.2019, (protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 3946/6 prot., datë 22.08.2019), Ministria e Financave dhe Ekonomisë informoi se:

“... arkivi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, disponon aktet e emërimit dhe lirimit për periudhën shtator 2014 - shtator 2015, kur z.{...} ka mbajtur funksionin Këshilltar i Ministrit të Financave”.

Bashkëngjitur kësaj shkrese, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar kopje, të njësuar me origjinalin, të aktit të emërimit dhe të lirimit nga detyra të kandidatit, z.{...}.

Konkretisht, shkresa nr. 12835 prot., datë 19.09.2014, e Ministrit të Financave, me subjekt: Emërim, që ka këtë përmbajtje:

“Në bazë të ligjit nr. 8095, datë 21.03.1996, “Për Shërbimin Civil në Republikën e Shqipërisë”, Kreu II, Pozita Juridike e Funkionarëve Politik, z. {...}, emërohet Këshilltar për Marrëdhëniet me Parlamentin, në Kabinetin e Ministrit të Financave. Marrëdhëniet financiare i fillojnë më datë 18.09.2014”.

Ndërsa sipas shkresës nr. 12613/1 prot., datë 14.09.2015, e Ministrit të Financave, me subjekt: Lirim nga Detyra, ka këtë përmbajtje:

“Në bazë të ligjit nr. 8095, datë 21.03.1996, “Për Shërbimin Civil në Republikën e Shqipërisë”, Kreu II, Pozita Juridike e Funkionarëve Politik, z. {...}, me detyrë Këshilltar i Ministrit të Financave, lirohet nga kjo detyrë me kërkesën e tij për dorëheqje. Marrëdhëniet financiare i ndërpriten më datë 18.09.2015”.

Po ashtu, në përgjigje të kërkesës së Këshillit të Lartë Gjyqësor, me shkresën nr. 7318/1 prot., datë 13.08.2019, (protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 3946/5 prot., datë 14.08.2019), Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë informoi se:

“... z. {...} nuk figuron në regjistrat themeltar të ish-Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE)”.

Pra nga kjo korrespondencë u konfirmua edhe fakti i punësimit të kandidatit, z. {...}, në Ministrinë e Financave, si Këshilltar i ministrit. Ndërkohë që referenca apo fakti i referuar në Jetëshkrimin e tij sa i përket qenies Këshilltar i Ministrit të Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës, nuk është konfirmuar nga institucionet përgjegjëse.

Pas marrjes së informacionit dhe dokumentacionit nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përmes të cilit vërtetohej punësimi i kandidatit, z. {...}, në detyrën e “këshilltarit në Kabinetin e Ministrit të Financave” në periudhën shtator 2014 - shtator 2015, pra gjatë 10 viteve të fundit para kandidimit, duke patur në vëmendje përmbajtjen e nenit 136, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenit 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; nenit 49, pika 2, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; nenit 13 (“Funksionarët politikë”), Kreu II (“Pozita juridike e funksionarëve politikë”), të ligjit nr. 8095, datë 21.03.1996, “Për shërbimin civil në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenit 15, të po këtij ligji; Shtojcën Nr.1, të po këtij ligji; nenit 17 (“Kabinetet”) të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; nenit 30, të po këtij ligji; pikat 5, 6 dhe 7, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 893, datë 17.12.2014, “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm” (dalë në bazë të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”); nenin 2 (“Fusha e veprimit”), të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” si dhe nenin 4 të këtij ligji; pikën 5, të nenit C, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenit 6 (“Kriteret e zgjedhjes së anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit”), të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; pikën 17, të nenit 3, të po këtij ligji, duke vlerësuar së në rastin konkret verifikohej një rrethanë që mund të çonte në

përfundimin se kandidati nuk plotëson një nga kushtet e emërimit si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, unë si relator i çështjes vura në dijeni Komisionin e Zhvillimit të Karrierës, i cili, mbështetur në shkronjën “a”, pika 12, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit nr. 75/2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, me vendimin e datës 28.08.2019, vendosi që:

“Kandidati z. {...} të ftohet për të paraqitur shpjegime lidhur me gjetjen e procedurës së verifikimit, si edhe të çdo dokumentacioni mbështetës të nevojshëm sipas vlerësimit të tij”.

Mbi këtë bazë, më datë 29.08.2019, kandidati, z.{...}, në rrugë elektronike, u njoftua për gjetjen e procedurës së verifikimit, pra në lidhje me kushtin e kandidimit “të mos ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit”, duke u ftuar për të paraqitur shpjegime për gjetjen e procedurës së verifikimit, si edhe të çdo dokumentacioni mbështetës të nevojshëm sipas vlerësimit të tij.

Në Njoftimin “Për gjetjen e procedurës së verifikimit”, kandidatit, z.{...}, iu parashtrua fakti i punësimit të tij si “këshilltar në kabinetin e Ministrit të Financave”, në periudhën shtator 2014 - shtator 2015, si dhe një analizë e legjislacionit në fuqi që përcaktonte këtë funksion si funksion politik.

Brenda afatit pesë ditor, pikërisht me datë 03.09.2019, kandidati, z.{...}, në rrugë elektronike, por edhe fizikisht, dorëzoi në zyrën e protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, shpjegimet e tij.

Në shpjegimet e tij, kandidati, z.{...}, ka parashtruar këto pretendime:

“Së pari për gjetjen që është njoftuar nga Këshillit të Lartë Gjyqësor, kjo pretendohet nga z.{...} që nuk është gjetje, pasi këtë gjë unë ua kam bërë të ditur si në kërkesën për kandidim, ashtu edhe në jetëshkrim, në librezën e punës, në kërkesat për plotësim dokumentacioni, në deklaratën nëse kisha mbajtur apo jo pozicione publike. Kësisoj, marrja e dokumenteve nga Ministria e Financave, sikurse janë akti i emërimit dhe akti i lirimit nga detyra, nuk mund të konsiderohen gjetje në zbatim të vendimit të KLGJ dhe vetë procedurës së verifikimit.

Ndërkohë, lidhur me arsyetimin për këtë “gjetje”, qëndrimi im është si vijon:

Së pari, referenca në shkresat e Ministrit të Financave për emërimin dhe lirimin tim nga detyra, është bërë gabimisht në ligjin nr. 8095, datë 21.03.1996 “Për Shërbimin Civil në RSH”, i ndryshuar, pasi në atë kohë kishte hyrë në fuqi ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin

civil”, i ndryshuar. Prandaj, edhe referenca juaj në këtë ligj dhe përfshirja e përkufizimit të tij porsa i përket “Funksionarëve politik”, është e gabuar dhe nuk mund të ketë vlerë juridike, pasi ky ligj as nuk ka qenë në fuqi kur jam emëruar dhe jam liruar nga detyra dhe nuk është as sot në fuqi. Referenca gabim nga ana e Ministrit nuk i jep fuqi këtij ligji dhe përkufizimeve të tij në lidhje me kërkesën time dhe plotësimin e kritereve që ka caktuar ligji për emërimin si anëtar të Gjykatës së Lartë.

Së dyti, ju i referoheni në arsyetimin tuaj, germës ç), të pikës 1 të nenit 4, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar. Në fakt, ndryshe ngase arsyetoni, në dallim nga ligji i mëparshëm, ky ligj bën një ndarje të ndryshme midis funksioneve që i përkasin kategorisë së nëpunësve civil dhe atyre jo civil, duke mos pasur si kritere dallimi funksionin politik ose civil, por duke bërë midis të tjerash, edhe përjashtimin e veprimit të këtij ligji në një tërësi pozicionesh që nuk lidhen në radhë të parë me funksione politike. Për më tepër referuar përmbajtjes literale të germës ç), të pikës 1 të nenit 4 dhe nenit 2 të këtij ligji, ky ligj, lidhur me funksionarin e kabinetit i referohet vetëm kabinetit të Presidentit, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, Zëvendëskryeministrit, ministri përgjegjës për administratën publike, apo pjesë e kabinetit të një titullari të një institucioni të pavarur apo një funksionari të emëruar nga Kuvendi ose Presidenti, nëse parashikohet nga ligji. Pra në këtë rast, ky ligj përjashton zbatimin e tij vetëm për kabinetin e ministrit që është përgjegjës për administratën publike dhe jo për çdo ministër, duke përfshirë Ministrinë e Financave ku unë kam punuar. Ky kuptim del nga pika 1 e nenit 7 të këtij ligji, i cili saktëson se: "Departamenti i Administratës Publike përgjigjet përpara ministrit përgjegjës për administratën publike". Ndërkohë, që aktualisht prej disa vitesh duke përfshirë vitet 2014 dhe 2015, ministri përgjegjës për administratën publike është "Ministri i Brendshëm".

Po ashtu, ndryshe nga ligji i mëparshëm, ky ligj nuk përkufizon dhe nuk përfshin shprehimisht në përmbajtjen e tij, përkufizimin e funksionarit politik dhe as nuk përcakton as shprehimisht dhe as tërthorazi, pozicionin e Këshilltarit të Ministrit të Financave si "funksion politik". Gjithsesi, ligji nr. 8095/1996 “Për Shërbimin Civil në RSH”, i ndryshuar (aktualisht i shfuqizuar) ashtu edhe ligji nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore" bëjnë një ndarje midis funksioneve politike dhe atyre jo politike jo për qëllime të ushtrimit të funksioneve politike, por vetëm për efekte të emërtesës dhe jo natyrës së detyrës që ushtrojnë, duke pasur si qëllim të vetëm shmangien

e zbatimit të normave për nëpunësit civil në emërimin dhe lirimin e tij nga detyra. Në të njëjtën linjë dhe kuptim është edhe Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 893, datë 17.12.2014, gjithashtu i cituar në njoftimin për gjetjen e procedurës së verifikimit.

Pra porsa më lartë, përfundimi juaj se referuar legjislacionit në fuqi në momentin e emërimit si këshilltar në Kabinetin e Ministrit të Financave, por edhe atij gjatë kohë vazhdimit të ushtrimit të kësaj detyre “funksioni i këshilltarit në kabinetin e ministrit” është përcaktuar si “funksion politik në administratën publike”, është i gabuar dhe i pambështetur si në këtë ligj ashtu edhe në ndonjë normë tjetër ligjore në fuqi në RSH. Ky arsyetim, është i saktë po të kemi parasysh që në këtë rast, interpretimi që është bërë në kuadër të një dispozite e cila ka për qëllim kufizimin e të drejtës time për të kandiduar mbi bazën e pasjes ose jo të një funksioni të mëparshëm politik në 10 vitet e fundit të kandidimit. Kësisoj, interpretimi në radhë të parë nuk mund të çojë në krijimin e një norme të re juridike të paqenë, sikurse praktikisht lë të nënkuptohet interpretimi i bërë dhe në radhë të dytë, interpretimi për qëllime të kufizimit të një të drejtë në zbatim të nenit 17 të Kushtetutës, në lidhje edhe me nenet 3, 4, 5, 116, 122 të dhe Kushtetutës, nuk lejohet porsa kohë norma nuk e përmban atë qartazi dhe shprehimisht, pasi kufizimi duhet të jetë i parashikuar shprehimisht në një ligj dhe nuk mund të vijë si pasojë e një interpretimi. Kjo do të cenonte në thelb këtë garanci kushtetuese timen dhe parimin themelor të së drejtës "In claris non fit interpretatio" duke përfshirë parimin e ndarjes së pushteteve, pasi ju ushtroni atributet e ligjvënësit nëpërmjet krijimit praktikisht një norme të re juridike. Mbi të njëjtin arsyetim, kufizimi i të drejtës time për të kandiduar, duhet të bëhet në përputhje me parimin e proporcionalitetit ose drejtpeshimit të mishëruar po edhe në nenin 17 të Kushtetutës dhe në praktikën e konsoliduar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ky kufizim sipas këtij parimi duhet të bëhet vetëm duke respektuar kushtet si vijojnë:

1. Kufizimi duhet të bëhet vetëm me ligj.
2. Masat duhet të ndërmerren jo mbi baza diskriminuese.
3. Masat duhet të justifikohen nga nevojat e interesit të përgjithshëm.
4. Masat duhet të jenë të përshtatshme për të përmbushur objektivat që ata synojnë.
5. Masat nuk duhet të shtrihen përtej nevojës për të përmbushur objektivin e synuar

(Me fjalë të tjera, ndërhyrja duhet të jetë e nevojshme për një shoqëri demokratike).



Në rastin konkret, ky kufizim i dalë nga një interpretim i tillë, cenon në thelb këtë parim themelor kushtetues pasi:

Nuk bëhet i bazuar në një ligj.

Bëhet mbi baza diskriminuuese, pasi Këshilli i Emërimeve në Drejtësi nuk e ka cilësuar si funksion politik, pozicionin e Këshilltarit të Presidentit të Republikës, porsa i përket z. {...}, fakt ky i bërë i njohur botërisht. Kësisoj, një kriter nuk mund të zbatohet ndryshe për një person sikurse për mua, kur në fakt ligji përcakton se vepron vetëm ndaj ministrit përgjegjës për administratën publike dhe ndryshe ndaj një personi tjetër sikurse atij që ka mbajtur postin e Këshilltarit të Presidentit, ndërkohë që Institucioni i Presidentit të Republikës shprehet saktësisht në ligj dhe Ministri i Financave nuk shprehet fare. Nga ana juaj, mund të arsyetohet që jeni dy institucione të ndryshme, por ky fakt nuk do ta zhbënte diskriminimin e pastër në raport me mua dhe këdo tjetër në pozitën time.

Interpretimi juaj në favor të kufizimit dhe vetë kufizimi ashtu sikurse ju arsyetoni, nuk justifikohet nga nevojat e interesit të përgjithshëm, pasi nuk synon të përmbushë asnjë interes legjitim në kuptim edhe të dispozitës kushtetuese, konkretisht të pikës 4 të nenit 136 të Kushtetutës. Në asnjë rast, ky nen nuk mund të kuptohet i shkëputur nga parimet e përgjithshme themelore kushtetuese ose nenet 3, 4, 5, 7, 17, 116 dhe 122 të Kushtetutës.

Interpretimi dhe kuptimi që ju i jepni ligjit konkretisht përkufizimit që ka bërë ligji nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", në germën ç) të nenit 3, haptazi bie ndesh me pikën 4 të nenit 136 të Kushtetutës. Konkretisht, pika 4, e nenit 136 të Kushtetutës dhe shumë nene të tjera të Kushtetutës, janë ndryshuar dhe kanë hyrë në fuqi në vitin 2016, kohë në të cilën legjislacioni i përmendur nga ana juaj ka qenë në fuqi me përjashtim të ligjit nr. 96/2016. Nga ana tjetër, kjo normë (neni 136) përmban një rezervë absolute kushtetuese duke saktësuar midis të tjerash se "4. Kandidati jo gjyqtar nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit. Kriteria të tjera dhe procedura e përzgjedhjes së gjyqtarit parashikohen me ligj." Pra Kushtetuta nuk ka autorizuar nxjerrjen e ndonjë normë ligjore për të përkufizuar së çfarë do të thotë "funksion politik në administratën publike", por vetëm nxjerrjen e normave për përcaktimin e kriterëve të tjera ligjore. Pra germa ç) e nenit 3 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", është nxjerrje në

shkelje të rezervës absolute kushtetuese, pasi nuk ka përcaktuar vetëm kriteret e tjera, por edhe ka përkufizuar "funksionin politik në administratën publike". Nga ana tjetër, kuptimi i funksioneve politike sipas frymës së kushtetutës dhe qëllimi i pikës 4 të nenit 136 të Kushtetutës është për të bërë të mundur mbrojtjen e interesit të përgjithshëm të ndalimit ose parandalimit të ndikimit të interesave politike në sistemin gjyqësor duke nënkuptuar në këtë mënyrë garantimin dhe ruajtjen e pavarësisë së pushtetit gjyqësor, si vazhdimësi e parimit themelor kushtetues të ndarjes së pushteteve të mishëruar në nenin 7 të Kushtetutës. Po ashtu, Kushtetuta ka përcaktuar si organe dhe funksione politike vetëm organet dhe funksionet kushtetuese që zgjidhen ose emërohen sikurse janë, Kryeministri, anëtarët e Këshillit të Ministrave, zëvendësministri, anëtarët e Kuvendit të Shqipërisë, Kryetarët e njësisë të Pushtetit Vendor dhe anëtarët e Këshillit Bashkiak. Ndërkohë, në kuptimin e përgjithshëm doktrinar, funksione politike ushtrohen nga çdo organ i çdo pushteti shtetëror i cili merr pjesë në ushtrimin e pushtetit shtetëror të RSH. Në këtë kuptim edhe pozita e gjyqtarit, është në vetvete një formë e politikë bërjes pasi gjyqtari në këtë rast merr pjesë në ushtrimin e pushtetit shtetëror gjyqësor të RSH. Pra ndarja që i referohen ligjet e përmendura nga ana juaj, përveçse porsa theksoj më lartë, bëhet vetëm për qëllime të ndarjes së kriterëve për zgjedhjen, emërimin ose lirimin nga detyra dhe jo për të bërë një ndarje midis funksioneve politike dhe jo politike sipas pikës 4 të nenit 136 të Kushtetutës së RSH. Nga ky këndvështrim, çdo përkufizim dhe arsyetim ligjor apo interpretues bie ndesh si me përmbajtjen ashtu edhe me frymën dhe qëllimin e Kushtetutës dhe nuk është i nevojshëm për një shoqëri demokratike.

Së fundmi edhe pse germa ç) e nenit 3 të ligjit 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", është nxjerrje në shkelje të rezervës absolute kushtetuese, përsëri kjo germë përcakton ndryshe ngase arsyetoni ju, konkretisht sikurse vijon:

ç) "Nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike" do të thotë që nuk ka qenë deputet, Kryeministër, Zëvendëskryeministër, ministër, zëvendësministër ose nëpunës, pjesë e kabinetit të Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, Zëvendëskryeministrit ose ministrit, që kryen detyrën e drejtorit të kabinetit, këshilltarit, ndihmësit, zëdhënësit ose sekretarit personal të titullarit të kabinetit".

Sipas formulimi i kësaj germe, në lidhje edhe me fjalinë e pikës 1 të këtij neni "Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:" është e qartë se nga pikëpamja gjuhësore jemi para një fjalie të përbërë me një pjesë kryesore "Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:" dhe me dy pjesë të nënrenditura sikurse janë:

Pjesa e parë: "Nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike" do të thotë që nuk ka qenë deputet, Kryeministër, Zëvendëskryeministër, ministër, zëvendësministër ose nëpunës, pjesë e kabinetit të Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, Zëvendëskryeministrit ose ministrit," dhe

Pjesa e dytë: "që kryen detyrën e drejtorit të kabinetit, këshilltarit, ndihmësit, zëdhënësit ose sekretarit personal të titullarit të kabinetit."

Në rastin tonë, pra edhe pse jemi para një formulimi të keq nga pikëpamja gjuhësore, përsëri në kuptimin që del nga interpretimi gjuhësor si interpretimi më origjinal dhe i drejtë i normës, kuptohet që funksione politike janë funksionet e "Kryeministrit, Zëvendëskryeministrit, ministrit, zëvendësministrit ose nëpunësit, pjesë e kabinetit të Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, Zëvendëskryeministrit ose ministrit. Në rastin tim, unë nuk kam pasur asnjë nga këto funksione. Në pjesën e parë, koha e foljes është e kryer e tejshkuar në formën mohore. Ndërkohë, në rastin e variantit të dytë, i shprehur në pjesën e dytë të nënrenditur, folja është në kohën e tashme "që kryen", çfarë nënkupton, që as ky variant në rastin tim nuk vlen, pasi unë nuk kryej funksionin e këshilltarit të ministrit të financave që nga data 18 shtator të vitit 2015.

Nga ana tjetër, në arsyetimin tuaj, është përdorur teksti i germës "ç)" duke i hequr ose injoruar presjen pas togfjalëshit "ose ministrit", ... duke çuar në këtë mënyrë në një kuptim krejtësisht të ndryshëm të fjalisë dhe duke e shndërruar atë nga një fjali e përbërë me dy pjesë të nënrenditura, në një fjali të përbërë me një pjesë të nënrenditur. Gjithsesi, referenca në ligjin nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", në nenin 6, është korrekte dhe në fakt ky ligj i qëndron besnik Neni C, të aneksit të Kushtetutës që ka një përcaktim të njëjtë me nenin 136 të Kushtetutës porsa i përket kriterit të mospasjes së funksionit politik.

Përfundimisht, vlerësoj që funksioni i Këshilltarit të Ministrit të Financave nuk përbën funksion politik sipas kuptimit të nenit 49 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", pasi midis të tjerash nuk përbën

një funksion të vërtet në kuptim të Kushtetutës dhe ligjit si nga pikëpamja politike ashtu edhe ajo administrative. Kjo për shkak se këshilltari nuk ka të drejtë firme, nuk përfaqëson institucionin në asnjë rrethanë dhe nuk merr asnjë lloj vendimi. Praktikisht, këshilltari ekziston vetëm për qëllime të ndihmës ndaj titullarit dhe jo për ndonjë person tjetër të tretë. Në rastin konkret, unë kam pasur detyrën e këshilltarit juridik dhe të atij për marrëdhëniet me Parlamentin. Kjo gjë del qartazi nga përshkrimi i detyrave që kam pasur, dokument i cili gjendet në arkivin e Ministrisë së Financave. Pra, unë jo vetëm që nuk kam ushtruar funksion politik, por përkundrazi, funksioni im ka qenë këshillimi për të respektuar ligjin dhe kushtetutën; pra për të kufizuar veprimin politik të ministrit brenda kufijve ligjor dhe kushtetues”.

Marrë shkas nga pretendimet e ngritura nga kandidati në shpjegimet e tij, në lidhje me gjetjen e procedurës së verifikimit, për një verifikim sa më të plotë të kushtit si më lart të kandidimit, pra atij “të mos ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit”, më datë 04.09.2019, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të vendimit nr. 75/2019, u kërkua interpretim/opinion ligjor nga organi i publik, i pavarur, i specializuar, përgjegjës për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, Komisioneri për Mbikëqyrjen në Shërbimin Civil, në lidhje me klasifikimin e funksionit të këshilltarit pjesë e kabinetit të ministrit, për periudhën nga viti 2014 dhe në vijim.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, me shkresën nr. 1436/1 prot., datë 06.09.2019 (protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 4327/1 prot., datë 06.09.2019), Komisioneri për Mbikëqyrjen në Shërbimin Civil, pas një analize të legjislacionit në fuqi për administratën shtetërore, në interpretimin/opinionin e tij ligjor ka arritur në përfundimin se:

“... pozicioni këshilltar në kabinetin e ministrit, në çdo ministri, gëzon statusin e funksionarit politik, i cili përjashtohet nga shërbimi civil sipas nenit 2, “Fusha e veprimit”, germa “gj” të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar”.

Lidhur me këtë përgjigje dhe këtë opinion marrë nga Komisioneri i Shërbimit Civil, ajo iu njoftua zotit {...} më datë 09.09.2019, në rrugë elektronike, ndërkohë që më datë 09.09.2019, po në rrugë elektronike, kandidati, z.{...}, paraqiti shpjegime shtesë në lidhje me gjetjen e procedurës së verifikimit.

Në shpjegimet e tij shtesë, kandidati, z. {...}, ka parashtruar se:

“Me anë të postës elektronike, me datë 6 shtator 2019, më është njoftuar vendimi juaj “Për marrjen e një interpretimi/opinionit ligjor nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në lidhje me klasifikimin e funksionit të këshilltarit pjesë e kabinetit të ministrit, për periudhën nga viti 2014 dhe në vijim”, si dhe mendimi i marrë. Lidhur me këtë vendim dhe mendimin e marrë, brenda afatit prej 3 (tre) ditësh nga dita e marrjes, dëshiroj t’ju shpjegoj si vijon:

1. Vendimi juaj për të kërkuar një interpretim/opinion ligjor nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në lidhje me klasifikimin e funksionit të këshilltarit pjesë e kabinetit të ministrit, për periudhën nga viti 2014 dhe në vijim, është në kundërshtim të hapur me statusin kushtetues të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe cenon pavarësinë e këtij organi kushtetues që garantohet nga neni 147 në lidhje edhe me nenin 147/a të Kushtetutës së RSH. Pavarësia e një institucioni në raport me vendimmarrjen e tij nuk nënkupton vetëm ndalimin e ndërhyrjes së organeve të tjera në vendimmarrje, por edhe në ndalimin e ndikimit në çdo lloj mënyrë në vendimmarrjen e këtij institucioni dhe në bindjen e secilit prej anëtarëve. Marrja e një mendimi nga një organ tjetër që nuk e parashikon kushtetuta, përbën drejtpërdrejtë ndërhyrje në pavarësinë e këtij institucioni, pasi çdo mendim apo interpretim përbën formë ndikimi në vendimmarrje. Në fakt, referuar neneve 147, 147/a dhe 134 të Kushtetutës, Këshillit të Lartë Gjyqësor mund të kërkojë mendim vetëm nga Gjykata Kushtetuese, të cilës mund t’i drejtohet me kërkesë në përputhje me nenin 131 të Kushtetutës së. Çdo institucion tjetër nuk mundet as tërthorazi dhe as drejtpërdrejtë të përzihet apo të shfaqë mendime qoftë edhe me kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në lidhje me çështje në kuadër të vendimmarrjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Edhe nëse marrja e mendimit do të vlerësohej e ligjshme, përsëri kërkimi i mendimi dhe vetë mendimi i dhënë nuk ka asnjë kuptim, porsa kohë, ju i kërkoni mendim këtij institucioni për veprimtari dhe persona të cilat nuk i ka objekt të punës. Konkretisht, referuar nenit 14 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ky institucion nuk ka kompetencë as të japë mendim për Këshillit të Lartë Gjyqësor ose ndonjë institucion tjetër dhe as të merret me interpretimin në lidhje me klasifikimin e funksionit të këshilltarit pjesë e kabinetit të ministrit, për periudhën nga viti 2014 dhe në vijim. Në këtë këndvështrim lind pyetja; si mund të jap mendim dhe të merret në konsideratë një mendim

për diçka që një institucion nuk ka asnjë kompetencë dhe nuk ka asnjë njohuri të thelluar mbi këtë çështje? Gjithashtu, unë nuk kam pretenduar asnjëherë të kem qenë nëpunës civil, por thjesht pretendoj që në kuptim të nenit 136/4 të Kushtetutës dhe germës ç) të nenit 3 të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", nuk kam ushtruar ndonjëherë ndonjë funksion politik dhe nuk kam ndalim për të kandiduar.

Interpretimi ligjor nuk është çështje institucionale më shumë sesa çështje njohurish të thelluara shkencore dhe profesionale. Në rastin konkret, referuar edhe mendimit të dhënë, rezulton të jetë një mendim i cili nuk ka kuptuar drejtë as përmbajtjen e vetë ligjit, pasi referuar përmbajtjes literale të germës ç), të pikës 1 të nenit 4 dhe nenit 2 të këtij ligji, ky ligj, lidhur me funksionarin e kabinetit i referohet vetëm kabinetit të Presidentit, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, Zëvendëskryeministrit, ministri përgjegjës për administratën publike, apo pjesë e kabinetit të një titullari të një institucioni të pavarur apo një funksionari të emëruar nga Kuvendi ose Presidenti, nëse parashikohet nga ligji. Pra në këtë rast, ky ligj përjashton zbatimin e tij vetëm për kabinetin e ministrit që është përgjegjës për administratën publike dhe jo për çdo ministri duke përfshirë Ministrinë e Financave ku unë kam punuar. Ky kuptim del nga pika 1 e nenit 7 të këtij ligji, i cili saktëson se: "Departamenti i Administratës Publike përgjigjet përpara ministrit përgjegjës për administratën publike". Ndërkohë që, aktualisht, prej disa vitesh duke përfshirë vitet 2014 dhe 2015, ministri përgjegjës për administratën publike është "Ministri i Brendshëm". Këtë fakt, lehtësisht të kuptueshëm, dhënësi i mendimit e injoron ose nuk e kupton siç duhet, pasi ligji nuk zbatohet në këtë rast për çdo ministri, por vetëm për ministrin që është përgjegjës për administratën publike, që është Ministria e Brendshme.

Së fundmi, sikurse edhe e kam theksuar në shpjegimet e paraqitura më shkrim para jush, edhe nëse kuptimi i legjislacionit të referuar nga ana juaj, do të ishte sikurse arsyetoni ju, përsëri theksoj që në kohën kur unë jam emëruar këshilltar i ministrit, ushtrimi i këtij funksioni nuk përbënte ndalim për të kandiduar për anëtar të Gjykatës së Lartë sipas legjislacionit të kohës. Pra legjislacioni në fuqi, nuk më kërkonte mua të bëja një kujdes të veçantë lidhur me këtë aspekt, në kohën kur u emërova. Ndërkohë, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe praktika e Gjykatës Kushtetuese, ndalon fuqinë prapavepruese të ligjit i cili cenon të drejta të fituara apo shkakton pasoja mbi marrëdhënie të lindura përpara hyrjes në fuqi të tij. Kjo nënkupton që ndalimi nuk mund të ketë efekt ndaj meje, porsa kohë në

kohën e emërimit nuk përbënte ndalim dhe mua nuk më kërkohet të bëja kujdes në raport me ambiciet e mia për të konkurruar në këtë pozicion në të ardhmen, sikurse kam bërë aktualisht. Një zbatim i tillë është i ndaluar nga Kushtetuta, pasi cenon parimet themelore kushtetuese duke përfshirë sigurinë juridike në raport me të drejtat e fituara më parë dhe pasojat që vijnë nga veprimet ose mosveprimet e kryera në një kohë të mëparshme për të cilat ligji i kohës nuk kishte penalizime. Me fjalë të tjera, zbatimi i ndalimit në rastin konkret, përbën edhe një lloj dënimi pa ligj ndaj meje për veprime të kryera në kohën e mëparshme, për të cilat ligji nuk parashikonte dënime në formën e ndalimeve sikurse ligji aktual.

Unë mendoj që lidhur me gjykimin e kësaj çështjeje, fakti që edhe ju i keni kërkuar mendim një institucioni tjetër (edhe pse në vlerësimin tim nuk duhej bërë), tregon që ekziston një paqartësi mbi kuptimin e shprehjes “Nuk ka ushtruar funksione politike... në rastin e Këshilltarit të Ministrisë të Financave”. Në fakt, sikurse kam shpjeguar edhe më parë, gjykoj që i vetmi ligji që Këshillit të Lartë Gjyqësor duhet t’i referohet, është ligji 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe Kushtetuta e RSH. Në këtë pikëpamje, nëse Këshillit të Lartë Gjyqësor ka paqartësi apo nuk është e sigurt mbi kuptimin kësaj shprehjeje, në cilësinë edhe të një personi që ka shprehur interes për kandidim, ju kërkohet t’i drejtoheni Gjykatës Kushtetuese në përputhje me germën ë) të nenit 134 dhe germën a) të nenit 131 dhe pikës 1 të nenit 124 të Kushtetutës, me kërkesë me objekt “Interpretimin e pikës 4 të nenit 136 të Kushtetutës, si dhe vlerësimin e përputhshmërisë së germës ç) të nenit 3 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë në lidhje edhe me nenet 3, 4, 5, 15, 17, 18, 116 dhe 122 të saj dhe përputhjen e kësaj norme me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, konkretisht me nenet 1, 7, 18 të saj”. Interpretimi nga Gjykata Kushtetuese është i domosdoshëm sidomos nëse i referohemi edhe arsytimit të bërë nga unë në pikën 4 të kësaj shkrese.

Porsa më lartë, në lidhje me këtë çështje, kërkohet që ky mendim të mos merret parasysh dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor të mos marr mendime të tjera dhe të mos ndikohet nga asnjë person ose institucion tjetër, me përjashtim të Gjykatës Kushtetuese. Gjithashtu, në çdo rast, përpara se të merrni një vendim përfundimtar mbi këtë çështje, në respektim

të së drejtës time për proces të rregullt, kërkoj që të dëgjohem personalisht nga Këshillit të Lartë Gjyqësor përpara se ju të shpreheni me vendim”.

Këto ishin edhe shpjegimet shtesë të kandidatit, z. {...}.

Nëse ka ndonjë pyetje, mund të jap ndonjë sqarim.

Gjithsesi, ju sjell në vëmendje se një nga kërkesat që ka bërë në shpjegimet shtesë z. {...}, është të dëgjohet personalisht përpara Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Po!

Illir Toska: Atëherë, në lidhje me kërkesën që ka bërë kandidati për t’u dëgjuar personalisht përpara Këshillit të Lartë Gjyqësor, ju sjell në vëmendje se referuar vendimit nr. 75 të vitit 2019, Këshilli shqyrton mbi akte. Në njoftimin që i kemi bërë kandidatit, i kemi theksuar këtë gjë, që Këshilli operon mbi akte. Gjithsesi, në pikëpamje procedurale, meqenëse na është bërë një kërkesë, do duhet që Këshilli të shprehet për këtë.

Unë si relator i çështjes, meqenëse vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor ngarkon gjithmonë relatorin që të shprehet i pari, mendoj se kjo kërkesë nuk duhet të pranohet, sa kohë është i garantuar procesi i rregullt ligjor. Kandidatit i janë marrë në dy raste të gjitha shpjegimet e mundshme që ai ka lidhur me gjetjen e procedurës. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Atëherë, ta kalojmë në votim kërkesën e kandidatit, sipas propozimit që bëri relatori, i cili thotë që mos ta pranojmë? E hedhim në votim? Jemi dakord me propozimin e relatorit për mostrajtimin e kërkesës?

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Dakord.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, vijojmë lidhur me përfundimin e propozimit nga ana juaj?



*Ilir Toska:* Meqenëse nuk pati ndonjë pyetje, po vijoj me diskutimet në lidhje me pretendimet që ka parashtruar zoti {...}, sa i përket gjetjes së procedurës së verifikimit. Konkretisht, në cilësinë e relatorit të çështjes mendoj se gjetja e procedurës së verifikimit është një rrethanë faktike dhe ligjore përmes të cilës vërtetohet që kandidati, z.{...}, nuk përmbush njërin prej kushteve dhe kriterëve të kandidimit, pikërisht atë “të mos ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit”, përcaktuar nga neni 136, pika 4, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si edhe neni 49, pika 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Gjetja e procedurës së verifikimit, vërtetohet përmes dokumentacionit që është referuar edhe në relacion nga përmbajtja e të cilave arrihet në përfundimin se kandidati, z.{...}, gjatë 10 viteve të fundit para kandidimit, ka qenë i punësuar në një funksion politik në administratën shtetërore, pjesë e administratës publike, pikërisht si “këshilltar në Kabinetin e Ministrit të Financave”.

Nga ana tjetër, gjetja e procedurës së verifikimit, sa i përket ligjit, vërtetohet përmes analizës ligjore, duke patur parasysh të gjitha dispozitat ligjore që janë cituar edhe në relacion, i cili është njoftuar edhe kandidati, z.{...}, dhe unë s’po i përsëris.

Më duhet të theksoj që referenca ligjore që përcakton ndalimin e kandidimit në lidhje me kushtin ndalues atë “të mos kenë mbajtur funksione politike në administratën publike gjatë 10 viteve të fundit para kandidimit”, përcaktohet në pikën 4 të nenit 136 të Kushtetutës, në pikën 2, shkronja “b”, të nenit 49, të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, që është e lidhur me shkronjën “ç”, të nenit 2 të këtij ligji.

Nga ana tjetër, në arritjen e përfundimit se kandidati, z.{...}, nuk plotëson kushtin e kandidimit si më lart, vlen të mbahet parasysh edhe ligji i zbatuar nga Ministri i Financave në rastin e emërimit dhe lirimit nga detyra e këshilltarit të kabinetit të z.{...}, konkretisht ligji “Për shërbimin civil”. Citimi i kësaj dispozite është për të bërë të qartë kuptimin dhe zbatimin që ka pasur autoriteti emëruar në rastin e emërimit të z.{...} në funksionin e këshilltarit në kabinetin e tij, pra Ministri i Financave.

Po kështu vlen të mbahet në konsideratë edhe përcaktimi i bërë në ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, neni 17, ku përcaktohet edhe kabineti i ministrit, ndër ta si pjesë e tij është edhe këshilltari.

Të gjitha citimet e bëra në ligjet “Për shërbimin civil” apo ligjin “Për administratën shtetërore” janë bërë në funksion të asaj që ligjvënësi në rastin e përcaktimit të bërë në shkronjën “ç” të nenit 2, të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” i është referuar pikërisht legjislacionit të veçantë në lidhje me funksionarët politik, duke përfshirë brenda shprehjes “funksione politike” të gjithë funksionet politike sipas ligjeve të veçanta, duke mos përjashtuar asnjë prej këtyre funksioneve.

Mendoj se pretendimet e kandidatit, z.{...}, se funksioni “këshilltar në Kabinetin e Ministrit të Financave” nuk klasifikohet si “funksion politik në administratën publike” në kuptim të nenit 136, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si edhe të nenit 49, pika 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, janë të pabazuara.

Konkretisht, mendoj se nuk qëndron pretendimi i kandidatit se gjetja e procedurës së verifikimit njoftuar atij nuk ishte “gjetje” meqenëse faktin e punësimit të tij si “këshilltar në Kabinetin e Ministrit të Financave” ai e kishte bërë vetë të ditur në dokumentacionin e kandidimit. Mendoj se kandidati ndan një kuptim të ndryshëm të konceptit “gjetje të procedurës së verifikimit” sipas vendimit nr. 75/2019, e cila në vetvete nuk nënkupton thjesht një fakt të caktuar, por një fakt të rëndësishëm për procedurën e verifikimit, vërtetimi i të cilit, shoqëruar me një analizë ligjore të ligjit të zbatueshëm, ka aftësinë të passjell/prodhojë një pasojë/efekt të caktuar në procedurën e verifikimit të atij kandidati. Nisur nga kjo, kandidati është njoftuar për faktin e vërtetuar përmes dokumenteve zyrtare (deklaruar paraprakisht edhe prej tij), sikundër ai është njoftuar edhe për analizën ligjore të këtij fakti, elemente këto që së bashku formojnë “gjetjen e procedurës së verifikimit”, gjetje kjo e aftë për të passjell skualifikimin e kandidatit nga procedura konkurruese publike ku ai ka marrë pjesë. Nga ana tjetër, duke u njoftuar për “gjetjen e procedurës së verifikimit”, kandidatit i është siguruar e drejta për t’u mbrojtur në një procedurë administrative, pra e drejta për të parashtruar shpjegimet e tij rreth gjetjes së kësaj procedure me pasoja të mundshme për të drejtat e tij, sikundër edhe për të paraqitur dokumente mbështetës për pretendime e tij eventuale.

Mendoj se nuk qëndron pretendimi i kandidatit, z.{...}, në lidhje me referencat ligjore të bëra nga Ministri i Financave në aktin e emërimit dhe të lirimit nga detyra e “këshilltarit në kabinetin e ministrit”. Pasqyrimi, në rastin e njoftimit të gjetjes së

procedurës së verifikimit, i referencës ligjore të përdorur nga Ministri i Financave në aktin e emërimit dhe të lirimit nga detyra të z.{...}, është bërë jo vetëm për korrektesë të pasqyrimin me besnikëri të përmbajtjes së këtyre akteve, por edhe për të evidentuar ligjin mbi të cilin është mbështetur Ministri i Financave, për të kuptuar procesin ligjor të realizuar në atë rast dhe, përmes tij, klasifikimin e bërë nga vetë organi i emërtesës të funksionit (civil ose politik) ku z.{...} është emëruar dhe ka ushtruar. Nga vete referenca ligjore e përdorur nga Ministri i Financave, duket që për atë, emërimi dhe lirimi nga detyra i z.{...}, është bërë për një funksion politik. Nëse referenca ligjore e përdorur nga Ministri i Financave në rastin e emërimit dhe të lirimit nga detyra të z.{...}, është e gabuar, sikundër kandidati pretendon, kjo nuk bën të gabuar përmendjen e kësaj reference në aktin e njoftimit të gjetjes së procedurës së verifikimit. Gjithsesi, në aktin e njoftimit të gjetjes së procedurës së verifikimit është bërë kujdes të parashtrohet çdo dispozitë ligjore relevante në lidhje me këtë çështje, pra atë të punësimit të funksionarëve politikë.

Mendoj se nuk qëndron edhe pretendimi tjetër i kandidatit në lidhje me përmbajtjen dhe analizën e nenit 2 (shkronja “b”) dhe nenit 4, pika 1, shkronja “ç”, të Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

Këto të dy dispozita nuk kanë pësuar ndryshime, sikurse kandidati pretendon. E gjithë problematika që kandidati ngre është që ligji “Për shërbimin civil”, nga fusha e zbatimit të këtij ligji, përjashtohet ministri përgjegjës për administratën publike. Që në fakt, përjashtohet çdo ministër, -kështu është kuptimi i ligjit dhe nuk ka se si të përjashtohet vetëm një ministër dhe të mos përjashtohen të gjithë ministrat, ndërsa dihet që janë funksionarët politikë në administratën shtetërore.

Është e qartë që pretendimi i zotit {...} se përjashtohet vetëm ministri përgjegjës për administratën publike është në funksion të përcaktimeve të bërë në lidhje me kabinetet, duke pretenduar që përjashtohen apo konsiderohen si funksionarë politikë vetëm anëtarët e kabinetit, pjesë e ministrit përgjegjës për administratën publike. Në fakt, kabinetet janë për çdo ministri dhe çdo ministër, duke qenë funksionarë politikë edhe kabinetet e tyre, sipas ligjit “Për administratën shtetërore”, konsiderohen si funksione politikë.

Mendoj se nuk qëndron edhe pretendimi i kandidatit lidhur me analizën që i bëhet shkronjës “b” të nenit 2 dhe nenit 4, pika 1, shkronja “ç”, të ligjit.

Ligji “Për nëpunësin civil”, ligji nr. 152/2013, sikurse pretendon kandidati, nuk përmban rregullime të shprehura drejtpërdrejt për “funksionarët politikë”. Por, ndryshe nga sa pretendon kandidati, edhe ligji pararendës për nëpunësin civil, pra ligji nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”, nuk ka përmbajtur rregullime të kësaj natyre. Pozita juridike e funksionarëve politikë, prej vitit 1996, pra edhe gjatë periudhës kur në fuqi ka qenë ligji më lart, pra 8549/1999, është rregulluar nga një ligj tjetër, pikërisht nga ligji nr. 8095, datë 21.03.1996, “Për shërbimin civil në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8300, datë 02.03.1998 (Kreu II).

Nga ana tjetër, ligji 152/2013, duke patur për qëllim rregullimin e marrëdhënies juridike ndërmjet shtetit dhe nëpunësit civil, pra marrëdhënien e shërbimit civil, indirekt, përmes përjashtimeve të shprehura nga fusha e zbatimit të tij, ka përcaktuar, ndër të tjerë, edhe “funksionarët politikë”, funksionarë këta të cilët, sa i përket administratës shtetërore, janë përcaktuar në mënyrë të shprehur në ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”. Në këtë ligj, përveç përcaktimeve për qëllimin dhe fushën e zbatimit të tij, definicioneve për administratën shtetërore dhe organizimin e saj, gjenden rregullime edhe për “kabinetin e ministrit”, që përcaktohet si strukturë që mbështet drejtpërdrejt ministrin në ndjekjen e politikave përkatëse, realizimin e objektivave, si dhe vlerësimin e zbatimit të tyre, por që nuk është pjesë e strukturës hierarkike të ministrisë, ndërsa funksionarët e kabinetit nuk ushtrojnë asnjë kompetencë drejtuese ose administrative mbi stafin ministror (neni 11 i këtij ligji). Ndërkohë, në nenin 17 (“Kabinetet”), përcaktohet se kabineti i ministrit mund të ketë ndër të tjerë edhe këshilltarë, të cilët kanë statusin e funksionarëve politikë, sipas ligjit.

Thënë sa më lart, ligji për nëpunësin civil, qoftë ai i vitit 1999, ashtu dhe ai i vitit 2013, kanë patur për qëllim rregullimin e marrëdhënies së shërbimit civil, duke përcaktuar dhe funksionet për nëpunësit civil, ndërkohë që indirekt, përmes përjashtimeve nga fusha e veprimit të tyre, ato kanë përcaktuar dhe funksionet për nëpunësit jo civil, ku përfshihen dhe funksionarët politikë, të cilët janë përcaktuar me ligje të tjera të veçanta.

Nga sa më sipër, mendoj se nuk qëndron edhe pretendimi i kandidatit, z.{...}, se ligji nr. 152/2013 dhe ligji nr. 90/2012, “bëjnë një ndarje midis funksioneve politike dhe atyre jo politike jo për qëllime të ushtrimit të funksioneve politike, por vetëm për efekte të emërtesës dhe jo natyrës së detyrës që ato ushtrojnë.

Në fakt, ligji nr. 90/2012, sa i përket nëpunësve pjesë të kabinetit të ministrit, ku përfshihen dhe këshilltarët, në mënyrë të shprehur dhe pa asnjë ekuivok ka përcaktuar se ata kanë statusin e funksionarëve politikë në administratën shtetërore, që është pjesë e administratës publike.

Një përcaktim i tillë ligjor është e pamundur të injorohet mbi arsyetimin se ai nuk ka qenë qëllimi i ligjit, ndërkohë që ligji ka përcaktuar edhe natyrën e detyrave, përfshirë dhe të këshilltarëve të kabinetit të ministrit, pikërisht në mbështetje të drejtpërdrejt të ministrit për ndjekjen e politikave përkatëse, për realizimin e objektivave, si dhe për vlerësimin e zbatimit të tyre. Fakti që nëpunësit e kabinetit të ministrit, përfshirë dhe këshilltarët, nuk kanë kompetencë drejtuese ose administrative mbi stafin ministror, nuk mund të çojë në përfundimin se ata nuk janë funksionarë politikë. Përkundrazi, sipas ligjit, ata janë të tillë, por pa patur këto kompetenca, të cilat ligji ua ka dhënë funksionarëve më të lartë politikë në administratën shtetërore, ndër ta dhe ministrit, në mbështetje të drejtpërdrejt të të cilit këshilltarët ushtrojnë funksionin këshillues të tyre.

Mbi sa më lart, mendoj se mund të arrihet në përfundimin se referuar legjislacionit në fuqi në momentin e emërimit të kandidatit, z.{...}, si këshilltar në Kabinetin e Ministrit të Financave, por edhe atij gjatë kohë vazhdimit të ushtrimit të kësaj detyre nga ai, “funksioni i këshilltarit në kabinetin e ministrit” është përcaktuar si “funksion politik në administratën publike”.

Vlen të ritheksohet se përcaktimi i qenies funksionar politik i “këshilltarit të kabinetit të ministrit”, është një përcaktim i bërë nga ligji, pika 1, e nenit 17, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, përcaktim ky që është konsideruar më pas edhe në shkronjën “ç”, të nenit 2, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Nga ana tjetër, është akti themeltar juridik më i lartë i shtetit shqiptar, Kushtetuta, ajo që ka përcaktuar si kusht për emërimin në Gjykatën e Lartë të kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur, atë të “të mos kenë mbajtur funksione politike në administratën publike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit”. Parashikimi i këtij kushti kushtetues, pra atij të përcaktuar në pikën 4 të nenit 136 të Kushtetutës edhe në nenin 49, pika 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, mendoj se nuk mund të përbëj shkak për të vënë në diskutim dhe, për më

tepër, për të arritur në përfundimin për papajtueshmërinë me Kushtetutën të këtij parashikimi ligjor, për sa kohë ky rregullim është përcaktuar shprehimisht në Kushtetutë, ndërsa ligji i veçantë thjesht ka ripërsëritur atë, përveç se, për të bërë atë njëlloj të zbatueshëm, ka përcaktuar kuptimin konkret të saj. Po ashtu, mendoj se nuk mund të vihet në diskutim kushtetutshmëria e shkronjës “ç”, të nenit 2, të ligji “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, pasi, ndryshe nga sa kandidati pretendon, përcaktimi i kuptimit të termave të përdorur në këtë ligj nuk ka nevojë për autorizim nga Kushtetuta, përveç se, kuptimi i dhënë në këtë rast për nocionin “funsione politike në administratën publike”, sikurse dhe më lart parashtrua, është i njëjtë me legjislacionin e veçantë të fushës. Për rrjedhojë, mendoj se nuk qëndron pretendimi i kandidatit, për kufizimin pa ligj të të drejtës së tij për të kandiduar si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për sa kohë ky kufizim është bërë nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e cila nuk ka marrë përsipër të specifikojë funksionet politike, pra nuk ka bërë asnjë dallim për funksionet dhe funksionarët politikë në administratën publike, të cilët, nga ana tjetër, janë përcaktuar shprehimisht në legjislacionin përkatës, përveç se në Kushtetutë, edhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Duket që ky kufizim kushtetues është vendosur pikërisht për atë që pranohet edhe nga vetë kandidati, pra për të shmangur ndikimet politike në sistemin gjyqësor, veçanërisht në organin më të lartë të pushtetit gjyqësor, Gjykatën e Lartë, me qëllim garantimin e pavarësisë së këtij pushteti dhe rritjen e besimit të publikut sa i përket integritetit dhe imazhit të anëtarëve të Gjykatës së Lartë, pra për një qëllim që i përgjigjet interesit publik të miradministrimit të drejtësisë.

Mendoj se nuk është i bazuar në ligj pretendimi i kandidatit se si funksione politike apo funksionarë politikë në administratën publike duhet të konsiderohen vetëm ato që parashikohen në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Si dhe më lart u parashtrua, Kushtetuta nuk ka marrë përsipër të specifikojë funksionet politike, pra nuk ka bërë asnjë dallim dhe përjashtim për funksionet dhe funksionarët politikë në administratën publike.

Mendoj se nuk qëndron pretendimi i kandidatit, për zbatimin, mbi baza diskriminuese ndaj tij, të kushtit skualifikues nga kandidimi të përcaktuar në nenin 136, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si edhe në nenin 42 (*lapsus neni 42, duhet neni 49*), pika 2, shkronja “b”, të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke referuar për këtë në një vendimmarrje të një organi tjetër

kushtetues (Këshillit të Emërimeve në Drejtësi), për lejimin e kandidimit të një kandidati për një funksion të caktuar (Inspektor i Lartë i Drejtësisë).

Pavarësisht pretendimit për diskriminim, kandidati, z.{...}, në thelb nuk referon ndonjë mënyrë të vepruari nga Këshilli i Lartë Gjyqësor të orientuar mbi paragjykime të gjinisë, racës, fesë, etnisë, gjuhës, bindjeve politike, fetare a filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësisë prindërore të tij, sikurse përcaktohet në nenin 18, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Përkundrazi, kandidati, përmes këtij pretendimi, në thelb, kërkon që Këshilli i Lartë Gjyqësor të trajtojë rastin e tij njëlloj sikundër ka vepruar Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në një rast që ka qenë për shqyrtim përpara këtij organi kushtetues. Pra, kandidati në fakt kërkon nga Këshilli i Lartë Gjyqësor respektimin e parimit të barazisë para ligjit, sipas nenit 18, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo kërkesë e kandidatit mendoj se është e papranueshme ligjërisht. Çdo organ i administratës publike ka detyrimin që gjatë veprimtarisë së tij të respektojë Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligjet dhe aktet e tjera normative në fuqi. Vendimi i një organi publik nuk është i detyrueshëm për organet e tjera publike, përveç kur parashikohet ndryshe në ligj. Përtej kësaj, referuar jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore. Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia para ligjit dhe në ligj prezumon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta. Në rastin konkret, pavarësisht natyrës së njëjtë të proceseve para dy organeve publike të ndryshme (verifikim të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit), nuk ekzistojnë të dhëna mbi të cilat të mund të thuhet që jemi para të njëjtave kushte faktike dhe ligjore të kandidatëve.

Nga sa më sipër, në përfundim, mendoj se procedurat e verifikimit për kandidatin, z.{...}, në lidhje me kushtin e kandidimit “të mos ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit”, janë të plota, prandaj, ndërsa konstatohet që kandidati është në kushtet e këtij ndalimi, nuk është e nevojshme vijimi i procedurës së verifikimit për kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit.

Për sa më lart, mendoj se Këshilli i Lartë Gjyqësor është para rastit për të vendosur skualifikimin e kandidatit z. {...} dhe përjashtimin e tij nga procedurat e emërimit në tre pozicionet e lira të shpallura për në Gjykatën e Lartë, ato në fushat e të drejtës administrative, të drejtës civile dhe të drejtës penale.

Në lidhje me këtë propozim, në cilësinë e relatorit të çështjes, në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në vendimin nr. 75/2019, kam përgatitur edhe projekt vendimin përkatës, që është pjesë e materialeve të mbledhjes për këtë çështje.

Baza ligjore është thënë. Përjashtimi është vetëm referenca që bëhet në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” që është shkronja “b”, pika 2 e nenit 49, në lidhje me shkronjën “ç” të nenit 2 të këtij ligji. Ndërsa urdhërimi final është ky: “Skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit z. {...} nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me vendimin nr.108, datë 09.07.2019, vendimin nr. 109, datë 09.07.2019 dhe vendimin nr.110, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Kandidati ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.” Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, kalojmë në votim të projektvendimit të propozuar nga relatori apo kemi ndonjë diskutim paraprak? Kemi?

Jo!

Kalojmë në votim!

Fillo relatori!

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.



**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli miraton propozimin sipas projektvendimit të bërë nga relatori dhe Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Kalojmë tani tek kandidatja tjetër që bëhet fjalë për zonjën {...}, relatore e së cilës është zonja Marçela Shehu.

**Marçela Shehu:** Faleminderit, Kryetare!

Kandidatja {...} ka kandiduar për një pozicion në Gjykatën e Lartë, në fushën e së drejtës civile, sipas vendimit nr.109, datë 09.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Këshilli, me vendimin nr. 142, datë 26.07.2019, ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit dhe ka caktuar relatorët përkatës për të gjithë kandidatët, ndër të tjerë, për zonjën {...} është caktuar relatore zonja Marçela Shehu, pra jam caktuar unë relatore.

Në vijim, ka vijuar procedura në respektim të vendimit nr. 75/2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Zonja {...} nuk ka paraqitur ndonjë shkak përjashtimi për relatorin apo për ndonjë anëtar. Ka depozituar rregullisht formularët dhe autorizimet e tjera.

Gjatë verifikimit, nga relatori është caktuar se zonja {...} nuk plotëson një nga kushtet kushtetuese dhe ligjore për të qenë anëtare e Gjykatës së Lartë dhe konkretisht nuk plotëson kushtin “e mbajtjes së gradës shkencore në drejtësi”.

Në këto kushte, bazuar në këtë gjetje, duke qenë se ishte një shkak që çon, mund të çonte në skualifikimin e saj, relatorja ka njoftuar Komisionin e Zhvillimit të Karrierës, i cili me vendimin e datës 28.08.2019 vendosi që kandidatja, znj. {...}, të ftohet për të paraqitur shpjegime lidhur me gjetjen e procedurës së verifikimit si dhe të çdo dokumentacioni mbështetës të nevojshëm sipas vlerësimit të saj. Asaj i është komunikuar njoftimi mbi gjetjen edhe pas këtij komunikimi, znj. {...} nuk ka paraqitur asnjë dokument që të vërtetonte mbajtjen e gradës shkencore nga ana e saj. Ajo ka theksuar vetëm faktin se

ka përfunduar Fakultetin Juridik në vitin '96 dhe diploma e saj, bazuar në ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, konvertohet me Master Shkencor.

Duke e konsideruar të plotë procedurën e verifikimit të ndjekur për këtë kandidatë deri në këtë moment, unë si relatore kam parashtruar rastin përkatës para Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Komisioni, në mbledhjen e datës 09.09.2019, ka konsideruar që procedurat dhe verifikimet për këtë kusht ndalimi ishin të plota, dhe në këto kushte ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në Këshillin e Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur (ky i fundit) për skualifikimin e kandidatës për mosplotësimin e këtij kushti apo për vijimin e procedurës së verifikimit për kushtet dhe kriteret ligjore të tjera të kandidimit.

Unë si relatore i propozoj Këshillit të Lartë Gjyqësor, që pas shqyrtimit të rastit përkatës, të vendos skualifikimin e kandidatës për shkak se, ashtu siç u relatua, ajo nuk plotëson një nga kushtet kushtetuese dhe ligjore të përcaktuar në nenin 136/3 të Kushtetutës dhe 49/1 të ligjit për Statusin, atë “të mbajtjes së gradës shkencore në drejtësi”, në kuptim të këtyre dispozitave si dhe të ligjit “Për arsimin e lartë”, zonja {...} nuk është mbajtëse e gradës shkencore në drejtësi.

Duke qenë se jemi para këtij kushti ndalimi, sipas meje si relatore, bazuar edhe në vendimin 75 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nuk është i nevojshëm kryerja e verifikimeve të tjera lidhura me kushtet e tjera.

Unë kam përgatitur edhe projektvendimin përkatës, me bazën ligjore që është cituar edhe nga relatorët e tjerë në rastet e skualifikimit të kandidatëve dhe i propozoj Këshillit të Lartë Gjyqësor që të vendosë: “Skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatës znj. {...} nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 109, datë 09.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” kandidatës znj. {...} dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Kandidatja ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.” Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zonja Shehu!

Atëherë, nëse ne nuk kemi diskutime lidhur me propozimin e bërë nga relatorja, kalojmë në votimin e projektvendimit të propozuar nga relatorja dhe pranuar nga Komisioni?

Atëherë, po!

Kalojmë në votim!

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi projekt-propozimin e bërë nga Komisioni dhe relatorja Marçela Shehu.

Kalojmë tek kandidati tjetër i radhës, që i përket zonjës {...} dhe relator i kësaj kandidateje është zoti Ilir Toska.

**Ilir Toska:** Faleminderit!

Atëherë, po parashtroj relacionin për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, të kandidatës znj. {...}.

Zonja {...}, është shtjelluar gjerësisht në relacion të gjitha rrethanat dhe faktet. Mund të sjell në vëmendje se zonja {...} ka kandiduar për një nga pozicionet e lira të shpallura për në Gjykatën e Lartë, pikërisht për atë që kërkon ekspertizë të veçantë në fushën e së drejtës civile, me vendimin nr. 109, datë 09.07.2019.

Gjatë procedurës së verifikimit, ndër dokumentet e dorëzuara nga kandidatja, zonja {...} ishte edhe një vërtetim me nr. 896 prot., datë 17.07.2019, lëshuar nga Akademia e Forcave të Armatosura, sipas të cilit:

“... Znj. {...} ({...}) ka mbrojtur dezertacionin me temë “Media, opinion publik dhe e drejta e informimit për çështjet e sigurisë kombëtare”, me udhëheqës shkencor Prof. Dr. {...}. Juria me vendimin nr. 23, datë 11.12.2018 e vlerësoi rezultatin “Shumë mire”.

Gjithashtu, bazuar në shkresën e Ministrisë së Sportit dhe Rinisë me nr. 1036/1, datë 15.04.2019 “Njoftim për regjistrimin dhe numrin e regjistrimit për gradat shkencore “Doktor”, Zonja {...} ({...}) është regjistruar në regjistrin përkatës në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë me nr. 3658”.

Në vijim të procedurës së verifikimit, më datë 06.08.2019... Në lidhje me verifikimin e kushtit të kandidimit “të mbajtjes së gradës shkencore në drejtësi”, përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, por edhe në nenin 49, pika 1, të ligjit nr. 96 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, u kërkua informacion dhe konfirmim nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në lidhje me fitimin e gradës shkencore në drejtësi nga kandidatët për gjyqtarë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, ndër ta edhe për znj. {...}.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, me shkresën nr. 7834/1 prot., datë 23.08.2019, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë informoi dhe konfirmoi, ndër të tjera, se:

“Grada shkencore “Doktor” fituar nga znj. {...} figuron e regjistruar në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademik, pranë Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, me numër rendor 3658, Akademia e Forcave të Armatosura, Nr. Vendimi: 23, datë 21.11.2018. ... Të gjitha gradat shkencore të listuara më sipër, përveç gradës shkencore të fituar nga znj. {...} (Siguri dhe Mbrojtje), i përkasin fushës së drejtësisë.”

Pas marrjes së këtij informacioni dhe konfirmimi nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, pra ministria përgjegjëse për arsimin që ka për kompetencë, ndër të tjera, edhe administrimin e regjistrimit shtetëror të gradave shkencore, nisur nga fakti se grada shkencore “Doktor” në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, fituar nga kandidatja, znj. {...}, nuk klasifikohet si “gradë shkencore në drejtësi”, duke patur në vëmendje përmbajtjen e nenit 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 49, pika 1, të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke vlerësuar së

në rastin konkret verifikohej një rrethanë që mund të çonte në përfundimin se kandidati nuk plotëson një nga kushtet e emërimit si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, unë si relator i çështjes, vura në dijeni Komisionin e Zhvillimit të Karrierës, i cili, mbështetur në shkronjën “a”, pika 12, Seksioni B, Kreu VI, të vendimit nr. 75/2019, me vendimin e datës 28.08.2019, vendosi që:

“Kandidatja znj. {...} të ftohet për të paraqitur shpjegime lidhur me gjetjen e procedurës së verifikimit, si edhe të çdo dokumentacioni mbështetës të nevojshëm sipas vlerësimit të saj”.

Për këtë, zonja {...} është njoftuar më datë 28 gusht dhe po më datë 28 gusht 2019, në rrugë elektronike, ajo paraqiti shpjegimet e saj sipas këtyre shpjegimeve:

“... Grada Shkencore që unë kam është në Fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes. Por, pavarësisht kësaj, tema të cilën unë kam mbrojtur ka lidhje me fushën e drejtësisë "Media, Opinioni publik dhe e drejta e informimit për çështjet e sigurisë kombëtare", gjë të cilës i jam referuar dhe nisa procedurën e aplikimit për gjyqtare në Gjykatën e Lartë”.

Duke vlerësuar të plotë procedurën e verifikimit të ndjekur deri në këtë moment për kandidaten, znj. {...} dhe, në veçanti, verifikimet në lidhje me kushtin e kandidimit “të mbajtjes gradë shkencore në drejtësi”, rastin ia parashtrova Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, i cili me vendimin e datës 09.09.2019, duke konsideruar se procedurat dhe verifikimet për këtë kusht kandidimi ishin të plota, bazuar në pikën 3, të Seksionit C, Kreu VI, të vendimit nr. 75/2019, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur për skualifikimin e kandidates për mosplotësimin e këtij kushti kandidimi ose për vijimin e procedurës së verifikimit për kushtet dhe kriteret ligjore të kandidimit.

Ndërkohë, po vijoj edhe me diskutimin për sa i përket pretendimeve të ngritura nga kandidatja zonja {...}.

Mendoj se ato janë të pabazuara. Konkretisht, sikurse rezulton nga dokumentet zyrtare me fuqi të plotë provuese, por edhe nga sa vetë kandidatja pranon në shpjegimet e saj, del se grada shkencore “Doktor” e fituar nga ajo i përket fushës së sigurisë dhe mbrojtjes.

Mendoj se nuk mund të pranohet pretendimi i kandidates, znj.{...}, për interpretimin e fushës së gradës shkencore të fituar prej saj referuar përmbajtjes së

disertacionit shkencor mbi të cilin ajo ka arritur të fitojë gradën, pasi përcaktimi i fushës dhe drejtimi i programit të studimit për fitimin e kësaj grade është bërë nga organi kompetent i institucionit të arsimit të lartë, që i ka dhënë gradën kandidates. Vlen të theksohet se, referuar ligjit për arsimin e lartë, institucioni i arsimit të lartë ku kandidatja ka ndjekur studimet e doktoraturës dhe ka fituar gradën shkencore, është një institucion i profilizuar, që do të thotë se programet e studimit të ofruara nga ai, përfshirë edhe ato për ciklin e tretë (studimet e doktoratës), janë të profilizuara sipas fushës përkatëse të kompetencës së institucionit (Akademia e Forcave të Armatosura), pra në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Gjithsesi, përtej kësaj, sjell në vëmendje se gjatë procedurës së verifikimit, kandidatja, znj. {...}, megjithëse u ftua të paraqiste dokumente mbështetës, nuk paraqiti ndonjë akt provues përmes të cilit të vërtetonte pretendimin e saj se programi i studimeve të doktoraturës i ofruar në rastin e saj nga Akademia e Forcave të Armatosura ka qenë një program studimi në fushën e drejtësisë, i hartuar dhe miratuar nga senati akademik i këtij institucioni të arsimit të lartë, sikurse edhe nga ministria përgjegjëse për arsimin.

Për rrjedhojë, mendoj se procedurat e verifikimit për kandidaten, znj. {...}, në lidhje me kushtin e kandidimit “të mbajtjes gradë shkencore në drejtësi”, janë të plota, prandaj, ndërsa nuk vërtetohet që kandidatja të përmbush këtë kusht, vijimi i procedurës së verifikimit për kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit nuk është i nevojshëm.

Për sa parashtrova, mendoj se Këshilli i Lartë Gjyqësor është para rastit për të vendosur skualifikimin e kandidates znj. {...} dhe përjashtimin e saj nga procedurat e emërimit në një pozicion të lirë të shpallur për në Gjykatën e Lartë, atë në fushën e të drejtës civile.

Në lidhje me këtë propozim, në cilësinë e relatorit të çështjes, në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në vendimin nr. 75/2019, kam përgatitur edhe projektvendimin përkatës, që është pjesë e materialeve të mbledhjes për këtë çështje.

Dua të sjell në vëmendjen tuaj edhe faktin, se referuar shkresës së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive me nr. 3832/1, datë 10.09.2019, Këshilli i Lartë informohet se kandidatët, ndër të tjerë edhe zonja {...}, nuk ka depozituar brenda afatit ligjor (pra deri më datë 6 shtator), deklaratën e kontrollit të pasurisë dhe konfliktit të interesave.

Në lidhje me projektvendimin, në fakt nuk i referohet faktit të referuar së fundmi nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave por vetëm për sa i përket kushtit “të mos mbajtjes së gradës shkencore në drejtësi”, ka të njëjtat referenca ligjore si edhe për kandidatin z. {...} dhe përmbajtja/urdhërimi është si më poshtë: “Skualifikimin dhe përjashtimin e kandidates znj. {...} nga procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 109, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Kandidatja ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.” Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Ilir Toska!

Kemi ndonjë koment apo kalojmë direkt në vendimmarrje lidhur me projekt-propozimin e propozuar nga Komisioni?

Atëherë, kalojmë në vendimmarrje.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi propozimin e bërë nga Komisionit i Zhvillimit të Karrierës lidhur me kandidaten {...}.

Kalojmë tek kandidatja tjetër, që bëhet fjalë për zonjën {...}. Edhe këtu relator zoti Ilir Toska.

**Ilir Toska:** Është zoti Alban Toro.

**Naureda Llagami:** Po, zoti Alban Toro.

**Alban Toro:** Edhe për kandidaten e mësipërme {...} është ndjekur e njëjta procedurë verifikimi dhe gjetja aktualisht e relatorit në këtë kandidate, pas kryerjes së të gjitha procedurave të verifikimit, mbështetet tek instituti dorëheqjes, pasi edhe kjo kandidate, gjatë procedimit administrativ, ka depozituar dorëheqjen, fillimisht nëpërmjet kontaktit elektronik më datë 01.08.2019 me anë të së cilës ajo deklaron se: “Unë {...}, me nr. Personal të Kartës së Identitetit {...}, tërhiqem nga kandidimi si kandidate për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për shkak se nuk kam interes të vazhdoj më tej procesin. Do t’ju lutesha të më mundësonit edhe tërheqjen e dokumentacionit që kam depozituar pranë zyrës së protokollit të KLGJ ose të ma dërgonit në rrugë zyrtare”.

Më tej kjo kërkesë u paraqitet prej kandidates pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me shkresën nr. 3986/2 prot., datë 06.08.2019 me objekt “Prezantim tërheqje nga gara” duke tërhequr të gjithë dokumentacionin e depozituar për aplikimin me nr.3986 prot., datë 19.07.2019.

Duke qenë që edhe ky fakti i dorëheqjes është parashikuar në rregulloren e Këshillit të Lartë Gjyqësor, miratuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, 23.05.2019 Kreu VI, Seksioni B, pika 17, iu relatua Komisionit i cili pasi e aprovoi dhe e vlerësoi të plotë procedurën e verifikimit, i relaton Këshillit të Lartë Gjyqësor faktin e kësaj gjetjeje.

Si relator i këtij subjekti, duke u mbështetur edhe tek instituti i dorëheqjes, i cili përfaqëson një akt vullnetar dhe nuk mund të jetë i kufizuar në kohë, ai bazohet në vullnetin e lirë të kandidates për të ndërprerë në çdo kohë vazhdimin e konkurrimit në një pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë dhe për rrjedhojë, procedura e verifikimit nuk mund të vijojë më tej, pavarësisht nga faza e procedimit administrativ. Kandidatja ka paraqitur jo vetëm me e-mail por është paraqitur edhe personalisht pranë zyrës së protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor me shkresë të veçantë, dëshirën e saj për t’u tërhequr, duke qartësuar dhe siguruar vullnetin përpara institucionit para së cilit ajo ka kandiduar dhe për rrjedhim



kryerja e procedurës së verifikimit për të gjitha kushtet dhe kriteret e tjera ligjore është e pa nevojshme, duke propozuar edhe përfundimin e procedurës së verifikimit.

Në këtë aspekt është përgatitur edhe projekti përkatës i vendimit të cilën po e lexoj vetëm dispozitivin, pra vendosi: Përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidatës {...} për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi, për pozicionin e lirë për në Gjykatën e Lartë, të shpallur me vendimin nr.108, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit.

Kandidati ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toro!

Në qoftë se s'kemi diskutime, kalojmë në votimin e projekt-aktit të propozuar nga relatori dhe mbështetur nga Komisioni.

**Alban Toro:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

*(Vota e zonjës Kadi nuk dëgjohet.)*

**Maksim Qoku:** Dakord.

*(Vota e zonjës Luli nuk dëgjohet.)*

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi projekt-aktin sipas propozimit të bërë nga relatori dhe Komisioni i Zhvillimit të Karrierës për kandidaten {...}.

Kalojmë tek kandidati tjetër që është zoti {...}, relator i të cilit është zoti Dritan Hallunaj.

**Dritan Hallunaj:** Faleminderit!

Në vijim të procedurës së verifikimit për kandidatët e paraqitur në zbatim të vendimeve nr. 108, 109, 110 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë, për pozicion të lirë”, ka paraqitur edhe kërkesë kandidati {...}. Kërkesat kanë qenë në të tre fushat, në atë administrative, civile dhe në atë penale.

Pas vijimit të hedhjes së shortit, Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 142, datë 26.07.2019, ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, caktimin e relatorit si dhe me vijimin e procedurave.

Nga ana e relatorit janë kryer të gjitha procedurat duke u njoftuar kandidati për fillimin e procedurës së verifikimit, për të drejtën për të kërkuar përjashtimin e relatorit apo të ndonjë anëtari të Këshillit, për të depozituar adresat. Brenda afateve ligjore kandidati ka paraqitur rregullisht formularin deklarues, adresat, adresën elektronike, numrin e kontaktit si dhe nuk ka ngritur ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar apo ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Gjithashtu është njoftuar kandidati në rrugë elektronike për plotësimin e dokumentacionit të kandidimit dhe kandidati është përgjigjur kësaj kërkesë, duke paraqitur të gjitha aktet dhe formularët dhe autorizimet përkatës, me përjashtim të librezës së punës, për të cilën e ka deklaruar që do ta paraqesë në një moment të dytë, pasi ishte fundi, ishte periudha e pushimeve. Por në jetëshkrimin e paraqitur nga kandidati, ai paraqet si përvojë pune, punën e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë për periudhën 1999-2008.

Nisur nga ky informacion, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor janë ndërmarrë disa verifikime, duke u konsultuar edhe me Fletoren Zyrtare dhe rezultoni që në Fletoren Zyrtare nr. 17, botimi më datë 15 korrik '99 është konstatuar se Presidenti i Republikës, me dekretin nr. 2375, datë 21.05.99, mbështetur tek neni 136/1 e Kushtetutës dhe në pëlqimin e dhënë nga Kuvendi, me vendimin nr. 407, datë 20.05.99 ka vendosur: “Zoti {...} emërohet anëtar i Gjykatës së Lartë. Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.”

Në vijim të procedurës së verifikimit nga korrespondenca me Gjykatën e Lartë si dhe shkresat me nr. prot. 2187/1, datë 02.09.2019, protokolluar në institucionin tonë me nr. 4238/1, datë 02.09.2019, konfirmohet fakti i emërimit të kandidatit, z. {...} me detyrën e sipërpërmendur, me dekret të Presidentit të Republikës, deri më datë 21.05.2008, pra deri në përfundim të mandatit 9-vjeçar.

Sipas nenit 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë emërohen nga Presidenti i Republikës, me propozim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për një mandat 9- vjeçar, pa të drejtë riemërimi.

Mbi këtë bazë, më datë 03.09.2019, kandidati, z. {...}, është njoftuar për gjetjen e procedurës së verifikimit, pra në lidhje me faktin e qenies një herë në këtë detyrë, si gjyqtar i Gjykatës së Lartë, duke u ftuar kandidati që të paraqesë shpjegime për gjetjen.

Kandidati, me datë 05.09.2019 ka parashtruar shpjegimet e tij duke thënë që erdha në dijeni të pretendimeve të parashtruara të paraqitura nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe bën interpretimin e nenit 136 të Kushtetutës mbi faktin e riemërimit, ku thuhet ndër të tjera, pra ai shpjegon që: “Pra veprimi i normës shtrihet mbi një subjekt të posaçëm që është anëtari i Gjykatës së Lartë, duke legjitimuar kohëzgjatjen e emërimit të tij vetëm për një mandat. Norma nuk lejon vazhdimësinë e mandatit të anëtarit të Gjykatës së Lartë. Në dallim me këtë kemi organe të tjera kushtetuese, në të cilat ligjvënësi ka lejuar parimin e vazhdimësisë së mandatit si në rastin e Prokurorit të Përgjithshëm. Në këtë aspekt kufizimi i sanksionuar sa më sipër vepron vetëm pasi ka filluar mandati përkatës, domethënë subjekti është emëruar. Ky kufizim nuk shtrihet mbi të drejtën që ka subjekti në cilësinë e kandidatit për postin e anëtarit të Gjykatës së Lartë, pasi subjekti i ndalimit është anëtari i Gjykatës së Lartë dhe jo kandidati për këtë detyrë. Vetë termi riemërim tregon vazhdimësi të procesit dhe këtë vazhdimësi ligjvënësi nuk e dëshiron.

Përfundimisht pengesa ka të bëjë vetëm me vazhdimësinë e mandatit të fituar rregullisht nga anëtari Gjykatës së Lartë dhe jo me të drejtën për të konkurruar për një vend të tillë domethënë me ushtrimin e procedurës për t’u emëruar në këtë detyrë. Kjo është e drejtë kushtetuese dhe ligjvënësi nuk mundet që të lejojë një kufizim të tillë.” Dhe shprehet që: “Unë e kam lënë mandatin në vitin 2008 dhe gjatë kësaj kohe kam patur aktivitet privat, pra nuk mundet të flitet për riemërim.” Pra i gjithë thelbi i fjalës është tek pjesa e riemërimit, vazhdimin në detyrë.

“I njëjti interpretim lejon të bëhet edhe kur i referohet organit që e zbaton këtë detyrim. Pra termi i përdorur është “riemërim” domethënë ky detyrim i referohet veprimit të Presidentit.”

Këto janë pra pretendimet që ka paraqitur në vija të përgjithshme kandidati, duke përmendur edhe ndonjë rast që në rastet e kaluara është kaluar një situatë e tillë siç shprehet

kandidati, siç është rasti i kandidimit të zotit {...}, i cili ka qenë për një mandat dhe më vonë përsëri është dekretuar nga Presidenti, por që në Parlament nuk ka arritur të bëjë votat, por jo për këtë shkak.

Pra këto janë pretendimet që ka paraqitur dhe nga ana e relatorit, pra nga ana ime është drejtuar Komisionit të Zhvillimit të Karrierës me idenë se duke vlerësuar se e gjitha procedurat e verifikimit e ndjekur deri në këtë moment për kandidatin z. {...} dhe në veçanti, verifikimet në lidhje me ekzistencën e kushtit ndalues të kandidimit, i jam drejtuar Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe ky Komision, më datë 09.09.2019, ka vendosur kalimin për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur për skualifikimin e kandidatit për faktin e ekzistencës së kushtit ndalues të kandidimit ose për vijimin e procedurës së verifikimit për kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit.

Edhe unë si kolegët e tjerë, përpara se të parashtrij, duke patur parasysh gjetjet e bëra gjatë procedurës së verifikimit e cila është një rrethanë përmes së cilës vërtetohet që kandidati z. {...}, verifikohet ekzistenca e kushtit ndalues të kandidimit, ai i emërimit në Gjykatën e Lartë, e përcaktuar në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Sipas nenit 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, formulimi që ka qenë në fuqi në momentin emërimit të tij si anëtar i Gjykatës së Lartë është i tillë: “Anëtarët e Gjykatës së Lartë emërohen nga Presidenti i Republikës me pëlqimin e Kuvendit. Kryetari dhe anëtarët e Gjykatës së Lartë qëndrojnë në detyrë për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi”. Ndërsa sipas nenit 136/1 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, formulimi aktual, pra në momentin e aplikimit të kandidatit, z. {...}, për t’u emëruar gjyqtar i Gjykatës së Lartë formulimi është i tillë: “Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë emërohen nga Presidenti i Republikës me propozim të Këshillit të Lartë Gjyqësor për një mandat 9-vjeçar, pa të drejtë riemërimi”. Pra referuar nenit 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, qoftë sipas formulimit të momentit të emërimit të kandidatit si anëtar gjyqtar i Gjykatës së Lartë ashtu edhe në formulimin në momentin e aplikimit të kandidatit z. {...} për t’u emëruar si gjyqtar i Gjykatës së Lartë, gjyqtari i Gjykatës së Lartë nuk ka të drejtë të riemërohet.

Propozimi që unë i kam propozuar edhe Komisionit është dërgimin e çështjes për skualifikimin e kandidatit {...} dhe përjashtimin e tij nga procedurat e mëtejshme të

emërimit për të tre pozicionet e lira për në Gjykatën e Lartë, atë në fushën administrative, civile dhe të drejtës penale.

Projektvendimi që është paraqitur është (pa pjesën hyrëse), vendosi: “1. Skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit z. {...} nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me vendimin nr.108, datë 09.07.2019, vendimin nr.109, të po kësaj date dhe nr. 110, të po kësaj date, pra 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...}.

Kandidati ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.”

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Hallunaj!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim para se të kalojmë në votimin sipas propozimit të bërë nga Komisioni përmes relatorit?

Jo!

Atëherë, kalojmë në votim, duke filluar nga relatori.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi propozimin për skualifikim e z. {...} sipas propozimit të bërë nga Komisioni.

Kalojmë tek kandidatja tjetër.

Bëhet fjalë për zonjën {...}, relatores e së cilës është zonja Marçela Shehu.

**Marçela Shehu:** Faleminderit, Kryetare!

Zonja {...} ka kandiduar për një pozicion në Gjykatën e Lartë, në fushën e së drejtës penale, pozicion ky i shpallur me vendimin nr. 110, datë 09.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me vendimin nr. 142, 26.07.2019 të Këshillit është vendosur fillimi i procedurës së verifikimit dhe jam caktuar unë me cilësinë e relatores. Pas këtij momenti ka vijuar komunikimi elektronik me kandidaten lidhur me plotësimin e dokumentacionit përkatës, të deklaratave, formularëve, autorizimeve që duhet të paraqiste në përputhje me parashikimet e vendimit nr. 75 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Gjatë procedurës së verifikimit është konstatuar se znj. {...} nuk ishte mbajtëse e gradës shkencore në drejtësi. Në këto kushte i është komunikuar kjo gjetje pas vendimit përkatës të Komisionit zonjës {...} dhe është ftuar për të dhënë shpjegime.

Pas këtij momenti, znj. {...}, më datë 02.02.2019, me anë të dokumentit njoftim për tërheqje nga kandidimi, protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 3985/3, datë 02.09.2019, ka njoftuar për tërheqjen nga kandidimi për pozicionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Lartë.

Në këto kushte, bazuar në faktin që kjo kandidate është tërhequr nga kandidimi, unë i kam parashtruar rastin Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Në Mbledhjen e datës 09.09.2019, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidatit të tërhequr znj. {...}.

Unë me cilësinë e relatores i propozoj Këshillit pikërisht që në përputhje me pikën 17, pika b e Kreut VI të vendimit 75, datë 23.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, i cili rregullon edhe rastin e tërheqjes nga procesi i kandidimit, i propozoj që në këtë moment të përfundojë procedurën e verifikimit të kandidates znj. {...} për shkak të tërheqjes nga kandidimi për pozicionin e lirë për në Gjykatën e Lartë, shpallur me vendimin nr. 110, datë 09.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, -po citoj projektvendimin.

Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit.

Kandidatja ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit.  
Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zonja Shehu!

Atëherë, përpara se të kalojmë për miratimin e projekt-propozimit nga Komisioni dhe relatorja, kemi ndonjë diskutim, ndonjë sqarim mbi relacionin?

Jo!

Atëherë, kalojmë në miratimin e projekt-propozimit të bërë nga Komisioni sipas së cilit përfundohet procedura e verifikimit të kandidates për shkak të tërheqjes nga procesi i kandidimit. Jemi dakord?

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi propozimin e Komisionit.

Kalojmë tek kandidates i radhës, e cila bëhet fjalë për zonjën {...} dhe relator i këtij kandidati është zoti Alban Toro.

**Alban Toro:** Faleminderit!

Atëherë, edhe për kandidaten {...} është proceduar në të njëjtën mënyrë. Është komunikuar duke kërkuar nëse ekzistonin shkaqe përjashtimore për relatorin ose për ndonjë nga anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Pasi u konfirmua është proceduar me dërgimin e informacionit të kërkuar dhe dokumentacionit të kërkuar.

Gjetja në rastin konkret që është verifikuar gjatë procedurës së verifikimit konsiston/mbështetet tek instituti i dorëheqjes dhe kjo kandidate gjatë komunikimeve me relatorin ka preferuar të japë dorëheqjen. Dorëheqja si një akt vullnetar është gjykuar që

ndërpret në çdo rast procedimin administrativ, mjafton që ai të jetë i sigurt në shfaqjen e tij. Në rastin konkret, kjo candidate, jo vetëm ka komunikuar me e-mail tekstin e dorëheqjes por është paraqitur personalisht pranë zyrës së protokollit të KLGJ-së, duke paraqitur edhe aktin e dorëheqjes dhe tërhequr të gjithë dokumentacionin tjetër shoqërues.

Në këto kushte është proceduar nga ana e relatorit duke i relatuar Komisionit, i cili më pas e ka kaluar çështjen në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Gjithashtu, relatori, duke pasur në konsideratë këtë institut, i ka paraqitur, ka përgatitur edhe projektin e vendimit me dispozitivin si më poshtë, ...vendosi: “Përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidates {...}, për shkak të tërheqjes nga kandidimi, për pozicionet e lira të shpallura me vendimin nr.108 dhe 109, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates {...}

Kandidati ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.”

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toro për relatimin.

Atëherë, para se të kalojmë në vendimmarrje, kemi ndonjë koment lidhur me relatimin, ndonjë diskutim?

Jo!

Atëherë, kalojmë në vendimmarrje, sipas propozimit të bërë nga zoti Toro dhe Komisioni, mbi përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidates {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga procesi për kandidimin. Jemi dakord?

**Alban Toro:** Dakord.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Erjon Muharremaj:** Pro.



**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli e miratoi propozimin e Komisionit për kandidaten {...}.

Kalojmë tek kandidati tjetër, zoti {...}, relator është zonja Marçela Shehu.

**Marçela Shehu:** Po, faleminderit Kryetare!

Kandidati zoti {...} ka kandiduar për të tre pozicionet e shpallura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimet 108, 109 dhe 110 të datës 09.07.2019.

Me vendimin nr. 142, të datës 26.07.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit për të gjithë kandidatët dhe për këtë kandidat jam caktuar unë me cilësinë e relatores.

Më tej ka vijuar komunikimi elektronik me zotën {...}. I është komunikuar e drejta për të kërkuar përjashtimin e relatorit dhe anëtarëve. Janë dërguar formularët, autorizimet përkatëse që duhet të plotësonte.

Më datë 29.07.2019, pas shqyrtimit paraprak të dokumentacionit, zoti {...} është njoftuar për plotësimin e dokumentacionit të kandidimit. Ai brenda afatit ligjor ka depozituar rregullisht dokumentacionin e kërkuar.

Me anë të komunikimit elektronik të datës 01.08.2019, zotit {...} i është kërkuar të plotësohet kërkesa për shprehje interesi, duke qenë që ai nuk e kishte cilësuar fillimisht, prandaj arritëm në konkluzionin që ai kishte shprehur vullnetin për të treja. Gjithsesi iu dërgua një komunikim për ta saktësuar ai personalisht interesin për një nga pozicionet, por ai nuk pati një kërkesë të shprehur. Në këtë mënyrë, relatorja ashtu edhe Komisioni prezumoi që ai kishte kandiduar për të tre pozicionet e shpallura.

Gjatë procedurës së verifikimit është konstatuar se zoti {...} kishte mungesë “të mbajtjes së gradës shkencore në drejtësi”, pra nuk kishte një akt që të vërtetonte këtë fakt, ndaj atij i është komunikuar fakti nga relatori nëpërmjet Komisionit. Komisioni, me vendimin nr., 28.08.2019 vendosi që kandidati z.{...} të ftohet për të paraqitur shpjegime lidhur me gjetjen e procedurës së verifikimit, që konsistonte pikërisht në mungesën e mbajtjes së gradës shkencore në drejtësi. Ai u njoftua më datë 28.08.2019 për këtë gjetje.

Nga ana e kandidatit nuk u paraqitën dokumenta shtesë, por me anë të komunikimit elektronik të datës 03.09.2019, ai ka dërguar kopje të skanuara të vërtetimit të datës

23.08.2019 lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë, me anë të të cilit vërtetohet se zoti {...} ishte regjistruar në ciklin e tretë të studimeve doktoraturë në Departamentin e së Drejtës Civile, më datë 17.12.2013.

Gjithashtu, me anë të vërtetimit të paraqitur vërtetohet se ky kandidat ka ndjekur vitin teorik përgjatë vitit akademik 2014-2015 dhe ka marrë rezultatet e cituara në vërtetim, por në këtë vërtetim nuk citohet nëse ai është “mbajtës i gradës shkencore në drejtësi”.

Gjithashtu, në pretendimet e paraqitura në rrugë elektronike, z. {...} thekson se sipas këndvështrimit të tij, rezulton se në qofte se çdo kandidat duhet të ketë gradë shkencore në drejtësi, atëherë referuar edhe teknikës legislative, nuk do të ishte e nevojshme që kjo dispozitë kushtetuese (neni 136, pika 3) të behej me 7 rreshta (sipas zotit {...}), por thjesht do të përcaktonte: “Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit dhe çdo jurist që ka 15 vjet punë dhe gradë shkencore në drejtësi”. Ai pretendon se arsyeja që ligjvënësi i ka përcaktuar më vete avokatët, dhe më vete profesorët ose lektorët e së drejtës dhe më vete juristët e institucioneve, është fakti që sipas tij, “mbajtja e gradës shkencore” është e detyrueshme vetëm për juristët e institucioneve pasi ata në ushtrimin e funksionit si jurist janë të kufizuar.

Duke vlerësuar të plotë procedurën e verifikimit, unë si relatore, pas këtij momenti kam parashtruar rastin para Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Komisioni ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi ka konsideruar që procedurat e verifikimit janë të plota, me qëllim që ky Këshill të vendosë skualifikimin e këtij kandidati për shkak të mungesës së këtij kushti apo për vijimin e procedurës së verifikimit për kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit.

Unë si relatore i propozoj Këshillit të Lartë Gjyqësor skualifikimin e kandidatit z. {...} nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë.

Lidhur me pretendimin e zotit {...} se ai është në proces dhe po ndjek studimet e doktoraturës, sjellim në vëmendje se edhe Kushtetuta dhe ligji kërkon që kandidati të jetë “mbajtës i gradës shkencore në drejtësi” dhe nuk parashikon që ky kandidat të jetë në proces e sipër të marrjes së kësaj grade.

Gjithashtu, lidhur me pretendimin e kandidatit që sipas tij, neni 136/3 i Kushtetutës, kushtin e “gradës shkencore në drejtësi” e vendos vetëm për juristët dhe jo për avokatët, profesorët, etj., në vlerësimin tim, mendoj që ky është një vlerësim dhe një interpretim i gabuar i kandidatit. Unë vlerësoj që Kushtetuta ka qenë e qartë në përcaktimin e saj, ashtu sikurse edhe neni 49 i ligjit 96 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku ka kërkuar që të gjithë juristët e spikatur, që kandidojnë, për një pozicion në Gjykatën e Lartë, ku përfshihen avokatë, profesorë apo juristë, duhet të jenë “mbajtës të gradës shkencore në drejtësi”.

Në këto kushte, unë i propozoj Këshillit skualifikimin dhe përjashtimin e këtij kandidati nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me vendimin nr.108, 109, 110, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Një kopje e arsyetuar e vendimit t’i komunikohet kandidatit dhe të bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

Kandidati ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

**Naureda Llagami:** Shumë faleminderit zonja Shehu për relatimin konciz dhe ezaurues!

Atëherë, përpara se të kalojmë tek vendimmarrja, kemi ndonjë diskutim lidhur me relatimin e çështjes?

Jo!

Atëherë, kalojmë në vendimmarrje sipas propozimit të bërë nga relatorja dhe të miratuar nga Komisioni.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit {...}, sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Kalojmë tek kandidati tjetër, që bëhet fjalë për zotin {...}, relator i të cilit është zoti Dritan Hallunaj.

**Dritan Hallunaj:** Kandidati zoti {...} ka kandiduar pas vendimmarrjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor për tre pozicione, në fushën administrative, civile dhe penale dhe duke patur të gjitha kriteret është hedhur shorti dhe me datën 26.07.2019 është caktuar, është çelur edhe procedura për verifikimin e kushteve si dhe caktimi i relatorit. Po atë datë është njoftuar në lidhje me procedurën e verifikimit për caktimin e relatorit, të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin, si dhe formularin deklarues për adresën postare elektronike, etj., të cilat ky kandidat i ka depozituar rregullisht, duke mos parashtruar asnjë pretendim në lidhje me relatorit apo me ndonjë anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Pastaj është njoftuar më datë 29.07 nga ana e Këshillit në lidhje me plotësimin e dokumentacionit të kandidimit dhe ky dokumentacion na është vënë në dijeni brenda afatit ligjor, brenda 5 ditëve nga ana e tij, me përjashtimin e dokumentit që provonte që ky kandidat “të mbante gradë shkencore në drejtësi”.

Në vijim të kësaj, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor është njoftuar kandidati me datë 28 gusht në lidhje me gjetjen e procedurës së verifikimit, pra në lidhje me kushtin e kandidimit “mbajtjes së gradës shkencore në drejtësi”, pra mungesën e saj dhe ky kandidat, me shkresën e protokolluar në institucionin tonë me nr.4007/6, të datës 02.09.2019, ka njoftuar Këshillin që ka marrë në dijeni dhe po jap shpjegimin në lidhje me kushtin e “mbajtjes së gradës shkencore në drejtësi” dhe në pretendimet e tij ai parashtron që: “Unë me vendimin nr.1, datë 30.03.1995 të KLD jam bërë pjesë e trupës gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mirditë. Por që shkresa mban datën 11.04.1995 (nga Drejtoria e Personelit, nënshkruar nga Ministri) ku ‘de juro’ nuk kam marrë vendim nga KLD për largim nga sistemi gjyqësor.”

Pastaj parashtron një rast për sa i përket një nga kandidatët për në Gjykatën Kushtetuese, ku ai thotë që është vendosur kalimi i saj, por nuk jep asnjë argument në lidhje me mungesën apo nuk shfaq asnjë dokument në lidhje me “pasjen e gradës shkencore në

drejtësi”. Prandaj këto gjetje iu referuan Komisionit dhe Komisioni, në datë 09.09.2019 i është drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor (seancës plenare), që të vijojë me vendimmarrjen e tij, duke i konsideruar procedurat dhe verifikimet të plota, duke vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim pranë këtij Këshilli për të vlerësuar dhe vendosur për skualifikimin e kandidatit për mosplotësimin e kushtit të kandidimit pra që është ai i “mbajtjes së gradës shkencore në drejtësi” apo për vijimin e procedurës së verifikimit për kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit.

Propozimi im në lidhje me këto gjetje, si relator i kësaj është se duke vlerësuar gjetjet e procedurës së vlerësimit që janë një rrethanë faktike, përmes së cilës vërtetohet se kandidati zoti {...} nuk përmbush njërin prej kushteve dhe kriterëve të kandidimit, pikërisht atë të “mbajtjes së gradës shkencore në drejtësi” të përcaktuar në nenin 136/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, por edhe nenin 49/1 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pra konfirmohet mungesa e diplomës që vërteton fitimin e gradës në drejtësi nga vetë kandidati si dhe në shpjegimet e tij dhe gjej të pabazuar pretendimin se mbajtja e gradës shkencore në drejtësi është favorizuese për kandidatin por nuk mund të jetë përcaktuese, pasi në përcaktimet ligjore të nenit 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kandidati për t’u emëruar në Gjykatën e Lartë duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme: Të mbajë gradë shkencore në drejtësi (një ndër këto kriteret).

Në këto kushte, duke qenë se zoti {...} nuk plotëson kushtet e kandidimit atë “të mbajtjes së gradës shkencore në drejtësi”, për mendimin tim nuk është e nevojshme kryerja e procedurës së verifikimit për kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit. Prandaj propozoj këtë projektvendim, që të vendoset: “Skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit z. {...} nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me vendimin nr. 108, 109, 110, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...}.

Kandidati ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 10 (*lapsus, pasi është 5 ditë*) ditëve nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.”

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Hallunaj!

Kemi ndonjë diskutim?

Atëherë, kalojmë me vendimmarrjen lidhur me propozimin e bërë nga relatori për skualifikimin e zotit{...}.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e vendimit sipas propozimit të Komisionit për skualifikimin e zotit {...} si kandidat në Gjykatën e Lartë.

Kalojmë tek kandidatura e fundit, zoti {...}, relator i të cilit është zoti Alban Toro.

**Alban Toro:** Faleminderit!

Në rastin konkret jam i detyruar ta cenoj standardin që kanë vendosur të parët, pasi do më duhet që për hir të një procedure të rregullt ligjore, të perifrzoj fjalë për fjalë të gjithë mbrojtjen që ka paraqitur ky kandidat në momentin kur është informuar për gjetjen, por jo vetëm gjatë momentit kur është verifikuar gjetja, pra mungesa e doktoraturës nga ana e tij, por edhe gjatë procedurës së paraqitjes së dokumentacionit të kërkuar, ai ka dhënë shpjegime të pa kërkuara në lidhje me mungesën e doktoraturës.

Kandidati në fjalë është magjistrat prokuror dhe në pretendimet që ka paraqitur para Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe relatorit ai shprehet konkretisht, duke evidentuar edhe mungesën dhe mosdoshmërinë e doktoraturës në rastin konkret.

Atëherë, më lejoni ta lexoj të plotë të gjithë mbrojtjen që ka bërë ai:

“Të nderuar përfaqësues të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në vijim të shprehjes time të interesit dhe të kandidimit për emërim si anëtar të Gjykatës së Lartë nga radhët e gjyqtarëve me ekspertizë të veçantë në fushën e së drejtës penale, duke konfirmuar

plotësisht arsyetimin tim në kërkesën për shprehjen e interesit të datës 24.07.2019, që në vijim do të citohet nga ana ime si ‘kërkesa’, nëpërmjet këtij materiali, lutem të pranoni edhe dokumentet dhe shpjegimet shtesë mbi rrethanat dhe çështjet ligjore të kandidimit tim.

Paraqitja e këtij materiali me shpjegime dhe dokumente shtesë, bazohet në përcaktimin e seksionit V, pika B/5 të vendimit 75, 23.05.2019 ku është parashikuar e drejta e kandidatit që kryesisht të paraqesë shpjegime dhe prova shtesë për faktet, rrethanat apo çështjet ligjore të kandidimit. Po ashtu, paraqitja e tij merr shkak edhe nga njoftimi juaj mbërritur rregullisht në postën time elektronike 29.07.2019 mbi plotësimin e dokumentacionit në lidhje me kushtet dhe kriteret e kandidimit tim, ku në faqen 2, paragrafi 2 të të cilit ju konfirmoj se bazuar në procedurat ligjore dhe nënligjore, kandidimi im do t’i nënshtrohet vlerësimit nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe vetë Këshilli i Lartë Gjyqësor për vijueshmërinë e këtij procesi.

Është pikërisht në funksion të kësaj procedure që po paraqes edhe këto shpjegime shtesë si vijon.

Ashtu sikurse kam parashtruar edhe në faqen 10 të kërkesës sime të datës 24.07.2019, rikonfirmoj vlerësimin tim se statusi i juristit të spikatur është i ndryshëm nga statusi i magjistratit, në kuptim të subjekteve që kandidojnë nga radhët e jo gjyqtarëve për anëtar të Gjykatës së Lartë.

Një dallim i tillë, veç argumentimit që kam përmendur edhe në kërkesën time të datës 24.07.2019, rezulton mjaft i qartë edhe nga formulimi i nenit 48 të ligjit në kuptim të ligjit 96/2016, në të cilin përcaktohet si vijon.” –dhe ka cituar nenin 48 në tërësi nga pika e parë tek pika 3, germat “a”, “b”, “c”.

“Nga ky përcaktim ligjor nuk ka asnjë dyshim se ashtu sikurse kam parashtruar edhe në kërkesën time të datës 24.07.2019, statusi i magjistratit është i ndryshëm nga statusi i juristit të spikatur, për efekt të procedurës së kandidimit për anëtar në Gjykatën e Lartë, për arsyet kryesore të përmbledhura si vijon: Së pari, sepse përkufizimi i statusit të magjistratit gjendet në nenin 2/gj, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” dhe ai i rezervohet vetëm gjyqtarëve ose prokurorëve.

Së dyti, sepse statusi i magjistratit fitohet vetëm në kushtet e plotësimin të parashikimeve në nenet 28 dhe 35, ose si alternativë e parashikuar nga vetë ligji, plotësimin

të kushteve në nenin 164/1 të nenit të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Së treti, sepse nuk ka asnjë parashikim ligjor që juristët e spikatur të gëzojnë statusin e magjistratit.

Por nga ky formulim ligjor, analizuar në harmoni edhe me nenet 136/1-2 dhe 136/3 paragrafi 1 dhe 2 të Kushtetutës rezulton gjithashtu se ligjvënësi nuk ka vendosur asnjë kufizim për prokurorët, duke përdorur vetëm termin magjistrat ku edhe ata përfshihen sipas neneve 2/gj dhe 164/1 të ligjit nr. 36/2016, për të qenë edhe këto subjekte kandidatë për plotësimin e 1/5 së vendeve nga jogjyqtarët në Gjykatën e Lartë, krahas kategorisë së ndryshme të juristëve të spikatur dhe që janë parashikuar si kandidatë në nenin 48/3-c të ligjit.

Nga ana tjetër vetë ligjvënësi ka parashikuar se jo vetëm për magjistratët, por edhe për juristët e spikatur, emërimi për në Gjykatën e Lartë kryhet vetëm nëpërmjet procedurës të cituar në ligj, si “ngritja në detyrë”, pasi në nenet 47 të ligjit nr. 96/2016, është përcaktuar si në vijim.” – dhe ka perifrazuar nenin 47, 48 të ligjit për Statusin.

“Ndërkohë, në nenin 49 të ligjit 96/2016 mbi emërimin e kandidatëve jogjyqtarë në Gjykatën e Lartë është përcaktuar si në vijim.” –përsëri ka cituar nenin 49.

“Është pikërisht edhe nga formulimi dhe interpretimi gramatikor i nenit 49/1 dhe 49/2, të ligjit nr. 96/2016, nga të cilat rezulton se, nga përdorimi i fjalës ‘mund’, 1/5 e anëtarëve të Gjykatës së Lartë parashikohet të zgjidhen nga jogjyqtarët ku përfshihen juristët e spikatur, por jo vetëm pasi kjo e drejtë i njihet edhe subjekteve të tjerë jogjyqtarë dhe ndër këta të fundit që plotësojnë kriteret ligjore janë vetëm magjistratët jogjyqtarë, pra prokurorët, ndërkohë që kushti i gradës shkencore për kandidim, i përcaktuar në nenin 49/1 të ligjit nr. 96/2016, i referohet vetëm kandidatëve juristë të spikatur dhe jo magjistratëve jogjyqtarë, që gëzojnë tjetër status.

Kësaj kategorie të fundit, pra magjistratëve, i referohet neni 49/2 i ligjit nr. 96/2016, që parashikon plotësimin prej tyre vetëm të kriterëve të germave përkatëse të nenit 28 të ligjit, dhe jo kushtit të gradës shkencore në drejtësi sipas nenit 49/1 të atij ligji.

Është pikërisht nga kuptimi dhe interpretimi harmonik dhe në tërësinë e tyre të dispozitave të neneve 136/3/4 të Kushtetutës, së bashku nenet 2/gj, 47/1-a, 48/1, 48/3-a, 48/3-c, 49/1, 49/2 dhe 164/1 të ligjit nr. 96/2016, për të cilat rikonfirmoj plotësisht



përfundimet e paraqitura me kërkesën time të datës 24.07.2019, mbi të cilat është bazuar shprehja ime e interesit për të kandiduar për pozicionin e anëtarit të Gjykatës së Lartë, nga jogjyqtarët me ekspertizë të veçantë në fushën e të drejtës penale, përfundime të cilat po i riparashtroj të përmbledhura në pikat kryesore, si në vijim.

Së pari, prokurorit që gëzon cilësinë e magjistratit dhe ka të paktën 15 vjet vjetërsi në detyrë, nuk mund t'i mohohet e drejta për të kandiduar për të plotësuar 1/5 e vendeve nga jogjyqtarët në Gjykatën e Lartë, pasi jo vetëm që kjo e drejtë buron nga kuptimi dhe interpretimi i neneve 136/3 dhe 136/4 të Kushtetutës, si dhe neneve 2/gj, 47/1-a, 48/1, 48/3-a, 48/3-c, 49/1, 49/2 dhe 164/1 të ligjit nr. 96/2016, por e kundërta do të përbënte diskriminim kushtetues sipas neneve 17/1 dhe 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Së dyti, konkurrimi i prokurorit si magjistrat jogjyqtar për të plotësuar 1/5 e vendeve nga jogjyqtarët në Gjykatën e Lartë, nuk vjen nga asnjë prej fushave shteruese të së drejtës prej nga vijnë juristët e spikatur, sipas parashikimit të nenit 49/1, të ligjit 96/2016, sepse funksioni i prokurorit është i papajtueshëm ligjërisht me to dhe, sipas nenit 148/3 të Kushtetutës, Prokuroria funksionon vetëm pranë sistemit gjyqësor, kurse statusi i gjyqtarëve dhe prokurorëve rregullohet në të njëjtin ligj, çka nuk rezulton për juristët e spikatur.

Së treti, prokurori që gëzon statusin e magjistratit (jogjyqtar), sipas nenit 164/1 të ligjit 96/2016 dhe njëkohësisht ka mbi 15 vjet vjetërsi në detyrë, i plotëson kushtet ligjore për kandidimin si anëtar jogjyqtar i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenet 136/3 dhe 136/4-1 të Kushtetutës, si dhe nenet 2/gj, 47/1-a, 48/1, 48/3-a, 49/1, 49/2 dhe 164/1 të ligjit 96/2016, edhe pse nuk ka “gradë shkencore në drejtësi”, pasi ai nuk konkurren me statusin e juristit të spikatur, kategori për të cilën është kusht i domosdoshëm grada shkencore, por me një status të ndryshëm dhe pikërisht atë të magjistratit jogjyqtar sipas nenit 48/3-a të ligjit 96/2016, status të cilin subjekti im e ka fituar për shkak të ligjit me datë 21.03.2019, kur ka marrë formë të prerë vendimi për rivlerësimin kalimtar.

Së katërti, prokurorët që janë në detyrë por ende nuk e kanë kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar, edhe pse mund të ketë 15 vjet përvojë pune, nuk e plotësojnë kushtin ligjor për kandidimin për në Gjykatën e Lartë, pasi ai ende nuk e ka fituar statusin e

magjistratit, por ka vetëm titullin e juristit, sipas përcaktimit të nenit 164/1 të ligjit 96/2016 dhe për këtë subjekt kusht i domosdoshëm është edhe “grada shkencore në drejtësi”.

Së fundi, për juristët e spikatur, të përmendur në nenin 136/3 të Kushtetutës dhe nenin 49/1 të ligjit 96/2016, “grada shkencore” është kusht kushtetues dhe ligjor për të kandiduar për pozicionin e anëtarit të Gjykatës së Lartë, krahas kritereve të tjera të parashikuara në ligj.

Ashtu sikurse u shpreha edhe më sipër nëpërmjet këtij materiali do të depozitohen pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor edhe dokumentet shtesë të mëposhtëm: Dëshmi e penalitetit, Vërtetim mbi eksperiencat në Prokurorinë e Përgjithshme.

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, dokumentacioni im i mësipërm do t’ju dërgohet paraprakisht nëpërmjet postës elektronike, ndërkohë që konfirmoj që kopjet origjinale të dokumenteve të cituara më sipër do depozitohen nëpërmjet postës pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Më herët kam pas dhënë shpjegime dhe dokumente shtesë, ku evidentohet që në vijim të shprehjes time të interesit dhe të kandidimit si anëtar i Gjykatës së Lartë, nga radhët e jogjyqtarëve me ekspertizë të veçantë në fushën e së drejtës penale, nëpërmjet këtij materiali dhe me kërkesën tuaj të datës 06.09.2019, po ju paraqes edhe shpjegimet shtesë si në vijim mbi rrethanat dhe çështjet ligjore të kandidimit tim.

Lidhur me kandidimin për plotësimin e 1/5 të vendeve të anëtarëve të Gjykatës së Lartë nga jogjyqtarët, ndonëse në kuadrin kushtetues ligjor dhe nënligjor aktual, askund nuk përcaktohet shprehimisht prokurori si një ndër subjektet që gëzon të drejtën për atë pozicion, besoj se ka qenë e kuptueshme edhe nga shpjegimet dhe rishpjegimet që kanë shoqëruar kërkesën për shprehjen e interesit se bindja ime për mospasje pengese ligjore në rastin e konkurrimit në mungesën e gradës shkencore në drejtësi është krijuar nga interpretimi dhe arsyetimi im juridik i përmbledhur si vijon:

Së pari, sepse subjekti prokuror, ashtu siç është rasti i konkurrimit tim, ndonëse nuk përmendet nominalisht në Kushtetutë, në ligj, në aktet ligjore si një ndër subjektet që mund të kandidojë për në pozicionin e anëtarit të Gjykatës së Lartë, legjitimohet të konkurrojë për këtë pozicion për arsyt themelore të tilla si: një pengesë në këtë konkurrim do të përbënte cenim të parimeve kushtetuese të përcaktuara në nenet 17, 18 të Kushtetutës; së dyti, sepse 1/5 e vendeve të anëtarëve të Gjykatës së Lartë plotësohen nga jogjyqtarët dhe

kjo e fundit është një bashkësi më e madhe subjektsh se ajo e juristeve të spikatur, të cituar nominalisht dhe në një mënyrë shteruese në nenin 49/1 të ligjit 96/2016.

Së dyti sepse për subjektin prokuror, që gëzon statusin e magjistratit dhe ka mbi 15 vjet përvojë në drejtësinë penale, nuk është kusht “sine qua non” grada shkencore në drejtësi për konkurrimin për pozicionin e anëtarit të Gjykatës së Lartë, në dallim nga kategoria e juristeve të fushave të tjera, të cilët duhet të vlerësohen edhe si të spikatur në kuptim të përcaktimit kushtetuese ligjor.

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të gjithë argumentet në funksion të vlerësimit tim për sa më sipër i kam parashtruar në shpjegimet e mia të mëparshme përfshirë mosqenien në kategorinë e subjektit prokuror kur ai sikurse në rastin tim gëzon statusin e magjistratit sipas neneve 2/gj, 48/3-a, 164/1 të ligjit 96/2016, në asnjë prej kategorive të juristëve të spikatur të përcaktuar në mënyrë shteruese në nenin 48/1-c dhe 49/1 të atij ligji. Ndërkohë që në vijim të arsytimit tim dëshiroj të theksoj se në funksion të zhvillimit të karrierës së magjistratëve sipas pjesës III të ligjit 6 (*lapsus, duhet të jetë 96*) të vitit 2016, pikërisht konkurrimi për plotësimin e vendit të anëtarit të Gjykatës së Lartë nga jogjyqtarët është mundësia e vetme e lejuar nga ligji, që karriera e prokurorit mund të altermohet me karrierën e gjyqtarit sepse një gjë e tillë nuk ndalohet nga parashikimet e këtij ligji, sikurse për shkallën e parë dhe të dytë të gjyqësorit.

Në dallim nga ushtrimi i funksioneve në shkallën e parë dhe të dytë të gjyqësorit ku sipas dispozitave ligjore 96/2016 karriera e gjyqtarëve dhe prokurorëve janë të ndara, në vlerësimin tim për pozicionin e anëtarit të Gjykatës së Lartë, rezulton mundësia ligjore që karriera e prokurorit të altermohet me atë të gjyqtarit në një proces të përcaktuar si ngritja në detyrë sipas neneve 47/1, 48/1, 49/1 të ligjit 96/2016.

Në lidhje sa më sipër është për t'u theksuar gjithashtu se vetëm për konkurrim për anëtar të Gjykatës së Lartë përcaktimi i termit është thjesht magjistrat, sipas nenit 48/3-a të ligjit 96/2016 sepse për shkallën e parë dhe të dytë të gjyqësorit, termi i përdorur është specifikuar sipas rastit, magjistrat nga radhët e gjyqtarëve për zhvillimin e karrierës në gjykata ose magjistrat nga radhët e prokurorëve për zhvillimin e karrierës në prokurori.

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor gjatë konsultimit me bazën kushtetuese ligjore në funksion të këtij procesi konkurrues, nuk kam mundur të gjej një shpjegim të vërtetë dhe të drejtë për pyetjen se pse prokurori nuk është përcaktuar

shprehimisht si një prej subjekteve që kanë të drejtë të konkurrojnë për plotësimin e 1/5 e vendeve nga jogjyqtarët për në Gjykatën e Lartë sikurse ka qenë në kuadrin paraardhës ligjor për plotësimin e kësaj gjykate.

Edhe hipoteza më e mundshme ajo e një boshllëku legjislativ në këtë drejtim e humbet kuptimin në rastin kur në ligj citohet subjekti avokat si një nga kandidaturat për këtë proces në kushtet kur gjatë procedurës së dhënies së drejtësisë penale, avokati vetëm në procesin e gjykimit është një nga palët e procesit duke qëndruar pikërisht përballë prokurorit që mbron akuzën në emër të shtetit dhe në këto kushte nuk mund të shpjegohet mungesa e palës tjetër ku prezumohet se diskriminimi është i papranueshëm.

Se ndonëse vetëm me gjykimin jam palë, në hierarkinë e subjekteve të së drejtës penale, prokurori të paktën nuk qëndron në shkallë më të ulët nga avokati duke patur parasysh pa subjektin prokuror nuk ka kuptim vetë procesi juridiko-penal pasi vetëm ky subjekt dhe askush tjetër sipas kuadrit kushtetueso-ligjor në fuqi që mund të ngrejë akuzën penale apo se në fazën e hetimit paraprak, që krahas gjykimit është një nga dy fazat e procesit penal, është subjekti që procedon dhe jo palë e procesit, etj.

Nga ana tjetër, në rastin se për këtë situatë do të vlerësohej se nuk ekziston ndonjë boshllëk ligjor, do të duhej t'u jepej një përgjigje bindëse dhe e bazuar në kuadrin kushtetueso-ligjor pyetjeve të mëposhtme:

A është shteruese ose joshteruese (e hapur edhe për përfshirjen e subjekteve të tjera), lista e subjekteve të përcaktuara në nenin 49/1 të ligjit 96/2016 për plotësimin e 1/5 së vendeve nga jogjyqtarët në Gjykatën e Lartë?

Në kushtet e prezumimit të mos cenimit të parimit kushtetues të mosdiskriminimit, a mund t'u mohohet e drejta prokurorëve për të kandiduar për plotësimin e vendeve nga jogjyqtarët në Gjykatën e Lartë?

Në se jo, në cilën kategori të subjekteve të përcaktuara në nenin 49/1 të ligjit 96/2016 për plotësimin e 1/5 së vendeve nga jogjyqtarët në Gjykatën e Lartë, hyjnë prokurorët?

Vlerësimin tim për sa më sipër e kam parashtruar edhe në materialet e mia të mëparshme për Këshillin, duke arritur në përfundimet subjektive se ajo listë është shteruese, se prokurorët nuk bëjnë pjesë në asnjë prej kategorive shteruese të listës dhe se

prokurorëve nuk mund t'u mohohet kandidimi për të plotësuar 1/5 e vendeve nga jogjyqtarët për në Gjykatën e Lartë.

Por edhe në kushtet nëse do të vlerësohej se në këtë rast ekziston një boshllëk ligjor, zgjidhja e kësaj situate dhe çdo interpretim ligjor i asaj do të duhej të ishte në favor të vazhdimit të kandidimit tim, bazuar në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe parimet e gjithë pranura të sistemit juridik shqiptar, të tilla si: Së pari, qëndrimin e shprehur të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në disa vendime të saj, sipas të cilit gabimet e autoritetit shtetëror (që në këtë do të ishte ligjvënësi), nuk duhet të penalizojnë individin e përfshirë në çështje (në këtë rast subjekti im kandidues), por ato duhet të merren përsipër nga shteti; Së dyti, parimi i jurisprudencës sonë kushtetuese sipas të cilit gjykata (dhe në këtë rast Këshilli i Lartë Gjyqësor vepron thajse si gjykatë), nuk mund të mos e zgjidhë çështjen me pretendimin se ligji nuk ekziston; Së treti, sipas parimit të jurisprudencës sonë kushtetuese sipas së cilës, në mungesë të qartësisë së prezumuar, interpretimi i zgjeruar i normës juridike mund të kryhet vetëm në rast se ky interpretim është në favor të të drejtave të individit.

Me konsideratë për detyrën tuaj, kërkuesi magjistrati {...}.”

Pra këto janë shpjegimet që kandidati ka dhënë gjatë procedurës administrative të verifikimit, duke pretenduar që mungesa e doktoraturës nuk është e nevojshme në rastin e tij, pasi ai kandidon si magjistrat jogjyqtar.

Në këtë gjetje aktualisht i është referuar Komisionit, i cili më pas e ka paraqitur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me këtë arsyetim dhe do të më duhet më poshtë pastaj të paraqes arsyetimin ligjor sepse shkaqet që ka paraqitur kandidati nuk janë të bazuara dhe pse relatori ka proceduar më pas në propozimin për skualifikimin dhe përjashtimin e këtij kandidati për efekt të mungesës së doktoraturës.

Po të shikojmë për të kuptuar edhe qëllimin e kushtetutëbërësit dhe t'i referohemi edhe kompozimit të gjykatës së mëparshme, të Gjykatës së Lartë, do të shikojmë që prurjet nga prokuroria kanë qenë goxha të mëdha në raport me ndryshimin që ka bërë më pas Kushtetuta.

Më të detajuar më lejoni që ta paraqes si më poshtë:

Relatori duke u mbështetur në dispozitat Kushtetuese, ligjin specifik dhe nënligjorë të zbatueshme për çështjen në shqyrtim si edhe nga aktet që janë të depozituar në dosjen

personale të kandidatit {...}, vlerëson se ky i fundit duhet të s'kualifikohet nga kandidimi për një pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë. Në këtë konkluzion relatori ka arritur pasi ka marrë në vlerësim dispozitat kushtetuese dhe ato ligjore me qëllim identifikimin e frymës dhe qëllimit të kushtetutëbërësit në lidhje me përzgjedhjen e anëtarit të Gjykatës së Lartë.

Jam i detyruar të citoj të plotë nenin 136 dhe më pas vetëm t'i përmend dispozitat e tjera ligjore, për të mos humbur kohë.

Në nenin 136 të Kushtetues se Republikës së Shqipërisë është përcaktuar ndër të tjera se:

“Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtareve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit. Një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë përzgjidhen mes juristeve të spikatur me jo me pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës. Kandidatet që përzgjidhen nga radhët e juristëve duhet të kenë gradë shkencore në drejtësi; Kandidati jogjyqtar nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 viteve të fundit para kandidimit. Kriteria të tjera dhe procedura e përzgjedhjes parashikohet me ligj.”

Në ligjin 96/2016 për Statusin është cituar neni 2 ku përmendet nocioni i magjistratit i cili përfaqëson gjyqtarin me përjashtim të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, prokurorin dhe kryetarin në kuptim të shkronjës “g” të këtij neni”.

Neni 28 ku janë kriteret ligjore të detyrueshëm që një kandidat duhet të ketë për të kandiduar në Gjykatën e Lartë.

Neni 32, 47, 48 të cituara dhe 49. Pra po të shikojmë interpretimin e dispozitave kushtetuese, duket që kushtetutëbërësi ka dashur që të vendosë aktualisht ndryshimet e reja një informacion të pasur për gjyqtarët të cilët do përbëjnë 4/5 e Gjykatës së Lartë dhe 1/5 pastaj të merren nga juristët e spikatur apo nga juristët në fusha të ndryshme të së drejtës.

Pra rezulton se ligji ka parashikuar kategorizimin/përbërjen e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë në dy lloje të ndryshme duke vendosur në përputhje me to kriteret ligjore kualifikimi dhe metodologji të ndryshme vlerësimi me qëllim përshtatjen e përvojës së kandidatëve nga kategoria nga e cila vijnë.

Në kategorinë e parë përfshihen vetëm magjistratët gjyqtarë (neni 136 i Kushtetutës) për të cilët Kushtetuta ka parashikuar minimumin e viteve të përvojës si

magjistratë, (me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit), dhe më pas ligjvënësi në nenin 48 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve” parashikon një sistem rregullash jo vetëm për vlerësimin individual të tyre por edhe për ngritjen në detyrë e cila konsiderohet ndër të tjera si kalimi nga një pozicion në sistemin gjyqësor, në një pozicion tjetër të një niveli më të lartë”, duke përfshirë në të edhe emërimin në Gjykatën e Lartë.

Në kategorinë e dytë të përbërjes së Gjykatës së Lartë (pra në këtë 1/5) dispozitat kushtetuese kanë përcaktuar në formulë prurje nga kandidatë të cilësuar si “juristë të spikatur” me përvojë të përqendruar avokati, veprimtari mësimdhënie/akademi, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës, ku në rastin konkret mund të bënte pjesë edhe kandidati në fjalë.

Raporti i kësaj kategorie është përcaktuar në masën 1/5 e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve të kësaj gjykate dhe si kritere minimum, vjetërsinë 15 vjet dhe gradën shkencore në drejtësi, (po perifrazoj dispozitën e 136 së Kushtetutës - një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë përzgjidhen mes juristeve të spikatur me jo me pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës). Gjithashtu për këtë lloj kategori prurjesh dispozitat kushtetuese kanë parashikuar edhe kushte ndaluese, mosplotësimi i të cilave sjell pengimin e tij për kandidim, (nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në parti politike, gjatë dhjetë viteve të fundit).

Me tej në nenin 49 ligjvënësi ka përcaktuar mënyrën e vlerësimit të aftësive profesionale nëpërmjet dokumentacionit ligjor, vlerësimin të punës ndër vite dhe aftësinë në zotërimin e të paktën një gjuhe të huaj evropiane.

Në analizë të interpretimeve të mësipërm rezultoi se magjistrati prokuror nuk është i përfshirë në kategorinë e parë të përcaktuar në dispozitën kushtetuese. Në këtë kategori ai nuk mund të kandidojë pasi kushtetutëbërësi ka përcaktuar si përbërje të Gjykatës së Lartë vetëm magjistratët gjyqtarë. Siç arsyetua më lart ligji ka përcaktuar në dispozita të veçanta neni 48 dhe 49 rregullime specifike për kategoritë e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë me prurje nga magjistratët gjyqtarë dhe ata të konsideruar si “juristë të spikatur”.

Më konkretisht në kategorinë e dytë kushtetutëbërësi ka përcaktuar në mënyrë shteruese dhe në mënyrë të shprehur se në të përfshihen vetëm “juristë të spikatur” me

përvojë të përqendruar avokati, veprimtari mësimdhënie/akademi, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës duke mos evidentuar në cilësimin magjistratët prokuror. Këta të fundit mund të kandidojnë vetëm si juristë të spikatur për të cilët ligji ka parashikuar si kritere minimum vjetërsinë 15 vjet dhe gradën shkencore në drejtësi.

Në rastin konkret kandidati {...} jo vetëm nuk ka dorëzuar një dokument “gradë shkencore” por pranon faktin e mospasjes së saj duke e interpretuar plotësimin e saj me faktin e disponimit të titullit “magjistrat”.

E drejta për të kandiduar në zgjedhje është një e drejtë themelore, por jo absolute. Ligji parashikon një proces mbledhje faktesh dhe rrethanash të mbështetura në dokumentacionin zyrtar, por njëherësh ai garanton një proces të rregullt ligjor duke e detyruar kandidatin të depozitohet akte të nevojshme zyrtare që konfirmojnë plotësimin e kritereve ligjore. Për këtë qëllim kandidati {...} ishte i detyruar që ndër aktet e dorëzuara të depozitonte edhe dokumentin “gradë shkencore në drejtësi” si pjesë e detyrimit individual për të përmbushur kriteret e nenit 136 të Kushtetutës si edhe të nenit 49 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në bazë të së cilës është hapur konkurrimi nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe ka vijuar konkurrimin ky kandidat.

Nga aktet e administruara rezulton se kandidati z. {...} rezulton mangësi në dokumentacionin që duhet të plotësonte dhe dorëzonte në kuadër të procedurës së verifikimit në bazë të procedurave të parashikuara në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019.

Pra me këtë lloj arsytimi relatori ka formatuar edhe projektvendimin. Po ju lexoj dispozitivin. Ku me anë të së cilës vendoset: “Skualifikimi dhe përjashtimi i kandidatit z. {...} nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë për pozicionet e lira të shpallura me vendimin nr.110, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...}.

Kandidati ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.” Faleminderit!



**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toro!

Para se të kalojmë në vendimmarrje, kemi ndonjë diskutim apo pyetje, sqarim?

Jo!

Atëherë, kalojmë në miratimin apo jo...

Po, zoti Toska!

**Ilir Toska:** Atëherë, lidhur me çështjen e gjetjes së procedurës, sa i përket kandidatit zotit {...}, unë do desha të bëja një diskutim. Mendoj se Kushtetuta, neni 136, ku parashikohen edhe kriteret në lidhje me zgjedhjen anëtar të Gjykatës së Lartë, ka përcaktuar dy kategori kandidatësh në pikën 3 të saj: një kategori janë gjyqtarët (fjalia e parë) dhe kategoria tjetër janë juristët e spikatur (që është fjalia e dytë). Ndërkohë në pikën 4, Kushtetuta flet për kandidatë jogjyqtarë.

Nga interpretimi i të dyja këtyre dispozitave, duket që Kushtetuta ka përcaktuar që anëtarët e Gjykatës së Lartë mund të vijnë nga dy burime: një burim janë radhët e gjyqtarëve dhe burimi tjetër janë radhët e jogjyqtarëve. Ndërkohë, termat që janë përdorur në Kushtetutë në të njëjtën mënyrë, pra “jurist i spikatur” dhe “jogjyqtar” janë përdorur edhe në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”. Krijohet një konfuzion nëse prokurori, i cili nuk është thjesht një jurist, por është magjistrat, në kuptim të legjislacionit të reformës në drejtësi, pra i barazuar edhe me gjyqtarin, përfshihet ose jo me ndonjë prej kategorive që përcakton Kushtetuta që mund të përzgjidhen gjyqtarët e Gjykatës së Lartë. Në një interpretim të ngushtë, duket sikur prokurori nuk hyn as në radhët e gjyqtarëve, as në radhët e jogjyqtarëve, sa kohë bëhet fjalë për “juristë të spikatur”, ku në nenin 136, pika 3, kushtetutëbërësi ka marrë përsipër edhe të listojë kush janë të gjitha profesionet që përfshihen në këtë kategori. Një nga ato nuk është magjistrati i profilit prokuror. Mund të interpretohet në një interpretim më të zgjeruar, që prokurorët duhet të përfshihen në kategorinë e juristëve të spikatur si jurist i nivelit të lartë në administratën publike, sa kohë institucioni i prokurorisë është një institucion i administratës publike. Gjithsesi prokurori nuk është thjesht një jurist i nivelit të lartë, por ai ka një titull, është “magjistrat”.

Sipas meje, duhet të ishte më e drejtë që ndarja kushtetuese të ishte bërë mes magjistratëve dhe jo-magjistratëve, por gjithsesi, kushtetutëbërësi ka zgjedhur ta ndajë mes gjyqtarëve dhe jogjyqtarëve.

Nisur nga kjo, do të mendoja që prokurorët duhet të përfshihen, siç kundër kandidati pretendon, tek radhët e jogjyqtarëve, por meqenëse kushtetutëbërësi ka marrë përsipër të listojë kategoritë e atyre subjekteve që kërkohet “grada shkencore në drejtësi”, ndërkohë nuk është specifikuar për prokurorin, mendoj se ai me të drejtë pretendon që sa kohë ka edhe gradën “magjistrat”, nuk i kërkohet një gradë e tillë për këtë kategori.

Ka një titull. Titull është “magjistrat”.

Gjithsesi mund të diskutoni zoti Qoku.

**Maksim Qoku:** Vetëm diçka.

**Ilir Toska:** Ta mbaroj diskutimin.

Atëherë, për këtë, kam në konsideratë edhe kriteret kushtetuese që vendoset për Prokurorin e Përgjithshme. Për Prokurorin e Përgjithshëm, kushtetutëbërësi ka konsideruar që të jetë nga radhët e “juristëve të spikatur” por nëse ka mbaruar Shkollën e Magjistraturës, nuk kërkon gradë, ndërsa “juristët e spikatur” që nuk kanë mbaruar këtë shkollë, kërkohet “gradë shkencore në drejtësi”. E thënë ndryshe, përfshirë edhe gjyqtarët, që mund të jetë një nga kategoritë që kanë mbaruar Shkollën e Magjistraturës, që është e vetmja prurje për në sistemin gjyqësor, në rastin e kandidimit për Prokuror të Përgjithshëm nuk kërkohet që ata të mbajnë “gradë shkencore në drejtësi”. Për të bërë të njëjtin arsyetim, duhet që, sipas meje, për magjistratin profili prokuror, në rastin e konkurrimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nuk kërkohet “gradë shkencore në drejtësi”. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Mendim tjetër?

**Maksim Qoku:** Në fakt, në referim të asaj që dëgjova nga relatori, nuk do kisha dëshirë që të hapeshim sepse është e konstatueshme lehtë që neni 49, pika 1 e përmend dhe thotë pjesa “ose në fusha të tjera të së drejtës” është pjesë e përfshirë, çka do të thotë kërkohet “grada shkencore në drejtësi” dhe mjafton ky konstatim, ne nuk e bëjmë më këtë debat. Megjithatë, pse s’desha të hapemi?

Mund të kemi nesër një magjistrat prokuror me “gradë në drejtësi”. Atëherë do të na detyronte që të shpreheshim. Sikurse mund të kemi magjistratë gjyqtarë me “gradë shkencore në drejtësi” dhe i fusim nga kërkimi nga juristë të spikatur, se edhe ata janë magjistratë në atë fushën e spikatur.

Ideja është që kushtetutëbërësi apo ligjvënësi është i njëjti që bën ligjin dhe Kushtetutën, kështu që unë kam qenë i asaj idesë që ai nuk gabon kurrë, çka do të thotë që

fakti që ka bërë këtë ndarje, fakti që ka kërkuar këto kushte, mungesa e të cilave të përjashton nga konkurrimi, ne nuk kemi ç'të interpretojmë.

Nëse do ruaja rezervën, do na shfaqej një situatë e asaj natyre, një prokuror me “gradë shkencore në drejtësi” apo edhe një magjistrat gjyqtar me “gradë shkencore”, ku do të konkurronin në njërin apo tjetrin pozicion, mbase ne si anëtarë do duhet që të bëjmë opinionin. Prandaj dhe në aspektin konkret jam me relatorin. Skualifikimi vjen për mungesën e një kushti haptazi të dukshëm, mungesa e “gradës shkencore”. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Ndonjë sqarim? Diskutim?

**Alban Toro:** Dy gjëra të vogla.

Jam munduar të kuptoj se cili ka qenë qëllimi i ligjvënësist në rastin konkret kur ka bërë këtë formulim të Gjykatës së Lartë. Po t'i referohemi përbërjes së Gjykatës së Lartë të mëparshëm do të shikoni dhe konstatooni (kolegu mund ta konfirmojë) që ka pasur goxha prokurorë në radhët e Gjykatës së Lartë dhe ndoshta me ndryshimin që ai ka bërë, pra me këtë formulë, ai ka dashur që të krijojë një kast 4/5 vetëm nga gjyqësori (pra gjyqësor i pastër vetëm nga radhët e gjyqtarëve), ndërkohë që 1/5 ta konfigurujë me elementë të tillë avokatë, juristë të spikatur apo juristë nga fusha të caktuara të së drejtës, ku natyrisht mund të bënte pjesë edhe ky kandidat, mjafton që të paraqiste një doktoraturë. Kështu që, besoj është e qartë si dispozita kushtetuese, si qëllimi, mjafton t'i referohesh para dhe mbrapa përbërjes së Gjykatës së Lartë se si ka qenë rregulluar, dhe në këtë aspekt mendoj që ky do të përbënte një shkak skualifikimi. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Nëse nuk kemi ndonjë koment apo diskutim, interpretim, qëndrim, kalojmë në vendimmarrjen sipas propozimit të bërë nga relatori dhe Komisioni i Zhvillimit të Karrierës?

Fillojmë vendimmarrjen për propozimin. Relatori!

**Alban Toro:** Dakord.

**Ilir Toska:** Kundër.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

*Erjon Muharremaj*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Medi Bici*: Pro.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi propozimin e bërë nga relatori dhe Komisioni i Zhvillimit të Karrierës mbi skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit, z. {...} nga procedurat për emërimin si anëtar në Gjykatën e Lartë, në pozicionet e lira të shpallura.

Pesë minuta pushim.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 11.09.2019)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur” (në fushën e të drejtës civile), i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:10 dhe mbaroi në orën 17:45.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
5. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
11. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Antuen Skënderi, Këshilltare e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
5. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
6. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
7. *Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
8. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
9. *Aurora Ndreu, Specialiste pranë Sektorit të Oponencës Juridike dhe Përafrimit të Legjislacionit.*
10. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
11. *Gregor Borgowski, EURALIUS.*
12. *Klodian Rado, EURALIUS.*
13. *Charles Ericksen, USAID.*
14. *Valbona Bala (Pajo), USAID.*

#### **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur” (në fushën e të drejtës civile), i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*Naureda Llagami:* Pesë minuta pushim.

*(Pas pauzës së shkurtër, rifillon sërish mbledhja plenare.)*

Kthehemi prapë në mbledhje.

Pasi mbaruam diskutimin e çështjes së parë, kalojmë tek diskutimi i çështjes së dytë të përcaktuar në rendin e ditës, e cila ka të bëjë me shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur (në fushën civile), të një pozicioni.

Lidhur me relatimin e këtij projekt-akti, fjalën do ia jap kryetarit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, zotit Ilir Toska.

***Ilir Toska:*** Faleminderit!

Atëherë, po ju parashtroj relacionin për miratimin e projektvendimit për shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur.

Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, dhe vendimin e datës 5 korrik 2019, nr. 102, “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jo-gjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”, i hapi rrugën nisjes së procesit të emërimit të kandidatëve jo-gjyqtarë në Gjykatën e Lartë.

Mbështetur në këto akte nënligjore, të nevojshme për verifikimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve jo-gjyqtarë për propozimin e tyre për emërim në Gjykatën e Lartë, bazuar në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 48, pikat 3/c dhe 5, si dhe nenin 49 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, propozon projektvendimin “Për shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur”.

Në hartimin e këtij akti, Komisioni ka pasur si qëllim identifikimin e kandidatit që përfaqëson juristin më të spikatur në kuptim të nenit 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 49, pika 1, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, por edhe që ka ekspertizën e veçantë në fusha të veçanta të së drejtës, duke patur parasysh për këtë nenin 31 të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, në lidhje me organizimin përmes tre kolegjeve të Gjykatës së Lartë, konkretisht Kolegjit Civil, Kolegjit Penal dhe Kolegjit Administrativ, çka përcakton dhe fushat respektive të së drejtës të profilizimit të gjyqtarëve të kësaj gjykate.

Sjellim në vëmendje fillimisht se me vendimet nr. 108, nr. 109 dhe nr. 110, të datës 09.07.2019, KLGJ shpalli nisjen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë, duke u bërë thirrje kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur, për të kandiduar për tre pozicione të lira, në fushën e së drejtës administrative, të së drejtës civile dhe në fushën e së drejtës

penale, dhe për të vijuar më pas, mbështetur në vendimin nr. 75/2019, me nisjen e procedurës së verifikimit të kandidatëve që shprehën interes. Pra Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimet e sipërcituara të datës 9 korrik 2019, bazuar në propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, vlerësoi shpalljen e procedurës së emërimit për në Gjykatën e Lartë për 3 pozicione të lira të përhershme, duke marrë për bazë numrin e përgjithshëm të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë (19 gjyqtarë), anëtarët në detyrë të saj të emëruar nga radhët e juristëve të spikatur dhe që nuk kishin përfunduar mandatin (1 i tillë), si dhe numrin e gjyqtarëve që mund të emëroheshin në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur (1/5 e numrit të përgjithshëm ose 4).

Mbi këtë bazë, duke vlerësuar se Këshilli me vendimet e tij nr. 108, nr. 109 dhe nr. 110, të datës 09.07.2019, shpalli nisjen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, për tre pozicione të lira, Komisioni propozon shpalljen e nisjes së procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, edhe për një pozicion tjetër të lirë.

Shpallja e këtij pozicioni të lirë vjen për shkak se, me njoftimin e bërë publik më datë 26.07.2019, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “b” të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr.46, datë 24.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit z. {...}, gjyqtar ky i emëruar pranë kësaj gjykate nga radhët e juristëve të spikatur.

Komisioni duke marrë shkas edhe nga informacioni i ardhur së fundmi nga Gjykata e Lartë lidhur me ngarkesën e çështjeve gjyqësore pranë kësaj gjykate deri më datë 31.08.2019, ku konstatohet lehtësisht numri shumë i lartë i çështje civile dhe administrative në raport me çështjet penale, propozon që pozicioni i lirë që duhet të shpallet për emërim në Gjykatën e Lartë të jetë në fushën e të drejtës civile. Plotësimi i pozicionit të lirë në Gjykatën e Lartë me juristë të spikatur, me ekspertizë të veçantë në fushën e të drejtës civile, vlerësohet se është alternativa më e drejtë referuar ngarkesës shumë të lartë në lëndë civile pranë kësaj gjykate, përveç se një gjë e tillë konsideron edhe mënyrën shumëvjeçare të organizimit në kolegje të Gjykatës së Lartë përmes dy kolegjeve civile, një kolegji administrativ dhe një kolegji penal. Kjo përpara situatës së fundit në Gjykatën e Lartë që me krijimin edhe të Kolegjit Administrativ, më herët ka pasur dy Kolegje Civile dhe një Kolegj Penal.



Nisur nga sa më sipër lidhur me përmbajtjen e projektvendimit, për këtë pozicion të lirë, ai përbëhet nga 4 Krerë, strukturuar në përputhje me përcaktimet e bëra në pikën 5 të nenit 48 në lidhje me pikën 4 të nenit 49, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Konkretisht, në Kreun I, mbështetur edhe në nenin 31 të ligjit nr. 98/2016 përcaktohet shpallja e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërja e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e juristëve të spikatur, me ekspertizë të veçantë në fushën e së drejtës civile.

Në Kreun II, titulluar “Afati i kandidimit”, projektvendimi përcakton afatin brenda të cilit kandidatët mund të aplikojnë për pozicionin e lirë të shpallur në Gjykatën e Lartë, duke vendosur një afat dyjavor, që është afati minimal i përcaktuar nga ligji, me qëllim përshpejtimin e procedurave të emërimit.

Në Kreun III, titulluar “Informacioni dhe dokumentacioni që i bashkëlidhet kandidimit”, projektvendimi rregullon informacionin për procedurën e emërimit dhe për dokumentacionin e kandidimit.

Kështu pika 1 përcakton se çdo jurist që plotëson kushtet dhe kriteret e parashikuara në nenin 136, pikat 3/c dhe 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 49, pikat 1, 2 dhe 5, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ftohet të marrë pjesë në këtë procedurë konkurrimi të hapur publike dhe të paraqesë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dokumentacionin sipas pikës 6 të këtij Kreu.

Ndërsa, në pikën 2 janë parashikuar kushtet që duhet të plotësojë kandidati për t’u emëruar në Gjykatën e Lartë të cilat përcaktohen nga nenit 136, pikat 2 dhe 3, të Kushtetutës, që janë: a) të ketë vjetërsi në profesion, prej 15 vjetësh, si avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës; b) të mbajë gradë shkencore në drejtësi; c) të mos ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit.

Në pikën 3 të këtij Kreu përcaktohet se kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 2, duhet të plotësojë edhe kriteret, sipas nenit 48, pika 3, shkronja “c” dhe pika 5, si dhe nenit 49 të ligjit nr. 96/2016 të tilla si : a) të ketë zotësi të plotë për

të vepruar; b) të jetë shtetas shqiptar; c) të mos jetë i dënuar me vendim penal të formës së prerë; ç) të mos jetë i larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi; d) të mos ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990; dh) të mos ketë qenë dhe të mos jetë bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete; e) të kalojë me sukses procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, sipas ligjit.

Më tej, në pikën 4 të këtij Kreu parashikohet se plotësimi i kushteve dhe kriterëve të mësipërme verifikohet sipas kërkesave dhe procedurës së përcaktuar në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”.

Kurse pika 5 e Kreut 3 parashikon se kandidati që përmbush kushtet dhe kriteret e parashikuara në pikat 2 dhe 3 të këtij Kreu, vlerësohet, pikëzohet dhe renditet sipas kërkesave dhe procedurës së përcaktuar në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 102, datë 05.07.2019, “Për kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jo-gjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”.

Për sa i përket dokumentacionit të kandidimit, pra dokumentacionit që duhet të paraqesë në momentin e aplikimit, ai përcaktohet në pikën 6 të këtij Kreu, ku listohen në mënyrë shteruese si më poshtë këto dokumente: a) kërkesën për shprehjen e interesit për të kandiduar për pozicionin e lirë, sipas kërkesave të shpallura; b) jetëshkrimin, me të dhënat e plota të kontaktit (numër telefoni/e-mail); c) fotokopje të kartës së identitetit; ç) dokumentacionin shoqërues nëpërmjet të cilit vërtetohet përmbushja e kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të këtij Kreu.

Kreu i fundit i projektvendimeve, Kreu IV, përcakton vendin ku duhet të dorëzohet dokumentacioni i kandidatëve sipas pikës 6 të Kreut III, që është pikërisht Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Së fundmi, parashikohet që projektvendimi të hyjë në fuqi menjëherë me botimin e tij në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Bashkëlidhur relacionit është edhe projektvendimi, të cilin po e lexoj.

“Projektvendim “Për shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 48, pikat 3/c dhe 5, në nenin 49 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si edhe në nenin 31, pika 1, të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, vendosi:

1. Shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në fushën e të drejtës civile.

2. Afati i kandidimit është dy javë nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Informacioni dhe dokumentacioni që i bashkëlidhet kandidimit –

Çdo jurist, që plotëson kushtet dhe kriteret e parashikuara në nenin 136, pikat 3 dhe 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 49, pika 1, 2 dhe 5, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ftohet të marrë pjesë në këtë procedurë konkurrimi të hapur publike dhe të paraqesë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dokumentacionin sipas pikës 6 të këtij Kreu.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për t’u emëruar në Gjykatën e Lartë, sipas nenit 136, pikat 3 dhe 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, janë si më poshtë:

a) të ketë vjetërsi në profesion, prej 15 vjetësh, si avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës;

b) të mbajë gradë shkencore në drejtësi;

c) të mos ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit;

3. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara më sipër, duhet të plotësojë edhe kriteret, sipas nenit 48, pika 3, shkronja “c” dhe pika 5, si dhe nenit 49 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si më poshtë:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

b) të jetë shtetas shqiptar;

c) të mos jetë i dënuar me vendim penal të formës së prerë;

ç) të mos jetë i larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

d) të mos ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990;

dh) të mos ketë qenë dhe të mos jetë bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete,

e) të kalojë me sukses procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, sipas ligjit.

4. Plotësimi i kushteve dhe kriterëve të mësipërme verifikohet sipas kërkesave dhe procedurës së përcaktuar në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”.

5. Kandidati që përmbush kushtet dhe kriteret e parashikuara në pikat 2 dhe 3 më sipër, vlerësohet, pikëzohet dhe renditet sipas kërkesave dhe procedurës së përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 102, datë 05.07.2019, “Për kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jo-gjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”.

6. Në momentin e aplikimit kandidati duhet të paraqesë këto dokumente:

a) Kërkesën për shprehjen e interesit për të kandiduar për pozicionin e lirë, sipas kërkesave të shpallura;

b) Jetëshkrimin, me të dhënat e plota të kontaktit (numër telefoni/e-mail);

c) Fotokopje të kartës së identitetit;

d) Dokumentacionin shoqëruës nëpërmjet të cilit vërtetohet përmbushja e kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të këtij Kreu.

Kreu IV- Vendi i dorëzimit të dokumentacionit -

1. Dokumentacioni i kandidatëve sipas pikës 6 të Kreut III, duhet të dorëzohet pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.” Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, kalojmë në vendimmarrje në qoftë se nuk keni ndonjë diskutim?

Kalojmë në vendimmarrje të projekt-aktit të propozuar nga Komisioni.

**Maksim Qoku:** Dakord.

*Brunilda Kadi*: Pro.

*Dritan Hallunaj*: Pro.

*Illir Toska*: Dakord.

*Alban Toro*: Dakord.

*Fatmira Luli*: Pro.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Erjon Muharremaj*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Medi Bici*: Pro.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e projektvendimit për shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur në fushën e së drejtës civile, sipas tekstit të propozuar nga kryetari i Komisionit.

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 11.09.2019)*

**Pika 3 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për përjashtimin e gjyqtarëve {...} dhe {...} nga procedura e ndarjes së çështjeve me short”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:10 dhe mbaroi në orën 17:45.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
5. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
11. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Antuen Skënderi, Këshilltare e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
5. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
6. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
7. *Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
8. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
9. *Aurora Ndreu, Specialiste pranë Sektorit të Oponencës Juridike dhe Përafrimit të Legjislacionit.*
10. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
11. *Gregor Borgowski, EURALIUS.*
12. *Klodian Rado, EURALIUS.*
13. *Charles Ericksen, USAID.*
14. *Valbona Bala (Pajo), USAID.*

#### **RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përjashtimin e gjyqtarëve {...} dhe {...} nga procedura e ndarjes së çështjeve me short”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek çështja e tretë e rendit të ditës, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projekt-aktit/e projektvendimit “Për përjashtimin e gjyqtarëve {...} dhe {...} nga procedura e ndarjes së çështjeve me short”. Ky projekt-akt është përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale dhe do relatohet nga kryetarja e Komisionit, znj. Ukperaj.

*Brikena Ukperaj:* Faleminderit, zonja Kryetare!

Që me konstituimin e tij, Këshilli i Lartë Gjyqësor është angazhuar në mënyrë të vazhdueshme jo vetëm me monitorimin dhe menaxhimin e ngarkesës së gjyqtarëve dhe gjykatave, por edhe me marrjen e masave për lehtësimin e punës së gjyqtarëve të angazhuar në veprimtari jashtëgjyqësore por në dobi të pushtetit gjyqësor, sikundër është dhe detyra kushtetuese e anëtarit të KED-së.

Në këtë kuadër, me vendimin nr. 58, datë 24.04.2019, KLGJ ka vendosur që për një afat 3-mujor, dy anëtarët e KED-së gjyqtarja {...} dhe gjyqtari {...}, përkatësisht gjyqtarja {...} me detyrën e gjyqarit në Gjykatën e Apelit Vlorë, dhe gjyqtari {...} detyrën e gjyqarit në Gjykatën e Apelit Tiranë, të përjashtohen nga procedurat e ndarjes së çështjeve me short dhe të plotësimit të trupave gjykues.

Ky vendim i ka mbaruar efektet e tij më datë 25.07.2019, moment nga i cili të dy gjyqtarët janë përfshirë rregullisht/paralelisht me ushtrimin e veprimtarisë gjyqësore, edhe me procedurën e verifikimit të kushteve ligjore të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në vijim, Kryetari i KED-së ka shprehur angazhimin maksimal të këtij organi në përmbushjen e detyrave të ngarkuara dhe ka informuar KLGJ-në se ky organ aktualisht është i përfshirë në procesin e pikëzimit, vlerësimit dhe të renditjes së kandidatëve lidhur me katër vende vakante për Gjykatë Kushtetuese dhe është në diskutim e sipër për fillimin e procedurave për vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve për ILD apo për rishpalljen e procedurës së aplikimit për këtë vend vakant. Nga ana tjetër sipas informacionit të përcjellë nga Kryetari i KED-së, Kuvendi ka shpallur procedurën e aplikimit për plotësimin e një vendi vakant për Gjykatë Kushtetuese deri në dt.15.09.2019 moment nga i cili KED do të fillojë menjëherë procedurat e verifikimit të plotësimit të kushteve ligjore. Ai ka informuar gjithashtu se për përmbushjen e detyrave në vijim, anëtarët nuk janë të angazhuar vetëm në mbledhjet e KED-së, por secili prej tyre në cilësinë e relatorit ka detyra dhe ngarkesë të posaçme pune për ndjekjen e procesit e përgatitjen e akteve përkatëse që i paraqiten për shqyrtim mbledhjes plenare. Në këtë kuadër Kryetari i KED-së i ka kërkuar KLGJ-së që, bazuar në kompetencat përkatëse të caktuara nga ligji dhe në kohën më të shpejtë të mundshme, të marrë në vlerësim mundësinë për lehtësimin apo heqjen e ngarkesës së punës në funksionet përkatëse gjyqësore të dy anëtarëve të mësipërm të KED-së, deri në fund te vitit 2019.



Veç kërkesës së mësipërme, në KLGJ janë depozituar edhe dy kërkesa individuale të gjyqtarëve {...} dhe {...}, të cilët për shkak të ngarkesës në gjykatë dhe volumit të punës si relator të zgjedhur në KED, kanë vënë në dijeni KLGJ-në për nevojën e ngutshme që ata kanë për t'u ripërkthuar nga shorti i çështjeve të reja që regjistrohen në gjykatat e tyre, për një afat tjetër 3-mujor. Secili prej tyre ka argumentuar se janë të detyruar të përballojnë një ngarkesë të konsiderueshme në punë deri në momentin përfundimtar të pikëzimit të kandidatëve e renditjen e tyre në listat përkatëse që do i dërgohen institucioneve të emërtesës. Kjo ngarkesë pune sipas tyre e bën të pamundur gjykimin në afat të çështjeve të reja, sidomos atyre me natyrë emergjente që iu caktohen për gjykim si gjyqtar relator.

Në kërkesën e saj gjyqtarja {...} sqaron se në Gjykatën e Apelit Vlorë nuk ka ndarje në seksione, prandaj i duhet të gjykojë të gjitha llojet e çështjeve, civile, penale, familjare, bashkë me çështje urgjente si masa sigurimi apo çështje të tjera për të cilat janë parashikuar në ligj afate të ndryshme procedurale, përfshirë këtu edhe çështje penale me të pandehur të paraburgosur. Ajo sqaron se ka të shortuara si gjyqtar relator 300 çështje gjyqësore që presin të shqyrtohen dhe bashkë me to e ka të pamundur objektivisht të respektoje në vijim afatet procedurale të gjykimit të çështjeve të reja të përcaktuara në ligj, në kushtet kur paralelisht duhet t'i përkushtohet edhe fluksit të madh të punës së nisur në KED, për fazën e dytë të procesit të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve. I njëjti argumentim si më sipër ngrihet edhe nga anëtari tjetër i KED-së, gjyqtari i apelit Tiranë {...}, i cili argumenton gjithashtu se ka si ngarkesë aktuale në cilësinë e gjyqtarit relator 436 çështje gjyqësore, që presin ende të shqyrtohen.

Të dy gjyqtarët në kërkesat e tyre i janë referuar nenit 25/3 të ligjit nr.98/2016 dhe nenit 89 të ligjit nr.115/2016.

Nisur nga gjendja faktike e mësipërme, marrë parasysh edhe nga rrjedha e fundit që kanë marrë vendimmarrjet e KED-së, aktualisht sipas shpalljeve publike rezulton që të jetë në përfundim procesi i vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së anëtarëve për në Gjykatën Kushtetuese dhe aktualisht, sipas shpalljes së vendimit rezulton të jetë pezulluar procedura e vlerësimit, pikëzimit të anëtarëve të ILD-së, pasi është rishpallur përsëri thirrja për hapjen për 1 pozicion dhe ka gjasa që të fillojnë përsëri procedurat e verifikimit të plotësimit të kushteve ligjore për Inspektor të Lartë të Drejtësisë.

Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale ka vlerësuar se:

në zbatim të nenit 89 të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” si dhe duke marrë parasysh detyrën e këtij organi për të nxitur çdo veprimtari tjetër në të cilën gjyqtarët janë të përfshirë për shkak të funksionit në dobi të pushtetit gjyqësor, kërkesat e të dy gjyqtarëve por edhe shqetësimi i Kryetarit të KED-së duhet të merret parasysh dhe të vlerësohet nga ky Këshill në përputhje me nenin 25, pika 3, shkronja “dh” të ligjit 98/2016 sipas të cilit:

“... 3. Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton rregulla më të hollësishme për programin dhe procedurat e ndarjes së çështjeve me short, të cilat në veçanti përcaktojnë: ...dh) kritere transparente dhe objektive për procedurën e përjashtimit të gjyqtarëve nga shorti për shkak të ngarkesës ose për shkak të angazhimit të gjyqtarëve në veprimtari të tjera në funksion të gjykatës apo të pushtetit gjyqësor; ...”

Dispozita e mësipërme lejon përjashtimin tërësisht të gjyqtarëve nga shorti i çështjeve të reja të regjistruara në gjykatë mbi bazën e kritereve transparente dhe objektive të miratuara nga KLGJ, në dy raste:

- a) për shkak të ngarkesës, ose;
- b) për shkak të angazhimit të gjyqtarëve në veprimtari të tjera në funksion të gjykatës apo të pushtetit gjyqësor.

Në kushtet aktuale kur ende nuk ka një akt të miratuar nga KLGJ lidhur me rregullat dhe personin përgjegjës për zbatimin e tyre, mbetet detyrë e këtij organi të vlerësojë të dy kërkesat e gjyqtarëve. Në rastin konkret të dy gjyqtarët që ushtrojnë funksionet e tyre në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, janë të angazhuar për shkak të një detyrimi kushtetues në funksionin e anëtarit relator të KED-së. Në lidhje me volumin e punës që paraqet për secilin relator procesi i verifikimit e vlerësimit të kandidatëve për Gjykatë Kushtetuese dhe Inspektor të Lartë të Drejtësisë, i referohemi përmbajtjes së nenit 228, pika 5 të ligjit ku janë të përcaktuara të gjitha detyrat që kryen relatori dhe veç parashikimit ligjor, i referohemi edhe vendimit nr. 5, datë 02.04.2019 të KED-së “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, sipas të cilit relatori i vendit vakant realizon njëkohësisht të gjitha veprimet përgatitore të procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve, jo më vonë se 5 ditë nga ajo e përfundimit të procedurave të verifikimit të të gjithë kandidatëve që kanë shprehur interesin pranë të njëjtit organ emërtese që ka shpallur

vendet vakante. Sipas së njëjtit vendim, KED qëndron i mbledhur, bën vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve për vendet vakante të shpallura nga i njëjti organ emërtese, jo më vonë se 10 ditë nga dita e mbledhjes.

Veç veprimeve të mësipërme, sipas të njëjtit vendim të KED-së, pika 27 dhe 28 e vendimit nr. 5, datë 02.04.2019), relatori kryen të gjitha veprimet e tjera që kanë të bëjnë me komunikimin me kandidatët, pranimin dhe plotësimin e dokumentacioneve, përgatitjen e dokumentacioneve dhe projekt-akteve për shqyrtim nga Këshilli lidhur me procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve, administron kopje të dokumentacionit, njofton kandidatin për të dhënë shpjegime apo për të saktësuar ose plotësuar dokumentacionin, njofton relatorët e tjerë të vendeve vakante për veprimin procedural të kryer, përgatit dhe paraqit për shqyrtim në Këshill relacionin që përmban përshkrimin e procedurave të ndjekura gjatë veprimeve përgatitore, të dokumenteve dhe përmbledhjen faktike të tyre për qëllime të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatit, si edhe kopje të këtyre dokumenteve bashkëlidhur relacionit.

Në këtë këndvështrim kjo natyrë e punës e cila sipas ligjit duhet të përfundojë brenda afateve të posaçme procedurale, e ushtruar njëkohësisht me funksionin e gjyqtarit, kërkon marrjen e masave nga ana e KLGJ-së, me qëllim krijimin e kushteve të punës sa më të favorshme për anëtarët gjyqtarë njëkohësisht relatorë në KED.

Nga ana tjetër, lidhur me ngarkesën e punës, veç çështjeve që secili prej dy gjyqtarëve ka aktualisht si ngarkesë në cilësinë e gjyqtarit relator, duhet të kihet parasysh se për një kategori çështjes civile dhe penale, në ligjin procedural janë parashikuar afate të posaçme gjykimi, tej afatit 14-ditor të përcaktuar në pikën 2 të ligjit 98/2016 si afat për gjykimin e çështjeve urgjente, përmendim këtu: paditë me objekt “kundërshtim veprimesh përmbartimore”, “pavlefshmëri titulli ekzekutiv”, “urdhrat e mbrojtjes” apo “vendimet e ndërmjetme me ankim të veçantë”. Ndërsa lidhur me çështjet penale, po kështu ligji procedural parashikon afate të posaçme 10-ditore të shqyrtimit të ankimit ndaj masave të sigurimit, 15-ditor të shqyrtimit të ankimeve ndaj vendimeve të kundërshtimit të vendimit të pushimit, 30-ditor të shqyrtimit të ankimeve të kundërshtimit të vendimit të mosfillimit të procedimit penal. Nga ana tjetër, mënyra e funksionimit të sistemit elektronik të regjistrimit dhe shortimit të çështjeve në gjykata, nuk mundëson përjashtimin e gjyqtarëve nga një kategori e caktuar çështjesh.

Për sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale vlerëson se për shkak të rrethanave aktuale të ngarkesës në punë të dy gjyqtarëve {...} dhe {...} dhe volumit të punës që paraqet për secilin prej tyre në vijim procesi i verifikimit e vlerësimit të kandidatëve për Gjykatë Kushtetuese dhe Inspektor të Lartë të Drejtësisë, është e domosdoshme përjashtimi i tyre nga procedurat e shortimit të çështjeve të reja në gjykatat ku ata ushtrojnë funksionin e gjyqtarit. Lidhur me afatin e zbatimit të këtij përjashtimi, sugjerojmë që ai të jetë 3 muaj, nisur edhe nga afatet e parashikuara në ligj për fillimin e përfundimin e procedurave të verifikimit të plotësimit të kushteve ligjore e mandej atyre të parashikuara për vlerësimin, pikëzimin e renditjen, marrë në konsideratë edhe afatet e ankimit.

Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale ka vlerësuar që për të njëjtën periudhë kohore, të dy gjyqtarët të përjashtohen jo vetëm nga shortimi i çështjeve, por edhe nga procedurat e plotësimit të trupave të tjerë gjykues, veç trupit të tyre, me përjashtim të rastit kur plotësimi i trupit është i detyrueshëm. Ky propozim mbështetet në nenin 23, pika 7 të ligjit 98/2016. Nga ana tjetër përjashtimi i gjyqtarëve nga shortimi i çështjeve të reja, për shkak të mënyrës se si funksionon sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve do të sjellë automatikisht edhe përjashtimin e tyre edhe nga shortimi i plotësimit të trupave të tjerë gjykues, me përjashtim të rastit kur plotësimi është i domosdoshëm për shembull në rastin e ndreqjeve të gabimeve materiale, sqarimit apo interpretimit dhe plotësimit të vendimit gjyqësor, apo kur gjyqtari është gjyqtari i vetëm me të cilin mund të plotësohet trupi gjykues.

Lidhur me kompetencën e mbledhjes plenare, për çështjen e propozuar, vlerësojmë se:

Me ndryshimet që ka pësuar ligji 115/2016, neni 61 i shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese është riformuluar në këtë mënyrë:

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor organizohet dhe e ushtron veprimtarinë e tij në mbledhje plenare ose në komisione.

Mandej në pikën 2 nuk po e citoj, janë përcaktuar të gjitha kompetencat që ka mbledhja plenare.

Ndërkohë që pika 4 përcakton që Komisionet kryejnë veprimtari të tjera veç atyre të përmendura më sipër, në përputhje me rregulloren e brendshme.

Në kushtet kur nuk ka ende një vendimmarrje të KLGJ-së në lidhje me rregullat që duhet të zbatohen për përjashtimin e gjyqtarëve nga shorti, rregulla këto që për shkak të natyrës së tyre dhe parashikimit të mësipërm, duhet të miratohen nga KLGJ në mbledhje plenare dhe as ekziston një rregullore e brendshme për çështje për të cilat çdo Komision ka kompetenca vendimmarrëse, pavarësisht se “çështja e propozuar për vendimmarrje” nuk përfshihet në listimin e bërë nga neni 61 i sipërcituar, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale ka vlerësuar se ajo duhet t’i kalojë për shqyrtim mbledhjes plenare. Dhe vijmë aktualisht me këtë projekt-propozim:

“Projektvendim – Bazuar në nenin 147, pika 1, shkronja “ë” të Kushtetutës, nenin 61 dhe 89 shkronja “b” të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, ligjin 47/2019, nenet 23, pika 6 dhe 7 dhe 25, pika 3, shkronja “dh” të ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, mbi kërkesën e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe të vetë gjyqtarëve {...} dhe {...}, Komisionit i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, propozon për miratim në mbledhje plenare: Përjashtimin e gjyqtarëve {...}, gjyqtare në Gjykatën e Apelit Vlorë dhe {...}, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë, njëkohësisht anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, nga procedurat e ndarjes së çështjeve me short në gjykatat respektive, për një afat 3-mujor.

Përjashtimin e gjyqtarëve të mësipërm nga procedurat e plotësimit të trupave gjykues, veç trupit të tyre, për të njëjtën periudhë kohore të përcaktuar në pikën 1, me përjashtim të rastit kur plotësimi i trupit tjetër gjykues është i detyrueshëm.

Ngarkohen Kryetari dhe Kancelari i Gjykatës së Apelit Tiranë dhe Kryetari dhe Kancelari i Gjykatës së Apelit Vlorë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.”

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zonja Ukperaj!

Kemi ndonjë diskutim lidhur me projekt-aktin?

Po, zoti Toro!

**Alban Toro:** Kam dy pyetje që s'i kam të qarta.

Këto 300 çështje që ka Vlora dhe 436 që ka Tirana, janë çështje të 2019 apo të mëparshme?

E dyta, shkakut kryesor këtu është pikëzimi i kandidatëve, që kërkohet edhe përjashtimi nga shorti?

**Brikena Ukperaj:** Atëherë, numri i çështjeve është numri total i çështjeve të regjistruara dhe që ka në ngarkim secili nga gjyqtarët si gjyqtar relator, presupozon edhe çështjet e reja që kanë marrë edhe në vitet paraardhëse, jo vitin 2019 (që mund të jetë 2016), pra është e gjithë ngarkesa totale që ka ai si gjyqtar relator.

Lidhur me shkaqet për të cilat kërkohet, pretendohet dhe është konstatuar që janë të ngarkuar në procedurat e vlerësimit, pikëzimit, renditjes për anëtarët e Gjykatës Kushtetuese. Nuk kanë filluar ende procedurat e verifikimit për një vend vakant të shpallur nga Kuvendi, që pritet të mbarojë afati dhe të vijnë kandidaturat dhe njëkohësisht është rishpallur një vend vakant për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, pretendohet që të vijnë, domethënë janë në pritje, është përcaktuar edhe afati i kërkesave që do vijnë për këtë vend dhe njëkohësisht mbase do fillojë edhe procedura e pikëzimit, vlerësimit dhe renditjes për inspektorë të Lartë të Drejtësisë.

**Naureda Llagami:** Po, zoti Toro!

**Medi Bici:** Çdo gjë që tha zonja Ukperaj është e saktë, përveçse janë dy kandidatura që janë për në Gjykatën Kushtetuese, njëra është nga Kuvendi dhe tjetra është nga Parlamenti, janë ato kandidatura që janë me mandate të kufizuara, që mbarojnë në vitin '22, plus është edhe një kandidaturë për Inspektorin e Përgjithshëm dhe do të bëhet pikëzimi për të gjithë kandidatët. Ato janë të mbledhur çdo ditë.

**Alban Toro:** Atëherë, po e nisim nga shorti, që është 300 i pari dhe 436 i dyti, që pa dyshim brenda ka vitet 2016-2019. Aktualisht, gjykata e apelit, Vlora dhe Tirana gjykojnë vitet 2016-2017 që do të thotë, ajo që ju kërkoni – vazhdoj të jem konsekuent me vendimin e parë – ajo që ju kërkoni të propozoni për t'i ndihmuar, në fakt s'ndihmoni asgjë sepse efektin ky vendim, po të nisesh nga momenti që ata po gjykojnë, janë vitet 2016-2017, ne flasim për vitin 2019, që do të ndihet për këta gjyqtarë pas 2-3 vjetësh, nëse KPK-ja do t'i kursejë.

Në këto kushte, unë nuk besoj që ne i ndihmojmë dot sepse aktualisht janë pothuajse të ngarkuar, janë vitet 2016-2017 që gjykoen dhe ata nuk është se ne po i ndihmojmë në fakt. Ne thjesht po deformojmë ngarkesën e gjykatave të apelit përkatëse.

Në lidhje me pjesën tjetër pastaj, kam këtu një njoftim të Gjykatës së Lartë e cila thotë që paska mbaruar pikëzimin e kandidatëve për në Gjykatën Kushtetuese më datën 10.09.2019 dhe ka bërë një renditje të kandidatëve, nga i pari tek i teti, -më fal, i gjashti. Pra edhe kjo pjesë e ngarkesës këtyre ua paska hequr, kështu që nuk e di.

E treta është edhe softueri (*software*) i famshëm që na del vendimtar mbi çdo gjë, pasi fare mirë ne mund të kufizojmë ato çështje ligjore, për të cilat ligji ka kërkuar afate rregorizisht të respektueshëm dhe t'i përjashtojmë nga ato çështje sepse në fakt ato e ndihmojnë gjyqtarin, ndërkohë që qenka e pamundur që ky softuer të ndryshohet, ndërkohë që besoj që nuk është e vështirë që të identifikojë ato çështje që kërkojnë afate të përcaktuara ligjore. Në këtë formë ne mund t'i ndihmojmë. Kjo që propozoni juve, përsëri mbetem konsekuent i refuzimit për të votuar pro këtij materiali, siç kam bërë edhe më parë, sepse në fakt ne nuk ndihmojmë aktualisht, por ngarkojmë në mënyrë artificiale të dy gjykatat. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toro!

Ndonjë koment ose sqarim më? – Jo!

Kalojmë në votim të projekt-aktit sipas propozimit të bërë nga Komisioni përkatës. Jeni dakord?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Kundër.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: “Përjashtimin e gjyqtarëve {...}, gjyqtare në Gjykatën e Apelit Vlorë dhe {...}, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë, njëkohësisht anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, nga procedurat e ndarjes së çështjeve me short në gjykatat respektive, për një afat 3-mujor.

Përjashtimin e gjyqtarëve {...} dhe {...} nga procedurat e plotësimit të trupave të tjerë gjykues, veç trupit të tyre, për të njëjtën periudhë kohore të përcaktuar në pikën 1 të projektvendimit, me përjashtim të rastit kur plotësimi i trupit tjetër gjykues është i detyrueshëm.

Ngarkohen Kryetari dhe Kancelari i Gjykatës së Apelit Tiranë dhe Kryetari dhe Kancelari i Gjykatës së Apelit Vlorë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.”

\* \* \*

(Pika 3 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 11.09.2019)*

**Pika 4 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i opinioneve për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve që kanë shprehur interes për komandimin pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:10 dhe mbaroi në orën 17:45.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
5. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
11. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Antuen Skënderi, Këshilltare e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 6. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 7. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
- 8. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 9. Aurora Ndreu, Specialiste pranë Sektorit të Oponencës Juridike dhe Përafrimit të Legjislacionit.*
- 10. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 11. Gregor Borgowski, EURALIUS.*
- 12. Klodian Rado, EURALIUS.*
- 13. Charles Ericksen, USAID.*
- 14. Valbona Bala (Pajo), USAID.*

#### **RENDI I DITËS:**

4. Shqyrtimi i opinioneve për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve që kanë shprehur interes për komandimin pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*Naureda Llagami:* Kalojmë sipas rendit të ditës në çështjen e katërt, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për dhënien e opinionit për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve që kanë shprehur interes për komandimin pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Atëherë, fjalën ia jap zotit Alban Toro, anëtar i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

**Alban Toro:** Opinion mbi kandidatët që kanë aplikuar për t'u komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor - Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 79 shkronja "b" të ligjit 115/2016, në nenet 53, 54, 57 dhe 58 të ligjit nr. 96/2016, me vendimin nr. 104, datë 05.07.2019 ka shpallur hapjen e procedurës për paraqitjen e kërkesës nga kandidaturat që vijnë nga radhët e gjyqtarëve, për t'u komanduar, me pëlqimin e tyre, për: Dy pozicione "këshilltar ligjor" në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Këshillit të Lartë Gjyqësor; Dy pozicione "nëpunës përgjegjës për vlerësimin" në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve.

Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është përcaktuar 2 javë nga dita e shpalljes së vendimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Brenda afatit të caktuar për paraqitjen e kërkesave për komandim, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor kanë paraqitur kërkesë 5 gjyqtarë sipas këtij rendi kronologjik të mëposhtëm:

Në datën 15.07.2019 pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është protokolluar kërkesa e gjyqtares {...}, e cila ushtron funksionin e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, e cila ka shfaqur vullnetin për t'u komanduar në një nga pozicionet e shpallura për "këshilltar ligjor" ose për "nëpunës përgjegjës për vlerësimin";

Në datën 16.07.2019 pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është protokolluar kërkesa e gjyqtares {...}, e cila ushtron funksionin e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila ka shfaqur vullnetin për t'u komanduar në një nga pozicionet e shpallura për vetëm për "nëpunës përgjegjës për vlerësimin";

Në datën 19.07.2019 pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është protokolluar kërkesa e gjyqtares {...}, e cila ushtron funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, e cila ka shfaqur vullnetin për t'u komanduar në një nga pozicionet e shpallura për "këshilltar ligjor" ose "nëpunës përgjegjës për vlerësimin";

Në datën 19.07.2019 pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është protokolluar kërkesa e gjyqtares {...}, e cila ushtron funksionin e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, e cila ka shfaqur vullnetin për t'u komanduar në një nga pozicionet e shpallura për vetëm për "nëpunës përgjegjës për vlerësimin";

Në datën 19.07.2019 pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është protokolluar kërkesa e gjyqtares {...}, e cila ushtron funksionin e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, e cila ka shfaqur vullnetin për t'u komanduar në një nga pozicionet e shpallura për vetëm për “nëpunës përgjegjës për vlerësimin”;

Duke qenë se Këshilli i Lartë Gjyqësor në rastin konkret, veç shpalljes së procedurës së komandimit është njëkohësisht dhe vetë institucioni që ka nevojë për gjyqtarin e komanduar, procedura e komandimit sipas vendimit nr. 104, datë 05.07.2019, kalon në dy faza verifikimi:

Në fazën e parë Komisioni për Zhvillimin e Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e larta të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin. Projekt-opinionin për çdo kandidat shqyrtohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor jo më vonë se një javë pas njoftimit të Kryetarit të Këshillit për përgatitjen e tyre. Opinionet e miratuara nga Këshilli publikohen në faqen zyrtare të tij. Këshilli vendos përjashtimin nga komandimi të kandidatit, komandimi i të cilit nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku ai ushtron funksionin apo kur për kandidatin verifikohet ndonjë prej kriterëve të tjera ndaluese të komandimit.

Në fazën e dytë procedura e komandimit vijon me vlerësimin e kriterëve të kandidimit për të gjithë kandidatët që nuk janë përjashtuar nga kandidimi në fazën e parë. Ky vlerësim bëhet nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, i cili, kur çmon të nevojshme, mund të intervistojë kandidatin për verifikimin e kriterëve të kandidimit. Intervista dokumentohet në një procesverbal me shkrim. Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale brenda dy javëve i paraqet Këshillit të Lartë Gjyqësor një raport ku pasqyrohen të dhënat rreth përmbushjes nga kandidatët të kriterëve të kandidimit, përveç edhe një renditje të tyre duke filluar nga kandidati i vlerësuar më mirë. Krahas kësaj, Komisioni i paraqet Këshillit dhe një propozim për komandim me emrat e katër kandidatëve të renditur më lart.

Sa më sipër në përgatitjen e këtij opinionin për secilin kandidat, Komisioni për Zhvillimin e Karrierës verifikon për secilin kandidat, ekzistencën ose jo të ndonjë prej kriterëve ndaluese si dhe vlerëson cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit të gjykatës ku ushtron detyrën gjyqtari që ka paraqitur kërkesën për komandim.

Në lidhje me kriteret ndaluese të komandimit, nga dokumentacioni i depozituar dhe dosja personale e gjyqtarit, rezulton se:

Gjyqtarja {...}, ushtron detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat nga data 23.01.2014, pasi me dekretin 8464, datë 23.01.2014 të Presidentit të Republikës, është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat. Ajo ka një eksperiencë profesionale në punë mbi 5 vjet, nuk ndodhet në një pozicion me mandat të kufizuar, nuk është dhe as ka qenë më parë e komanduar dhe nuk ka mase disiplinore në fuqi. Në këto kushte për këtë gjyqtare nuk ekziston asnjë kriter ndalues komandimi.

Gjyqtarja {...}, ushtron detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë që prej datës 25.09.2015, pasi me dekretin 9241, datë 25.09.2015 të Presidentit të Republikës, është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë. Ajo ka një eksperiencë profesionale në punë mbi 3 vjet, nuk ndodhet në një pozicion me mandat të kufizuar, nuk është dhe as ka qenë më parë e komanduar dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi. Në këto kushte për këtë gjyqtare nuk ekziston asnjë kriter ndalues komandimi.

Gjyqtarja {...}, ushtron detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër që prej datës 23.01.2014, pasi me dekretin 8466, 23.01.2014 të Presidentit të Republikës, është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër. Ajo ka një eksperiencë profesionale në punë mbi 5 vjet, nuk ndodhet në një pozicion me mandat të kufizuar, nuk është dhe as ka qenë më parë e komanduar dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi. Në këto kushte për këtë gjyqtare nuk ekziston asnjë kriter ndalues komandimi.

Gjyqtarja {...}, ushtron detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë që prej 23.06.2016, pasi me dekretin 9658, 23.06.2016 të Presidentit të Republikës, është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Ajo ka një eksperiencë profesionale në punë mbi 3 vjet, nuk ndodhet në një pozicion me mandat të kufizuar, nuk është dhe as ka qenë më parë e komanduar dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi. Në këto kushte për këtë gjyqtare nuk ekziston asnjë kriter ndalues komandimi.

Gjyqtarja {...}, ushtron detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër që prej datës 05.10.2007. Ajo është emëruar gjyqtare me dekretin 5481, 05.10.2017 të Presidentit të Republikës, dhe është caktuar fillimisht për kryerjen e stazhit profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Në vijim me dekretin tjetër nr. 6112,

25.03.2009 ajo është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Ajo ka një eksperiencë profesionale në punë prej më shumë se 10 vjet dhe aktualisht nuk ndodhet në një pozicion me mandat të kufizuar dhe as ka marrë masë disiplinore në fuqi. Gjatë karrierës së saj profesionale kjo gjyqtare me vendimin 297/7, 15.11.2012 është komanduar në pozicionin e ndihmësit ligjor pranë gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, për një afat 3-vjeçar, i cili i ka përfunduar në datën 15.11.2015. Që nga ky moment ajo është rikthyer në detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Në kushtet kur kjo gjyqtare ka qenë e komanduar më parë, për lejimin sërish të komandimit, në zbatim të nenit 53, pika 7 të ligjit 96/2016 dhe shkronjës “e” të pikës 4 kreu II i vendimit 104, datë 05.07.2019, duhet që të ketë kaluar një periudhë jo më pak se 5 vjet, pas përfundimit të periudhës së mëparshme të komandimit.

Konkretisht, në nenin 53 të ligjit 96/2016 parashikohet se periudha e komandimit të magjistratit nuk mund të jetë më shumë se 5 vjet, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në ligj; Magjistrati duhet të shërbejë jo më pak se pesë vjet si magjistrat pas përfundimit të periudhës së komandimit.

Po kështu në pikën 4 të Kreut II të vendimit 104, 05.07.2019 parashikohen kriteret e komandimit, ku ndër të tjera, kandidati që ka qenë i komanduar më parë, të ketë shërbyer jo më pak se 5 vjet si gjyqtar pas përfundimit të periudhës së mëparshme të komandimit.

Sa më sipër Komisioni për Zhvillimin e Karrierës vlerëson se për gjyqtaren {...} ekziston një prej kriterëve ndaluese të komandimit, pasi nga momenti i përfundimit të periudhës së saj të komandimit në 15.11.2015 e deri më sot kanë kaluar më pak se 5 vjet. Në këto kushte për këtë gjyqtare propozohet që të vendoset përjashtimi nga kandidimi.

Në lidhje me cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit (interesit të lartë) të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin, nga raportimet periodike dhe informacioni e mendimi i marrë nga kryetarët e gjykatave respektive rezulton se:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ku ushtron detyrën gjyqtarja {...} ka në organikën e saj 10 gjyqtarë. Efektivisht në detyrë janë 6 gjyqtarë, pasi një gjyqtare është me leje lindje, e cila sipas informacionit të përcjellë nga kryetari i gjykatës ka njoftuar se do të rifillojë punë në datën 01.10.2019, një gjyqtar është pezulluar për shkak të procesit të rivlerësimit, një gjyqtar është transferuar përkohësisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, ndërkohë

që 1 pozicion tjetër është i lirë i përhershëm. Aktualisht ngarkesa e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat është 667 çështje, ndërkohë që ngarkesa e 3-mujorit paraardhës ka qenë 780 çështje. Vetë gjyqtarja {...} ka një ngarkesë prej 115 çështje. Për vitin 2019, me të njëjtin numër gjyqtarësh, nga kjo gjykatë janë paraqitur vetëm 2 kërkesa për caktimin e 4 gjyqtarëve nga gjykatat e tjera për gjykimin e çështjeve të ndryshme nga ato në gjykatat ku ata ushtrojnë funksionin. Sipas mendimit të kryetarit me rikthimin e gjyqtares nga leja e lindjes dhe plotësimin e pozicionit të lirë të përhershëm me të diplomuar të Shkollës së Magjistraturës, ngarkesa e punës në këtë gjykatë është e përbalueshme. Në kushtet e mësipërme dhe pritshmëritë e sigurta që krijohen nga rikthimi i gjyqtares së larguar me leje lindje, plotësimi i pozicionit të lirë të përhershëm apo edhe rikthimi i gjyqtarit të transferuar, Komisioni për Zhvillimin e Karrierës vlerëson se komandimi i znj. {...} në strukturat e KLGJ-së, përballë ngarkesës së çështjeve që ka kjo gjykatë, nuk passjell cenim të interesave të larta të kësaj gjykate për sa kohë nuk cenohet funksionaliteti i saj.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ku ushtron detyrën gjyqtarja {...} ka në organikën e saj 14 gjyqtarë. Efektivisht në detyrë janë 11 gjyqtarë, pasi një gjyqtar është pezulluar për shkak të procesit të rivlerësimit, një gjyqtar është transferuar përkohësisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, ndërkohë që 1 pozicion tjetër është i lirë i përhershëm. Aktualisht ngarkesa e gjykatës së rrethit gjyqësor Korçë është 769 çështje, ndërkohë që ngarkesa e 3-mujorit paraardhës ka qenë 663 çështje. Vetë gjyqtarja {...} ka një ngarkesë prej 70 çështjesh. Për vitin 2019, nga kjo gjykatë nuk është paraqitur asnjë kërkesë për caktimin e gjyqtarëve nga gjykatat e tjera për gjykimin e çështjeve të ndryshme në gjykatat ku ata ushtrojnë funksionin. Sipas mendimit të kryetarit ngarkesa e punës në këtë gjykatë është e përbalueshme (sqarojmë këtu që deri në 31.07.2019 kjo gjykatë ka gjykuar me 10 gjyqtarë, pasi gjyqtari {...} është caktuar në këtë gjykatë me vendim të KLGJ nr. 148, 30.07.2019). Në kushtet e mësipërme Komisioni për Zhvillimin e Karrierës vlerëson se komandimi i znj. {...} në strukturat e KLGJ-së, përballë ngarkesës së çështjeve që ka kjo gjykatë dhe numrit aktual të gjyqtarëve që ushtrojnë efektivisht detyrën pranë kësaj gjykate, nuk passjell cenim të interesave të larta të kësaj gjykate për sa kohë nuk cenohet funksionaliteti i saj.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ku ushtron detyrën gjyqtarja {...} ka në organikën e saj 14 gjyqtarë. Efektivisht në detyrë janë 11 gjyqtarë, pasi një gjyqtar është pezulluar për shkak të procesit të rivlerësimit, një gjyqtar është transferuar përkohësisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, ndërkohë që 1 pozicion tjetër është i lirë i përhershëm. Aktualisht ngarkesa e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër është 1195 çështje, ndërkohë që ngarkesa e 3-mujorit paraardhës ka qenë 1224 çështje. Vetë gjyqtarja {...} ka një ngarkesë prej 100 çështje. Për vitin 2019, nga kjo gjykatë nuk është paraqitur asnjë kërkesë për caktimin e gjyqtarëve nga gjykatat e tjera për gjykimin e çështjeve të ndryshme nga ato në gjykatat ku ata ushtrojnë funksionin. Sipas mendimit të kryetarit ngarkesa e punës në këtë gjykatë është e përballeshme dhe komandimi i znj. {...} në KLGJ, nuk cenon dhe as dëmton funksionalitetin e kësaj gjykate. Në kushtet e mësipërme Komisioni për Zhvillimin e Karrierës vlerëson se komandimi i znj. {...} në strukturat e KLGJ-së, përballë ngarkesës së çështjeve që ka kjo gjykatë dhe numrit aktual të gjyqtarëve që ushtrojnë efektivisht detyrën pranë kësaj gjykate, nuk passjell cenim të interesave të larta të kësaj gjykate për sa kohë nuk cenohet funksionaliteti i saj. Sjellim në vëmendje që nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës është propozuar gjithashtu dhe ndërprerja e transferimit të gjyqtarit Besmir Stroka dhe rikthimi i tij për vazhdimin e ushtrimit të detyrës në gjykatën ku ai është caktuar në mënyrë të përhershme e që është pikërisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ku ushtron detyrën gjyqtarja {...} ka në organikën e saj 14 gjyqtarë. Efektivisht në detyrë janë 12 gjyqtarë, pasi një gjyqtar është komanduar në pozicionin e ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë dhe një gjyqtare tjetër është larguar me leje lindje. Aktualisht ngarkesa e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është 1302 çështje, ndërkohë që ngarkesa e 3 mujorit paraardhës ka qenë 1445 çështje. Vetë gjyqtarja {...} ka një ngarkesë prej 160 çështje. Për vitin 2019, nga kjo gjykatë janë paraqitur 3 kërkesa për caktimin e gjyqtarëve nga gjykatat e tjera për gjykimin e çështjeve të ndryshme nga ato në gjykatat ku ata ushtrojnë funksionin. Sipas mendimit të kryetarit ngarkesa e punës në këtë gjykatë është e përballeshme dhe komandimi i znj. {...} në KLGJ, nuk cenon dhe dëmton funksionalitetin e kësaj gjykate. Në kushtet e mësipërme Komisioni për Zhvillimin e Karrierës vlerëson se komandimi i znj. {...} në strukturat e KLGJ-së, përballë ngarkesës së çështjeve që ka kjo gjykatë dhe numrit të gjyqtarëve që ushtrojnë efektivisht



detyrën pranë kësaj gjykate, nuk passjell cenim të interesave të larta të kësaj gjykate për sa kohë nuk cenohet funksionaliteti i saj.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër ku ushtron detyrën gjyqtarja {...} ka në organikën e saj 4 gjyqtarë. Aktualisht organika e kësaj gjykate është e plotë, pasi një pozicion i lirë i përhershëm që ka ekzistuar është plotësuar nga KLGJ me vendimin 153, 30.07.2019. Aktualisht ngarkesa e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër është 232 çështje, ndërkohë që ngarkesa e 3-mujorit paraardhës ka qenë 213 çështje. Vetë gjyqtarja {...} ka një ngarkesë prej 73 çështje. Për vitin 2019, nga kjo gjykatë janë paraqitur 7 kërkesa për caktimin e 11 gjyqtarëve nga gjykatat e tjera për gjykimin e çështjeve të ndryshme nga ato në gjykatat ku ata ushtrojnë funksionin. Sipas mendimit të kryetarit me plotësimin e vendit të lirë të përhershëm, edhe pse pas komandimit të znj. {...} në KLGJ numri i gjyqtarëve të kësaj gjykate do të jetë 3 gjyqtarë, ngarkesa e punës përsëri është e përbalueshme dhe nuk cenon funksionalitetin e gjykatës. Në kushtet e mësipërme Komisioni për Zhvillimin e Karrierës vlerëson se komandimi i znj. {...} në strukturat e KLGJ-së, përballë ngarkesës së çështjeve që ka kjo gjykatë, nuk passjell cenim të interesave të larta të kësaj gjykate për sa kohë nuk cenohet funksionaliteti i saj.

Sa më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor: Vijimin e procedurave të komandimit nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale me vlerësimin e kritereve të tjera të komandimit për kandidatët gjyqtarë: {...}, {...}, {...} dhe {...}; Përfundimin nga kandidimi për komandim të gjyqtarës {...}, për shkak të ekzistencës së kriterit të mësipërm ndalues të komandimit; Publikimin e këtij opinioni në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toro!

Kemi ndonjë diskutim apo koment lidhur me këtë fazë të kandidimit?

Atëherë, kalojmë në vendimmarrje?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli miraton opinion e bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës për sa i përket fillimit të procedurave për komandimin pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ndërkohë që lidhur me kandidaturën e zonjës {...}...

**Alban Toro:** Në kushtet kur pjesë e opinionit ka qenë edhe përjashtimi nga kandidimi për komandim të gjyqtarës {...} për shkak të ekzistencës së kriterit të mësipërm ndalues të komandimit dhe për shkak se ky opinion u aprovua nga Këshilli i Lartë Gjyqësor është përgatitur edhe një projektvendim i cili konfirmon faktin e përjashtimit, mund ta lexoj: “Për përjashtimin nga kandidimi për komandim pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor të gjyqtarës {...} - KLGJ-ja, mbështetur në nenin 53, pika 7 të ligjit 96/2016 të ndryshuar, me vendimin nr. 104, datë 05.07.2019 “Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit”, në kërkesën për komandim të gjyqtarës {...}, si dhe në “Opinionin mbi kandidatët që kanë aplikuar për t’u komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor” të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, vendosi:

Përjashtimin e gjyqtarës {...} nga kandidimi për komandim në pozicionin “nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për shkak të ekzistencës së një kriteri ndalues komandimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.”

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toro!

Atëherë, kalojmë në votim projektvendimin që prezantoi zoti Toro?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

*Ilir Toska:* Dakord.

*Alban Toro:* Dakord.

*Fatmira Luli:* Pro.

*Marçela Shehu:* Dakord.

*Erjon Muharremaj:* Pro.

*Brikena Ukperaj:* Pro.

*Medi Bici:* Pro.

*Naureda Llagami:* Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi përjashtimin e gjyqtarës {...} nga kandidimi për komandim në pozicionin “nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për shkak të ekzistencës së një kriteri ndalues në komandim. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 4 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 11.09.2019)*

**Pika 5 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit { ... } në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:10 dhe mbaroi në orën 17:45.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
5. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
11. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Antuen Skënderi, Këshilltare e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
5. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
6. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
7. *Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
8. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
9. *Aurora Ndreu, Specialiste pranë Sektorit të Oponencës Juridike dhe Përafrimit të Legjislacionit.*
10. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
11. *Gregor Borgowski, EURALIUS.*
12. *Klodian Rado, EURALIUS.*
13. *Charles Ericksen, USAID.*
14. *Valbona Bala (Pajo), USAID.*

#### **RENDI I DITËS:**

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*Naureda Llagami:* Kalojmë, sipas rendit të ditës, në çështjen e pestë, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër”. Projekt-akt i cili është i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe do raportohet nga zoti Alban Toro.

**Alban Toro:** Më herët KLGJ ka shpallur një pozicion të lirë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, për transferim të përkohshëm deri në 1 vit, duke i bërë thirrje të gjithë gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë që plotësojnë kriteret për pozicionin e lirë të shpallur, të ftohen për të dhënë pëlqimin për transferimin e përkohshëm pranë kësaj gjykate (vendimi është 138, 19.07.2019).

Pasi është lënë i hapur konkurrimi, i vetmi gjyqtar i cili ka paraqitur pëlqimin në këtë aspekt ka qenë gjyqtari {...}, i cili ka shprehur vullnetin e tij me shkresën 833, datë 26.07.2019.

Në bazë të nenit 46 të ligjit 96/2016 dhe nenit 8 të vendimit 23, 07.02.2019 “Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, KZHK ka kërkuar opinionin e kryetarit të gjykatës në lidhje me ngarkesën e gjykatës të cilën drejton në përgjithësi; pasojat që krijohen për gjykatën nga vazhdimi i transferimit të gjyqtarit pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër si edhe; një propozim mbi periudhën maksimale për të cilën gjyqtari kërkon të transferohet.

Kryetari, më datë 09.09.2019 ka kthyer përgjigjen: Ngarkesa e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë është 136 çështje. Gjyqtari {...} aktualisht ka në gjykim 38 çështje. Pas dërgimit të e-mail-it tuaj për dërgimin e ngarkesës së çështjeve të gjyqtarit {...} në shortim e sotëm datë 09.09.2019 i kanë renë për gjykim 13 çështje. Aktualisht pranë kësaj gjykate janë 3 gjyqtarë: {...}, {...}, {...}. Mendoj se nuk ka pasoja nga vazhdimi i transferimit të gjyqtarit {...} pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Sa i përket pikës 3 të shkresës për propozimin për periudhën maksimale të gjyqtarit të transferuar {...} mendoj sipas afateve ligjore të përcaktuara në vendimin nr. 23, datë 07.02.2019.

Pra aktualisht, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër ka çështje në gjykim (pra janë pa vendimmarrje) gjithsej 429; Çështje të gjykuara (me vendimmarrje janar - 6 shtator 2019) janë 359; Ndërkohë nga 14 qershor 2019 deri me 06 shtator 2019 janë depozituar në total 191 çështje administrative, të cilat nuk janë shortuar.

Në vijim Komisioni i Zhvillimit të Karrierës duke marrë në konsideratë që nuk mund të aplikohet zbatimi i neneve 45 dhe 46 të ligjit 96/2016, verifikoi plotësimin e kriterëve të të vetmes kandidaturë që ka dhënë pëlqimin për transferim e përkohshëm por që përkon edhe me ushtrimin aktualisht të detyrës në këtë gjykatë.

Duke vlerësuar ngarkesën aktuale të gjyqtarit që ka shprehur pëlqimin pranë Gjykatës Administrative të Shkodrës, fusha e së drejtës (specifike) që mbulon në këtë gjykatë në nevojë, cenimin e funksionimit normal, marrë në konsideratë jo vetëm organikën aktuale por edhe numrin e madh të çështjeve, ekzistenca e dy pozicioneve të lira të përkohshme në të, ngarkesa aktuale Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë ku ai është caktuar në mënyrë të përhershme, përfundimi i afatit të transferimit (zgjatjes) të përcaktuar me vendimin e mëparshëm 99, 21.06.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor;

Bazuar sa më sipër, KZHK, i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor konform nenit 4 – 8 të vendimit 23... transferimin e përkohshëm për një pozicion të lirë pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër të gjyqtarit {...}; Afati i transferimit të jetë 15.06.2020; Të njoftohet {...}, Kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë dhe Administrative e Shkallës së Parë Shkodër.

**Naureda Llagami:** Jeni dakord me projekt-propozimin e relacionit?

Jeni dakord?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: “Gjyqtarit {...}, aktualisht gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, i përsëritet transferimi i përkohshëm, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, deri më datë 15.06.2020.

Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarit {...}, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë si dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.”

\* \* \*

(Pika 5 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 11.09.2019)*

**Pika 6 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për ndërprerjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë dhe kthimin e tij në pozicionin e mëparshëm”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:10 dhe mbaroi në orën 17:45.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Brunilda Kadi* (anëtare)
5. *Fatmira Luli* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Illir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Antuen Skënderi, Këshilltare e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 6. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 7. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
- 8. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 9. Aurora Ndreu, Specialiste pranë Sektorit të Oponencës Juridike dhe Përafrimit të Legjislacionit.*
- 10. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 11. Gregor Borgowski, EURALIUS.*
- 12. Klodian Rado, EURALIUS.*
- 13. Charles Ericksen, USAID.*
- 14. Valbona Bala (Pajo), USAID.*

**RENDI I DITËS:**

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për ndërprerjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë dhe kthimin e tij në pozicionin e mëparshëm”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek çështja tjetër e rendi të ditës, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për ndërprerjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë dhe kthimin e tij në pozicionin e mëparshëm”.

Këtë projekt-akt do ta relatojë zonja Marçela Shehu, anëtare e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

**Marçela Shehu:** Faleminderit, zonja Kryetare!

“Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 6, datë 21.12.2018, ka urdhëruar transferimin e përkohshëm, pa pëlqim, të gjyqtarit {...}, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë. Ky transferim erdhi si pasojë e situatës emergjente të lindur në atë gjykatë pas shkarkimit të Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, z. {...}, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, më datë 20.12.2018, si dhe faktit se gjyqtari tjetër i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, z. {...}, me vendim të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. 99, datë 21.06.2018, ishte transferuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Si e tillë, kjo gjykatë kishte mbetur vetëm me një gjyqtar, znj. {...}, e cila aktualisht është zëvendëskryetare e kësaj gjykate.

Me Vendimin nr. 152, datë 30.07.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka vendosur emërimin si gjyqtare të zonjës {...} dhe ka caktuar si gjyqtare në mënyrë të përhershme pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.

Pra, aktualisht, rezulton që kjo gjykate, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë, në organiken e së cilës janë 4 gjyqtarë, efektivisht e ushtrojnë detyrën e gjyqtarit zonja {...} (e caktuar në mënyrë të përhershme); {...} (e caktuar në mënyrë të përhershme) dhe gjyqtari {...} i transferuar përkohësisht pranë kësaj gjykate.

Vlen të theksohet se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë është një gjykatë me një ngarkesë jo shumë të lartë. Sipas të dhënave të përcjella nga zëvendëskryetarja e gjykatës, aktualisht gjyqtarja {...} ka në gjykim 53 çështje; gjyqtarja {...} ka në gjykim 15 çështje dhe gjyqtari {...} ka në gjykim 67 çështje.

Komisioni, duke vlerësuar faktin se aktualisht nuk ekziston më situata emergjente që orientoi Këshillin në vendimmarrjen e tij për transferimin e përkohshëm, pa pëlqim, të gjyqtarit {...} pranë Gjykatës Pukë, pasi: efektivisht mund ta ushtrojnë detyrën e gjyqtarit dy gjyqtarë; ngarkesa e gjykatës nuk është e lartë si dhe faktin që Këshilli ka vlerësuar që transferimi i gjyqtarit {...} nuk cenon funksionalitetin e kësaj gjykate, Komisioni për Zhvillimin e Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor, që të deklarojë përfundimin e periudhës së transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor

Pukë, sipas vendimit nr. 6, datë 21.12.2018 dhe kthimin e tij në pozicionin e mëparshëm, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Me qëllim që ndërprerja e periudhës së transferimit të përkohshëm të këtij gjyqtari mos të krijojë efekte negative në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, sepse ai aktualisht ka në gjykim 67 çështje gjyqësore, Komisioni e vlerëson të nevojshme që vendimi për deklarimin e përfundimit të periudhës së transferimit të përkohshëm të jetë me një efekt të shtyrë në kohë, ai të fillojë t'i krijojë efektet në 01.11.2019, periudhë kjo e nevojshme gjatë së cilës gjyqtari mund të përfundojë gjykimin e çështjeve për të cilat është ngarkuar. Nga ana tjetër, vlerësohet e nevojshme të urdhërohet edhe përjashtimi nga shorti i gjyqtarit {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë.

Bazuar sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor: Të deklarojë përfundimin e periudhës së transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...}, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, sipas vendimit nr. 6, datë 31.10.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe kthimin e tij në pozicionin e mëparshëm, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Efektet e këtij vendimi fillojnë më 01.11.2019.

Gjyqtari {...} të përjashtohet menjëherë nga procedurat e shortit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë.”

**Naureda Llagami:** Kemi diskutime?

**Brunilda Kadi:** Atëherë, në parim unë jam dakord. Vetëm në lidhje me afatin që propozohet për t'i përfunduar transferimi, besoj se nuk është se ka ndonjë bazë që ta lejmë një muaj e gjysmë, 1 muaj e 20 ditë. Ndoshta do kishte më kuptim që ne t'i linim një 2 javësh që ai në qoftë se i ka disa dosje në fazën e shpalljes së vendimit, të ketë kohë që t'i arsyetojë dhe t'i dorëzojë sepse pastaj ky afati 1 muaj e gjysmë më duket sikur s'ka ndonjë arsyetim ose bazë konkrete sepse edhe të gjitha ai dihet që s'mund t'i përfundojë. Edhe mund t'i përfundojë të gjitha dosjet, por mund të jenë dosje që janë me afate që mund të shkojnë edhe 2 vjet. Kështu që unë do propozoja një afat më të shkurtër dhe konkretisht dy javë nga dita e vendimit, dy javë t'i fillojë efektet vendimi. Ky është propozimi im.

**Naureda Llagami:** Do e hedhim në votim?

Keni diskutime të tjera?

E hedhim në votim propozimin e bërë?

*(Anëtarët diskutojnë njëherësh pa ndezur mikrofonat.)*

**Brunilda Kadi:** Ta lejmë 1 tetor propozimin?

Atëherë, më falni, meqenëse po diskutohet, unë po propozoj konkretisht datën 1 tetor (që është dy javë). Ky është propozimi im. Të hidhet në votë. Po s'kaloi pastaj, të kalojmë... Pra gjithçka siç është propozuar nga Komisioni i Karrierës, përveç datës, datën 1 tetor, jo 1 nëntor.

**Naureda Llagami:** E hedhim fillimisht në votim propozimin që bëri anëtarja Brunilda Kadi, pra që të jetë e njëjta përmbajtje me atë të bërë nga Komisioni i Karrierës, përveç efektet e këtij vendimi të fillojnë më datë 01.10.2019.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Kundër.

**Alban Toro:** Kundër.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Kundër.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Pro.

Atëherë, Këshilli vendosi: "Deklarimin e përfundimit të periudhës së transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, sipas vendimit nr. 6, datë 21.12.2018, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe kthimin e tij në pozicionin e mëparshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Efektet e këtij vendimi të fillojnë më 01.10.2019.

Gjyqtari {...} të përjashtohet menjëherë nga procedurat e shortit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë.

Një kopje e vendimit t'i njoftohet gjyqtarit {...}, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.”

Faleminderit!

\* \* \*

(Pika 6 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 11.09.2019)*

**Pika 7 e rendit të ditës me objekt:** Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:10 dhe mbaroi në orën 17:45.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
5. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
11. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Antuen Skënderi, Këshilltare e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 6. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 7. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
- 8. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 9. Aurora Ndreu, Specialiste pranë Sektorit të Oponencës Juridike dhe Përafrimit të Legjislacionit.*

#### **RENDI I DITËS:**

7. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek çështja 7 e rendit të ditës, ku bëhet fjalë për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme. Lidhur me ndjekjen e procedurave dhe hedhjen e shortit të këtyre gjyqtarëve, fjalën po ia kaloj kryetarit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, zotit Toska.

*Ilir Toska:* Faleminderit!

Atëherë, fillimisht po ju parashtroj propozimin lidhur me radhën e procedurave të shortit sipas gjykatave. Komisioni ka këtë propozim që të ndiqet kjo radhë: Fillimisht gjykatat e shkallës së parë sipas kësaj renditjeje: Gjykata e shkallës së parë sipas



juridiksioneve të gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm: Fillimisht, gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Tiranë, konkretisht - Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin; Më pas Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë dhe në fund; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Më pas vijojmë me gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë: Fillimisht, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe më pas Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet.

Më pas vijojmë me gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Vlorë: që është vetëm Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Më tej të vijojmë me gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit administrativ, sipas kësaj renditjeje: Fillimisht, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër; Më pas Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë dhe në fund; Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë.

Më tej procedurat e shortit vijojnë me gjykatat e apeleve, sipas kësaj radhe: Gjykata e apelit me juridiksion të përgjithshëm, konkretisht në fillim: Gjykata e Apelit Durrës; Më pas Gjykata e Apelit Vlorë; Më pas Gjykata e Apelit Korçë; Më pas Gjykata e Apelit Shkodër; Më pas Gjykata e Apelit Gjirokastrë dhe në fund; Gjykata e Apelit Tiranë.

Në fund procedurat e shortit do të vijojnë me Gjykatën e Lartë.

Jeni dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Mirë, meqenëse jeni dakord, atëherë vijojmë me procedurat e shortit për secilën gjykatë.

Mirë atëherë, fillojmë procedurat e shortit. Fillimisht kemi **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin**. Nevojat e gjykatës deri më datë 09.09.2019, përmes kërkesave të paraqitura nga kryetari në detyrë i kësaj gjykate, është vetëm për 1 çështje penale, ndërsa kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve në përbërje të trupit gjykues.

Lidhur me nevojat e gjykatës, zbatimi i mekanizmit të skemës së delegimit të gjyqtarit në këtë rast nuk mund të bëhet, referuar kërkesave të përcaktuara në nenin 45 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe rregullores së Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për kriteret dhe procedurën e funksionimit të

skemës së delegimit”, për shkak të padisponueshmërisë, mungesës së gjyqtarëve në skemë delegimi. Po kështu dhe zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, në këtë rast është i padobishëm për sa kohë bëhet fjalë për një çështje gjyqësore për të cilën kërkohen dy gjyqtarë, ndërkohë që transferimi i përkohshëm i dy gjyqtarëve do të sillte efekte negative në gjykatën nga e cila ata duhet të transferohen. Për rrjedhojë, bëhet i zbatueshëm mekanizmi i caktimit të gjyqtarëve për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin, sipas vendimit përkatës të Këshillit në lidhje me rregullat dhe përcaktimin e gjyqtarëve për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme. Referuar këtij të fundit, paragrafit 4, pika 5 të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor si më lart, si dhe në zbatim të paragrafit 5, pika 4 e këtij vendimi, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon që, gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ndërsa numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 2.

Në rastet e pranimit të këtij propozimi, për hapat e shortit që duhet të ndiqen, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon që, për 1 çështje penale, për të cilën kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve, ata të përzgjidhen, me short, nga gjyqtarët e Seksionit Penal të Çështjeve Penale të Themelit, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Gjithashtu, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, propozon edhe përjashtim nga shorti, referuar paragrafit 8 të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, konkretisht: në shortimin e kësaj çështjeje të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që është me leje lindje, zonja {...}; Në shortimin e kësaj çështjeje të përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, konkretisht zoti {...}; Në shortimin e kësaj çështjeje të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Seksionit Penal të Çështjeve Penale të Themelit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të cilët, sipas informacionit të marrë nga Zëvendëskryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, kanë pengesë ligjore për gjykimin e saj, konkretisht gjyqtarët {...} dhe

{...}; Në shortimin e kësaj çështje të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Seksionit Penal të Çështjeve Penale të Themelit, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të cilët janë caktuar më herët për gjykimin e 4 apo më tepër çështjeve gjyqësore të veçanta, në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, konkretisht gjyqtarët {...}.

Jeni dakord me këto propozime?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Dakord. Mirë atëherë, meqenëse jeni dakord, vijojmë me procedurat e shortit.

Në një enë të do të fusim emrat e gjyqtarëve që mbeten të Seksionit Penal të Çështjeve Penale të Themelit, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke hequr ata që përjashtuam.

Atëherë, emri i parë është {...}, emri i dytë është {...}, emri i tretë është {...}. Vetëm tre emra janë që duhet të marrin pjesë.

Emri i parë është {...}. Emri i dytë është {...}, të cilët të dy caktohen për gjykimin e 1 çështjeje penale në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin. Me kaq mbyllet procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë**. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë ka paraqitur nevojë për 2 çështje të cilat të dyja janë në lëndë penale dhe kërkohet caktimi i 1 gjyqtari. Edhe në këtë rast nuk mund të zbatohet mekanizmi i skemës së delegimit për shkak padisponueshmërie të gjyqtarëve. Po kështu është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm të gjyqtarëve referuar faktit se kërkohet caktimi i 1 gjyqtari për 2 çështje, ndërkohë që transferimi i përkohshëm i 1 gjyqtari do të sillte më shumë efekt negativ në gjykatën ku ai duhet të transferohet. Për këtë shkak bëhet i zbatueshëm mekanizmi i caktimit të gjyqtarëve për gjykimin e një çështjeje të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon që, gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 1.

Në opsionin e pranimit të propozimit si më lart, për 2 çështjet, për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, Komisioni propozon që ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Seksionit Penal të Çështjeve Penale të Themelit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ndërsa të përjashtohet nga shorti gjyqtarja që është me leje lindjeje e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, zonja {...}; Kryetari në detyrë i kësaj gjykate, zoti {...}; Gjyqtarët që janë caktuar më herët në 4 apo më tepër çështje gjyqësore të veçanta, të kësaj gjykate, në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, pra gjyqtarët {...}; Po kështu të përjashtohen nga shorti dhe gjyqtarët që do caktohen me short, për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin, që nga shorti i mëparshëm ishin gjyqtarët {...}.

Atëherë, jeni dakord me propozimet?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Dakord. Mirë atëherë, referuar propozimeve të bëra, atëherë janë dy gjyqtarë mes të cilëve duhet të përzgjedhim: është gjyqtari {...} dhe gjyqtari {...}. Do të zgjedhim njërin prej tyre i cili do caktohet për dy çështje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë.

Atëherë, emri i përzgjedhur është i gjyqtarit {...}.

Me kaq mbyllet procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë**. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka paraqitur nevojë për 1 çështje civile. Kërkohet caktimi i 1 gjyqtari. Në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit për padisponueshmëri të gjyqtarëve ne skemën e delegimit. Nuk është i dobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm ndërsa kërkohet caktimi i një gjyqtari vetëm për 1 çështje gjyqësore, duke qenë kështu i zbatueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e një çështjeje të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar të cilit, Komisioni propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhet me short gjyqtari që do caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Në rast të pranimit të këtij propozimi, për 1 çështje, për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, Komisioni propozon që ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Seksionit Civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Jeni dakord me këtë propozim?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Dakord. Mirë atëherë, vijojmë procedurat e shortit.

Në një enë do të hedhim emrat e gjyqtarëve të seksionit civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, që janë: {...}...{...}.

*(Ripërsëriten emrat që futen në enën e qelqit.)*

Do përzgjedhim emrin e njërit prej tyre i cili caktohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë - {...}.

Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë**. Atëherë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë ka paraqitur nevojë për 1 çështje penale ku kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, por që të jetë nga Seksioni për të mitur. Edhe në këtë rast është i pamundur zbatimi i skemës së delegimit për padisponueshmëri të gjyqtarëve në këtë skemë. Ndërsa është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë i aplikueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarëve për gjykimin e një çështjeje të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, ku në zbatim të paragrafit 6, pika 4 e këtij vendimi, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon që, gjykata nga duhet të përzgjidhet me short gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Në rast të pranimit të propozimit si më lart, Komisioni propozon që për 1 çështje penale për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari që bën pjesë në Seksionin për të miturit, ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Seksionit Penal për gjykimin e të miturve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Jeni dakord me këtë propozim?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Dakord. Atëherë, do të hedhim në një enë emrat e gjyqtarëve të Seksionit Penal për gjykimin e të miturve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për të përzgjedhur njërin prej tyre. Emrat janë: {...}. Do të përzgjedhim njërin prej tyre.

Vazhdojmë procedurat e shortit atëherë. Do përzgjedhim emrin e njërit prej tre gjyqtarëve – {...}.

Faleminderit! Mbyllet shorti për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

Vazhdojmë me shortin për **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet**. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet ka paraqitur nevojë për 2 çështje, një në lëndë civile dhe një në lëndë penale. Kërkohejt caktimi i 1 gjyqtari. Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit, por ndërkohë është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë kështu i aplikueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarëve për gjykimin e një çështjeje të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, në zbatim të paragrafit 5, pika 4 e të cilit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short, gjyqtarët që do të caktohet për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Në rast të pranimit të këtij propozimi, për hapat e shortit që duhet të ndiqen, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon që, për 2 çështje gjyqësore të veçanta, për të cilat kërkohejt caktimi i 1 gjyqtari, ai të përzgjidhet me short, nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Përrjashtimet nga shorti – Komisioni propozon që të përjashtohen nga shorti i këtyre çështjeve gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë që kanë pengesë ligjore për gjykimin e çështjes nr. 2, konkretisht, gjyqtarët {...}.

Jeni dakord me propozimet e Komisionit?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Dakord. Mirë atëherë, në një enë do të hedhim emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, duke përjashtuar

ata të cilët kanë pengesë ligjore, janë emrat e këtyre gjyqtarëve: {...}. Do të përzgjedhim emrin e njërit prej tyre që do caktohet për dy çështjet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet – Është {...}.

Me kaq mbyllen procedurat e shortit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë**.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka paraqitur nevojë për 1 çështje penale. Kërkoheft caktimi i 1 gjyqtari. Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm zbatimi i mekanizmit të skemës së delegimit, ndërsa është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë kështu i aplikueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarëve për gjykimin e një çështjeje të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, në zbatim të paragrafit 5, pika 4 e të cilit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, propozon që, gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Në rast të pranimit të këtij propozimi, për hapat e shortit që duhet të ndiqen, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon që, për 1 çështje gjyqësore, për të cilën kërkoheft caktimi i 1 gjyqtari, ai të përzgjidhet, me short, nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat. Po kështu, në vijim të kësaj, Komisioni propozon lidhur me përjashtimet nga shorti që në shortimin e kësaj çështjeje të përjashtohet kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, zoti {...}. Po kështu, të përjashtohet edhe gjyqtarja e kësaj gjykate që është në proces konkurrimi për komandim pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, gjyqtarja {...}.

Jeni dakord me këto propozime?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Dakord. Atëherë, emrat e gjyqtarëve që do t'i nënshtrohen shortit {...}. Do të përzgjedhim emrin e njërit prej tyre që të caktohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Përzgjidhet emri i gjyqtarit {...}.

Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Vazhdojmë me procedurat e shortit për **Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër**. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër ka paraqitur nevojë për 7 çështje gjyqësore, në 6 prej të cilave kërkohet 1 gjyqtar, ndërsa në 1 prej tyre kërkohen 2 gjyqtarë.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit, ndërsa është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë kështu i aplikueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarëve për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, në zbatim të paragrafit 6, pika 4 e të cilit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 7 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 7 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2.

Në rast të pranimit të këtij propozimi, për hapat e shortit që duhet të ndiqen, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon që përjashtimet nga shorti të jenë këto: Të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, zoti {...}, po kështu të përjashton nga shorti gjyqtarët e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të cilët janë caktuar më herët për gjykimin e këtyre çështjeve që janë, zonja {...}, zoti {...} dhe zoti {...}. Po kështu, në shortimin e këtyre çështjeve të përjashtohen nga shorti edhe gjyqtarët e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të cilët janë caktuar në shortin e fundit të datë 19.07.2019, në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, që janë zonja {...} dhe zoti {...}.

Jeni dakord me këto propozime?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Dakord. Atëherë, për hapat e shortit, Komisioni ka propozuar që, për çështjen nr.7, për të cilën kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve, ata të përzgjidhen, me short, midis gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ndërsa për 6 çështjet e tjera, për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, për secilin grup çështjesh, grupin e parë që përfshin çështjet nr.1, nr.2 dhe nr.3, si dhe grupin e dytë



që përfshin çështjet nr.4, nr.5 dhe nr.6, gjyqtari të përzgjidhet, me short, midis 2 gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të caktuar për çështjen nr.7. Në këtë rast, gjyqtari i përzgjedhur për grupin parë të çështjeve, përjashtohet nga përzgjedhja për grupin tjetër të çështjeve.

Jeni dakord për hapat e shortit?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Dakord. Mirë atëherë, vijojmë shortin për çështjen nr. 7 për të cilën kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve, do përzgjedhim 2 gjyqtarë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë. Duhet të fusim në një enë emrat e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, duke përjashtuar ata që u pranua propozimi, pra {...}. Emrat e tjerë janë: {...}...{...}.

Atëherë, do të përzgjedhim emrat e 2 prej tyre që do caktohen për çështjen nr. 7 – Emri i parë është {...}. Emri i dytë është {...}.

Do vijojmë procedurat e shortit për 6 çështjet e tjera. Do të fusim në një enë emrat e dy gjyqtarëve si më lart dhe në një enë tjetër dy grupet e çështjeve, njëri grup çështjet nr.1, nr.2 dhe nr.3 dhe grupi i dytë nr.4, nr.5 dhe nr.6. Atëherë, do përzgjedhim njërin grup të çështjeve. Pastaj do përzgjedhim emrin e gjyqtarit.

Grupi i përzgjedhur është ai që ka çështjet nr.1, nr.2 dhe nr.3.

Do të përzgjedhim emrin e gjyqtarit – Është {...}.

Automatikisht për grupin tjetër 4-5-6 emri është emri i gjyqtarës {...}.

Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

Vazhdojmë me **Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë.**

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë ka paraqitur nevojë për 4 çështje. Kërkohet caktimi i 1 gjyqtari për secilën çështje.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit, ndërsa është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë kështu i aplikueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarëve për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, në zbatim të

paragrafit 6, pika 4 e të cilit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 4 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 4 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2.

Në opsion të pranimit të propozimit si më lart, për hapat e shortit Komisioni propozon që për 4 çështje, në të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, për secilin grup çështjesh, grupin e parë që përfshin çështjet nr.1 dhe nr.2, si dhe grupin e dytë që përfshin çështjet nr.3 dhe nr.4, gjyqtari të përzgjidhet, me short, midis gjyqtareve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë. Në këtë rast, gjyqtari i përzgjedhur për grupin e parë të çështjeve, përjashtohet nga përzgjedhja për grupin tjetër.

Kemi edhe propozimin sa i përket përjashtimeve nga shorti. Propozojmë që të mos përjashtohet nga shorti kryetari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, zoti {...} për shkak të numrit të kufizuar të gjyqtarëve të kësaj gjykate dhe për të mundësuar shpërndarjen e barabartë të çështjeve.

Jeni dakord me këtë propozim?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Dakord. Atëherë, në një enë do të hedhim emrat e gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë që janë {...}, ndërsa në një enë tjetër do të hedhim dy grupet e çështjeve, grupin e parë që është çështja nr.1 dhe nr.2 dhe grupi i dytë që është çështja nr.3 dhe nr.4.

Atëherë, përzgjedhim njërin grup të çështjeve – është grupi që ka çështjen nr. 1 dhe nr. 2.

Do të përzgjedhim një emër gjyqtari. Emri i gjyqtarit të përzgjedhur është {...}.

Nga grupi tjetër i çështjeve që janë çështjet 3, 4 mbetet që të jenë për gjyqtaren {...}.

Me kaq mbyllet shorti për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë.

Vazhdojmë me **Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë**. Ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore. Kërkohet caktimi i 1 gjyqtari.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit, ndërsa është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë kështu

i aplikueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarëve për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, në zbatim të paragrafit 6, pika 4 e të cilit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Në opsionin e pranimit të këtij propozimi, për hapat e shortit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon që, për 1 çështje, për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ai të përzgjidhet, me short, midis gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër.

Po kështu, në funksion të kësaj, propozon që mos të përjashtohet Kryetari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, zoti {...}, për shkak të numrit të kufizuar të gjyqtarëve të kësaj gjykate nga duhet të caktojmë 1 gjyqtar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

Jeni dakord me këtë propozim?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Dakord. Atëherë, në një enë do të hedhim emrat e dy gjyqtarëve {...}.

Do të përzgjedhim emrin e njërit prej tyre që do të caktohet për një çështje në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë – Emri i përzgjedhur është {...}.

Mbyllet shorti për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

Vazhdojmë me gjykatat e apelit.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Apelit Durrës**. Nevojat e kësaj gjykate janë në 3 çështje, dy në lëndë penale dhe një në lëndë civile. Kërkohet caktimi i 2 dhe 3 gjyqtarëve.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm zbatimi i mekanizmit të skemës së delegimit, ndërsa është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë kështu i aplikueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarëve për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, në zbatim të paragrafit 6, pika 4 e këtij vendimi, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës,

propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda dhe Gjykata e Apelit Tiranë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 5.

Në opsionin e pranimit e propozimit si më lart, për hapat e shortit që duhet të ndiqen, Komisioni propozon që për çështjet penale, për çështjen penale nr.2, për të cilën kërkohet caktimi i 3 gjyqtarëve, ata të përzgjidhen, me short, nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda. Në këtë rast, gjyqtari i përzgjedhur i pari caktohet edhe si relator i çështjes.

Për çështjen penale nr.1, për të cilën kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve, si të përzgjedhur nga shorti të konsiderohen dy gjyqtarët që nuk janë caktuar si relator për çështjen penale nr.2.

Sa i përket çështjes civile, atë nr.3, për të cilën kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Seksionit Civil të Gjykatës së Apelit Tiranë. Në këtë rast, përzgjedhja e gjyqtarit të parë përcakton edhe rrethin e gjyqtarëve nga do të përzgjidhet gjyqtari i dytë, pikërisht mes dy gjyqtarëve të tjerë që janë në përbërje të trupit gjykues me gjyqtarin e parë, në gjykatën nga e cila ata vijnë.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, Komisioni ka këto propozime: Të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda dhe Gjykatës së Apelit Tiranë, konkretisht zonja {...}. Po kështu përjashtohen nga shorti në çështjen civile gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë që janë me leje afatgjatë nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë, zoti {...}dhe {...}; Në shortimin e çështjes civile të përjashtohen nga shorti gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë që është anëtar i KED-së, zoti {...}. Këto ishin propozimet për përjashtimet nga shorti.

Jeni dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Dakord. Meqenëse jeni dakord me propozimet e bëra nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, vijojmë me procedurat e shortit. Fillimisht për çështjet penale. Në fillim për çështjen penale nr.2 për të cilën kërkohet caktimi i tre gjyqtarëve, që Këshilli ra dakord që të caktohen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda. Do të hedhim

në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, për të përzgjedhur 3 prej tyre. Konkretisht emrat janë {...}. Do të përzgjedhim emrat e tre prej tyre. I pari që do të përzgjidhet është edhe relator i çështjes.

Emri i parë i përzgjedhur është {...}. Emri i dytë është {...}. Emri i tretë është {...}.

Atëherë, për çështjen penale nr. 2 u përzgjedhën gjyqtarët {...}. Gjyqtarja {...}, si e përzgjedhur e para është edhe relatores e çështjes.

Referuar edhe propozimit të pranuar nga Këshilli për çështjen penale nr. 1 për të cilën kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve, si të përzgjedhur nga shorti të konsiderohen dy gjyqtarët që nuk janë caktuar si relator për çështjen penale nr.2, që janë gjyqtarët {...}.

Vazhdojmë procedurat e shortit për çështjen civile nr. 3, për të cilën kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve do të përzgjidhen nga gjyqtarët e Seksionit Civil të Gjykatës së Apelit Tiranë. Do të hedhim në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Tiranë, Seksioni Civil, duke përjashtuar kryetarin në detyrë, të dy gjyqtarëve që janë me leje afatgjatë dhe të gjyqtarit që është edhe anëtar i KED-së, v. Emrat e tjerë janë {...}. Do të përzgjedhim njërin prej këtyre emrave dhe pastaj në varësi të kësaj do të vejmë trupin gjykues sipas gjykatës së apelit. Emri i përzgjedhur është {...}. Atëherë, emrin e dytë do ta përzgjedhim mes dy anëtarëve të tjerë të trupit gjykues, ku është në përbërje edhe gjyqtarja {...}, që janë {...}. Do të bëjmë një short mes këtyre dy gjyqtarëve, kush do të jetë gjyqtari i dytë që do të caktohet në Gjykatën e Apelit Durrës.

Atëherë, fusim në një enë emrat e dy gjyqtarëve, {...} për të përzgjedhur njërin prej tyre. Emri i përzgjedhur është {...}.

Me kaq mbyllet procedura e shortit në Gjykatën e Apelit Durrës.

Vijojmë me **Gjykatën e Apelit Vlorë**. Gjykata e Apelit Vlorë ka paraqitur nevojë për 6 çështje, nga të cilat 5 çështje penale dhe 1 çështje civile.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit, ndërsa është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë i aplikueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarëve për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, në zbatim të paragrafit 6, pika 4 e të cilit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, propozon që gjykata nga duhet të

përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 6 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë Gjykata e Apelit Gjirokastër, Gjykata e Apelit Durrës, Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda dhe Gjykata e Apelit Shkodër.

Kanë specifika të ndryshme çështjet këtu se janë trupa gjykues të krijuar më herët prandaj është bërë propozimi për 4 gjykata.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 6 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 7, 3 gjyqtarë nga Gjykata e Apelit Gjirokastër, 3 gjyqtarë nga Gjykata e Apelit Durrës, 1 gjyqtar nga Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda dhe 1 gjyqtar nga Gjykata e Apelit Shkodër.

Në opsion të pranimit të propozimit si më lart, ndërsa gjyqtarët do caktohen nga katër gjykata apeli, duke patur në konsideratë numrin e gjyqtarëve që kërkohen të caktohen për secilën çështje, formimin më herët të trupave gjykues për çështjet në nevojë për caktim gjyqtari, si dhe për ekonomizim të burimeve njerëzore referuar pikës 4 të Kreut VII të vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, për hapat e shortit që duhet te ndiqen, Komisioni i Karrierës propozon që, sa i përket 5 çështjeve penale, për çështjen nr.1, për të cilën kërkohet caktimi i 3 gjyqtarëve, ata të përzgjidhen, me short, midis gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Gjirokastër dhe të Gjykatës së Apelit Durrës. Në këtë rast, përzgjedhja e gjyqtarit të parë përcakton dhe përzgjedhjen e dy gjyqtarëve të tjerë, që janë në përbërje të trupit gjykues në gjykatën nga e cila vijnë, me gjyqtarin e përzgjedhur i pari. Ky i fundit është automatikisht relator për çështjen.

Për çështjen nr.2, për të cilën kërkohet caktimi i 3 gjyqtarëve, ata te përzgjidhen, me short, midis gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Gjirokastër ose të Gjykatës së Apelit Durrës, në varësi të rezultatit të shortit për çështjen nr.1. Në këtë rast, përzgjedhja e gjyqtarit të parë përcakton dhe përzgjedhjen e dy gjyqtarëve të tjerë, që janë në përbërje të trupit gjykues në gjykatën nga e cila vijnë, me gjyqtarin e përzgjedhur i pari. Ky i fundit është automatikisht relator për çështjen.

Për çështjet nr.3 dhe nr.4, për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, për secilën nga ato, ai të përzgjidhet me short midis gjyqtareve të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë dhe të Gjykatës së Apelit Durrës, të caktuar si anëtarë për çështjet nr.1 dhe nr.2.

Për çështjen nr.5, për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ai të përzgjidhet me short ndërmjet gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Shkodër.

Sa i përket çështjes civile, atë nr.6, për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ai të përzgjidhet me short ndërmjet gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda.

Lidhur me përjashtimet e shortit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka këto propozime: Në shortimin e çështjes penale nr.5 të përjashtohet nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër, që janë caktuar më herët për gjykimin e saj, konkretisht: znj. {...}; Në shortimin e çështjes penale nr.5 të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Shkodër, z. {...}; Në shortimin e çështjes civile nr.6 të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda që është caktuar më herët për gjykimin e saj, konkretisht: znj. {...}; Në shortimin e çështjes civile nr.6 të përjashtohet nga shorti kryetarja në detyrë e Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, konkretisht znj. {...}.

Gjithashtu, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon që të mos përjashtohet nga shorti i çështjeve penale, si përjashtim nga rregulli, kryetari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, zoti {...}, në kushtet e përfshirjes në përbërje të trupave gjyqësive të tij në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë.

Jeni dakord me këto propozime?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Mirë atëherë, meqenëse jeni dakord, vazhdojmë me procedurat e shortit për secilën çështje. Atëherë, për çështjen nr. 1 për të cilën kërkohet caktimi i tre gjyqtarëve, Këshilli ra dakord që ata të përzgjidhen me short midis gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë dhe Gjykatës së Apelit Durrës.

Atëherë, do të hedhim në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë dhe të Gjykatës së Apelit Durrës – {...}, të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, {...}. Do hedhim edhe emrat e Gjykatës së Apelit Durrës – {...}. Do përzgjedhim emrin e njërit

prej tyre dhe automatikisht është përzgjedhur trupi gjykues nga gjykata nga e cila vijnë, ndërsa ai i përzgjedhur i pari është edhe relatori i çështjes nr. 1.

Është {...}. Referuar ndarjes së trupave gjykues të Gjykatës së Apelit Durrës, gjyqtari {...} është bashkë me gjyqtarët {...} dhe {...}.

Pra për çështjen penale nr.1, caktohen tre gjyqtarët {...}. Relator është gjyqtari {...}.

Për çështjen nr. 2, shorti do të bëhet midis gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Gjirokastër. Do të përzgjedhim emrin e njërit prej tyre që do të jetë relatori që automatikisht do të përcaktojë edhe trupin gjykues. Do të lejmë në enë vetëm emrat e gjyqtarëve të apelit Gjirokastër, pra emrat e gjyqtarëve {...}. Do përzgjedhim njërin prej tyre – Është {...}.

Trupi gjykues në Gjykatën e Apelit Gjirokastër ku është gjyqtari {...} është bashkë me gjyqtarët {...}. Të tre këta gjyqtarë caktohen për çështjen penale nr.2, ku relator është gjyqtari {...}.

Vijojmë shortin për çështjet nr.3 dhe nr.4 për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari. Këshilli ra dakord që për secilin nga ato ai të përzgjidhet me short midis gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Gjirokastër dhe Gjykatës së Apelit Durrës, të caktuar si anëtarë për çështjet nr.1 dhe nr.2. Pra dy gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës, bashkë me gjyqtarin {...}, që ishin gjyqtarët {...}, do të hidhen në një enë. Po kështu edhe gjyqtarët {...} dhe {...} të Gjykatës së Apelit Gjirokastër. Do t'i hedhim në një enë. Në enën tjetër do të hedhim çështjen nr. 3 dhe nr. 4.

Atëherë, përzgjedhim njëren çështje – Çështja e parë e përzgjedhur është ajo me nr. 4.

Do të përzgjedhim emrin e një gjyqtari – {...}.

Çështja që mbetet është çështja nr. 3.

Do të përzgjedhim emrin e një gjyqtari – Është {...}.

Me kaq mbyllet shorti për çështjet penale nr.1, 2, 3 dhe 4.

Vijojmë shortin për çështjen penale nr. 5, për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ai të përzgjidhet me short ndërmjet gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Shkodër, ra dakord Këshilli. Do të hedhim në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Shkodër, duke përjashtuar ata që janë caktuar më herët për gjykimin e kësaj çështjeje që janë {...}, po kështu të përjashtohet edhe gjyqtari, kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Shkodër, {...}.



Atëherë, hedhim në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Shkodër që mbetet, që janë {...}.

Do përzgjedhim emrin e njërit prej tyre, që do caktohet për çështjen nr. 5. Emri i përzgjedhur është {...}.

Mbyllim kështu procedurat e shortit për çështjet penale dhe vijojmë procedurat e shortit për çështjen civile, atë nr.6, për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, që Këshilli pranoi që të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, ndërsa trupi gjykues për këtë çështje përbëhet edhe nga anëtarë të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda. Këshilli pranoi përjashtimin nga shorti të gjyqtarës që është caktuar për këtë çështje, që është zonja {...} dhe për kryetaren në detyrë të kësaj gjykate që është zonja {...}.

Do të hedhën në një enë emrat e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, për të përzgjedhur njërin prej tyre. {...}. Do të përzgjedhim emrin e njërit prej tyre që të caktohet për çështjen nr.6. Emri i përzgjedhur është {...}.

Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit Durrës (*lapsus, pasi është Gjykata e Apelit Vlorë*).

Vazhdojmë me **Gjykatën e Apelit Korçë**. Gjykata e Apelit Korçë ka paraqitur nevojë 4 çështje, dy në lëndë penale, dy në lëndë civile. Kërkohen 1 dhe 2 gjyqtarë që të caktohen.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit të gjyqtarëve. Po kështu është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë i aplikueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarëve për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar paragrafit 6, pika 4 e të cilit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 4 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë Gjykata e Apelit Tirane, Gjykata e Apelit Shkodër dhe Gjykata e Apelit Durrës. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 4 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 4, ku 2 gjyqtarë të jenë nga Gjykata e Apelit Tirane, 1 gjyqtar nga Gjykata e Apelit Shkodër dhe 1 gjyqtar nga Gjykata e Apelit Durrës.

Në opsionin e pranimit të propozimit si më lart, ndërsa gjyqtarët do të caktohen nga 3 gjykata apeli, duke patur në konsideratë numrin e gjyqtarëve që kërkohen të caktohen për secilën çështje, formimin më herët të trupave gjykues për çështjet në nevojë për caktim gjyqtari, si dhe për ekonomizim të burimeve njerëzore referuar pikës 4 të Kreut VII të vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, për hapat e shortit që duhet të ndiqen, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon sa i përket çështjeve penale, për çështjen penale nr.2, për të cilën kërkohet caktimi i 2 gjyqtareve, ata të përzgjidhen me short ndërmjet gjyqtarëve të Seksionit Penal të Gjykatës së Apelit Tiranë. Në këtë rast, përzgjedhja e gjyqtarit të parë përcakton edhe rrethin e gjyqtarëve nga do të përzgjidhet gjyqtari i dytë, pikërisht mes dy gjyqtarëve të tjerë që janë në përbërje të trupit gjykues me gjyqtarin e parë, në gjykatën nga e cila ata vijjnë.

Për çështjen penale nr.1, për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ai të përzgjidhet me short ndërmjet 2 gjyqtareve të Seksionit Penal të Gjykatës e Apelit Tiranë të caktuar për çështjen penale nr.2.

Sa i përket çështjeve civile, për çështjen civile nr.3, për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ai të përzgjidhet me short ndërmjet gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Shkodër.

Për çështjen civile nr.4, për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ai të përzgjidhet me short ndërmjet 2 gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Durrës, që janë në përbërje të trupit gjykues me gjyqtarin {...}, i caktuar më herët për gjykimin e kësaj çështjeje.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon që, në shortimin e çështjeve penale të përjashtohet nga shorti gjyqtari i Seksionit Penal të Gjykatës së Apelit Tiranë, që ka paraqitur dorëheqje nga detyra e gjyqtarit, konkretisht z. {...}; Po kështu në shortimin e çështjeve penale të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Seksionit Penal të Gjykatës së Apelit Tiranë, Gjykatës së Apelit Shkodër që kanë pengesë ligjore apo që janë caktuar me herët për gjykimin e këtyre çështjeve, që janë (për çështjen civile nr. 3), që janë znj. {...}; Në shortimin e çështjes civile nr.3 të përjashtohet nga shorti edhe kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Shkodër, z. {...}.

Jeni dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Mirë, vazhdojmë me procedurat e shortit më tej për secilën çështje.

Fillimisht për çështjen penale nr. 2 për të cilën kërkohet caktimi i dy gjyqtarëve, për të cilët Këshilli ra dakord që ata të përzgjidhen me short nëpërmjet gjyqtarëve të Seksionit Penal të Gjykatës së Apelit Tiranë. Në këtë rast, përzgjedhja e gjyqtarit të parë përcakton edhe rrethin e gjyqtarëve nga do të përzgjidhet edhe gjyqtari i dytë referuar përbërjes të trupit gjykues, në gjykatën nga e cila vijnë. Hedhim në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Tiranë, Seksioni Penal, që janë {...}. Do të përzgjedhim emrin e njërit prej tyre. Emri i përzgjedhur është {...}.

Në përbërje të trupit gjykues me gjyqtarin {...} janë edhe gjyqtarët {...}. Ky i fundit u përjashtua për shkak se ka paraqitur dorëheqjen. Mbetet gjyqtarja {...}. Të dy ata caktohen për çështjen penale nr. 2.

Për sa i përket çështjes penale nr. 1 për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, Këshilli ra dakord që të përzgjidhet me short ndërmjet 2 gjyqtarëve që do caktohen për çështjen penale nr. 2, pra do të bëjmë një short mes gjyqtarëve {...}. Gjyqtari i përzgjedhur do të caktohet për çështjen penale nr. 1. Do të hedhim në një enë emrat e gjyqtarëve {...}. Do të përzgjedhim emrin e njërit prej tyre. Emri i përzgjedhur është {...}.

Vazhdojmë me procedurat e shortit për çështjet civile. Për çështjen civile nr. 3 për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, Këshilli ra dakord që të përzgjidhet me short ndërmjet gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Shkodër. Do të fusim në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Shkodër, duke hequr ata që kanë pengesë ligjore pra që janë caktuar më herët për gjykimin e kësaj çështjeje, pra zonja {...} si dhe kryetari në detyrë {...}. Emrat e tjerë do t'i fusim në një enë për të përzgjedhur njërin prej tyre. Emrat e tjerë janë {...}. Do të përzgjedhim njërin prej tyre. {...}e cila caktohet për çështjen civile nr. 3.

Vazhdojmë shortin për çështjen civile nr. 4 për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ai të përzgjidhet me short ndërmjet 2 gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Durrës, që janë në përbërje të trupit gjykues me gjyqtarin {...}, që është caktuar më herët për gjykimin e kësaj çështjeje. Bashkë me gjyqtarin {...} në përbërje të trupit gjykues janë edhe gjyqtarët {...} dhe {...}. Do të hedhim në një enë emrat e këtyre dy gjyqtarëve, për të përzgjedhur njërin prej tyre që do të caktohet për çështjen nr. 4 në Gjykatën e Apelit Korçë. Fusim në një enë

emrat e gjyqtarëve {...}. Emri i përzgjedhur është gjyqtari {...}, i cili caktohet për çështjen civile nr.4.

Me kaq mbyllet procedurat e shortit në Gjykatën e Apelit Korçë.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Apelit Shkodër**. Gjykata e Apelit Shkodër ka paraqitur nevojë për 1 çështje penale për të cilën kërkohet caktimi i 3 gjyqtarëve. Në këtë rast është i pazbatueshëm zbatimi i mekanizmit të skemës së delegimit të gjyqtarëve. Po kështu është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë i aplikueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarëve për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, në zbatim të paragrafit 6, pika 4 e të cilit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 3.

Në opsion të pranimit të këtij propozimi, Komisioni propozon që, për 1 çështje, të përjashtohen nga shorti vetëm kryetarja në detyrë e Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda znj. {...}.

Jeni dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Dakord. Fusim në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Krimeve të Rënda, që janë {...}. Duhet të përzgjedhim emrat e tre prej tyre, ku gjyqtari i përzgjedhur i pari do të jetë edhe relator i çështjes. Vazhdojmë me përzgjedhjen e emrave të gjyqtarëve. Është {...}, emri i përzgjedhur i pari. {...} është emri i dytë dhe {...} është emri i tretë. Mbyllet kështu shorti për Gjykatën e Apelit Shkodër.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Apelit Gjirokastrë**. Ka paraqitur nevojë për 1 çështje në lëndë civile ku duhet caktimi i 1 gjyqtari.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit të gjyqtarëve. Ndërsa është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë i aplikueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarëve për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në

një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, në zbatim të paragrafit 6, pika 4 e të cilit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit Vlore. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Në opsionin e pranimit të propozimit si më lart, për hapat e shortit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon që, për 1 çështje gjyqësore, për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ai të përzgjidhet, me short, midis 2 gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Vlorë, që janë në përbërje të trupit gjykues me gjyqtarin {...}, i caktuar më herët për gjykimin e kësaj çështjeje.

Jeni dakord me këtë propozim?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Atëherë, në përbërje të trupit gjykues me gjyqtarin {...} janë edhe gjyqtarët {...} dhe {...}. Do të hedhim në enë emrat e këtyre dy gjyqtarëve, për të përzgjedhur njërin prej tyre që do caktohet për një çështje në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë bashkë me gjyqtarin {...}. Dy emrat e gjyqtarëve janë {...}. Përzgjedhim njërin prej tyre. Është gjyqtari {...} që caktohet për çështjen në nevojë në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë. Mbyllet shorti për Gjykatën e Apelit Gjirokastrë.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Apelit Tiranë**. Gjykata e Apelit Tiranë ka paraqitur nevojë për 1 çështje në lëndë penale. Kërkohet caktimi i tre gjyqtarëve.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit. Ndërsa është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë i aplikueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarëve për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, ku në zbatim të paragrafit 6, pika 4 e të cilit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jenë Gjykata e Apelit Shkodër dhe Gjykata e Apelit Korçë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 3.

Për sa i përket përjashtimeve nga shorti, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon që të përjashtohen nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Shkodër dhe Gjykatës së Apelit Korçë, konkretisht z. {...}.

Jeni dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Dakord. Atëherë, do të hedhim në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe Gjykatës së Apelit Korçë për të përzgjedhur emrat e tre prej tyre, ku ai i përzgjedhur i pari është dhe relatori i çështjes. Emrat e gjyqtarëve janë {...}. Do të përzgjedhim tre prej tyre. I pari është edhe relator.

Emri i parë i përzgjedhur është {...}. Emri i dytë është {...} dhe emri i tretë është {...}, të cilët caktohen për çështjen në nevojë në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit Tiranë.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Lartë**. Gjykata e Lartë ka paraqitur nevojë për tre çështje penale që janë me lëndë ekstradim. Kërkohet caktimi i dy gjyqtarëve.

Edhe në këtë rast në zbatim të mekanizmit të caktimit të gjyqtarëve për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, për nevoja të Gjykatës së Lartë si më lart bëhet i nevojshëm zbatimi i këtij vendimi të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në konsideratë të kritereve të përcaktuara në paragrafin X/1 të vendimit të KLGJ-së si më lart, por edhe referuar përcaktimeve të shkronjës “c”, pika 5, Kreu IV, të këtij Vendimi, në zbatim të paragrafit VI, pika 4, të tij, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm dhe Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda. Gjyqtarët për 3 çështjet gjyqësore të veçanta, të përzgjidhen, me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2.

Në opsionin e pranimit të propozimit si më lart, për hapat e shortit që duhet të ndiqen, Komisioni propozon për 3 çështjet, për të cilat kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve, ata

të përzgjidhen, me short, ndërmjet gjyqtarëve të apelit që plotësojnë kriteret si më lart, të cilët referuar të dhënave janë gjyqtarët {...}, e Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, {...} e po kësaj gjykate, {...}, i po kësaj gjykate, dhe {...}, i po kësaj gjykate, gjyqtari {...} i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë dhe gjyqtarja {...} e Gjykatës së Apelit Vlorë. Pra janë 7 gjyqtarë.

Margarita u përjashtua nga procedurat e shortit në Gjykatën e Apelit Vlorë. Nuk ramë dakord që të përjashtohet nga çdo punë në këtë vend. Gjithsesi është çështje që mund ta vendosë Këshilli.

Gjykata e Apelit Tiranë dhe Gjykata e Apelit Durrës.

Atëherë, me propozimin e Komisionit jeni dakord apo jo?

Jeni dakord me propozimet e Komisionit?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Dakord.

Mirë, meqenëse jeni dakord me propozimet e Komisionit, vazhdojmë me procedurat e shortit. Në një enë do të hedhim emrat e 7 gjyqtarëve që u referuan më lart, për të përzgjedhur 2 prej tyre. Janë emrat e gjyqtarëve {...}. Do përzgjedhim dy prej tyre.

Emri i parë është i gjyqtarin {...}.

Emri i dytë është i gjyqtarës {...}.

Me kaq mbyllen procedurat e shortit edhe për Gjykatën e Lartë dhe të gjitha procedurat e shortit për këtë rast.

Faleminderit!

*Naureda Llagami:* Faleminderit, zoti Toska!

Nëse nuk keni ndonjë diskutim apo çështje tjetër, unë e konsideroj mbledhjen të mbyllur. Faleminderit! Faleminderit juve, faleminderit edhe stafit që ka qëndruar deri në orarin e zgjatur

\* \* \*

(Pika 7 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**